

LUMO SKENDO

HIDHE

SHPUZE

albin

I.

**LUMO SKENDO DHE PROZA E TIJ
TREGIMTARE**

Lumo Skëndo alias Mithat Frashëri (1880-1949) u takon atyre personaliteteve të botës shqiptare, që me veprën e tyre të gjithanëshme u bënë shtylla të kulturës sonë kombëtare në dekadat e para të shekullit të njëzetë. I dalë prej një dere patriotësh të mëdhenj, po dhe intelektualësh të mëdhenj, duke qenë i biri i Abdyl Frashërit dhe nip e nxënës i Naimit e Samiut, ai jo vetëm ndoqi udhën e tyre atdhetare-iluministe, por krijoi dhe individualitetin e vet të spikatur intelektual dhe artistik. Ai bëri emër të nderuar si shkrimtar dhe publicist, studjues dhe punëtor i palodhur i kulturës shqiptare. Prandaj injorimi i figurës dhe veprës së tij për afro gjysëm shekulli s'kish si të mos përftonte, siç përftoi në fakt zbrazëti në studimet tona dhe në rjedhat e letërsisë shqipe.

Lumo Skëndo u shfaq në jetën shqiptare në dekadën e fundit të Rilindjes, kur në qiellin e letërsisë sonë po ngjitej plejada e Faik Konicës, Fan Nolit, Luigj Gurakuqit, Gjergj Fishtës me shokë. Ishte ky brez i ri letrarësh dhe veprimtarësh atdhetarë që

duke mos e ndarë artin nga dituritë dhe duke u njohur atyre rolin militant në kauzën e çlirimit të atdheut, synoi dhe punoi për një emancipim të gjithanshëm të jetës shpirtërore të popullit, për një frymëmarrje më të gjerë të njeriut shqiptar. Në kushtet e reja historike, ata sollën risi, jo vetëm në mendimin politiko-shoqëror, por dhe në sferën e kulturës në përgjithësi dhe të artit në veçanti. Në këtë aspekt u bënë përpjekje të frutshme për të kapërcyer kufijtë e një letërsie poetike, e cila kish krijuar vepra të shkëlqyera, për të dalë në një terren pak a shumë djerrë siç është proza. Duke qenë e një stadi fillestar nga ana artistike, si një prozë diturake-historike-publicistike, me vlera njohëse dhe edukative, ajo nuk i përmbushte nevojat e një letërsie kombëtare siç ndodhte me poezinë shqipe bashkëkohore. Në këtë hop cilësor të prozës sonë do të bashkonin përpjekjet talente me ndjershmëri të lartë si F.Konica e L.Skëndo, po dhe talente si M.Sotir Gurra, M.Grameno, Papa Kristo Negovani, B.Shpataraku etj.

Nuk është e rastit që proza e mirëfilltë artistike shqiptare do të niste me llojet e shkurtra epike, me skica e proza poetike, me vizatime letrare dhe portrete, për të kaluar të rrëfenja e tregime. Pionierët e vërtetë e kësaj ngjitjeje artistike do të jenë F.Konica dhe L.Skëndo. Poredhe pse qenë bashkëkohës dhe frymëzoheshin nga të njëjta ideale patriotike, prijet krijuese dhe interesat intelektuale të Lumo Skëndos do të ndjekin një rrugë të vetën për të ardhur në fushën e prozës tregimtare. Në fillim, duke ecur më tej në brazdat e Rilindjes, ai do t'i përkushtohet punës prej iluministi të vërtetë kur do të botojë e drejtojë në Sofje "Kalendarin kombiar, që doli për më tepër se tridhjetë vjet (1897-1928) dhe u bë siç është quajtur " një enciklopedi e vogël kulturore-letrare", L.Skëndo shpalosi aftësitë dhe dhuntitë prej intelektual, veprimtari dhe krijuesi patriot. Atë që bënte ndërkohë F.Konica, me "Albanien" në Bruksel e në Londër, ai do ta kryente në gjirin e kolonisë shqiptare të Sofjes, duke u qëndruar më afër problemeve dhe nevojave të lëvizjes kombëtare, sidomos për të përhapur dritën dritën diturisë e të arsimit në masën e shqiptarëve. Në qoftëse "Albania" u drejtohej më shumë intelektualëve shqiptarë dhe rrethëve të huaja në Europë, "Kalendari

komiar" hyri në shtëpitë shqiptare dhe u bëri të njohur njerëzve të thjeshtë historinë dhe folklorin, dituritë dhe letërsinë kombëtare. L. Skëndo do të botonte në vitet 1908-1909 dhe gazetën e përjavëshme politiko-letrare "Liria", e cila edhe pse doli në kohë të vështira, i solli shërbime të çmuara lëvizjes dhe kulturës shqiptare. Veçanërisht, ajo u dallua në përgatitjen e Kongresit të Manastirit për alfabetin, në krye të të cilit u zgjodh Lumo Skëndo.

Por veprimtaria e pinjollit të Frashëllinjve në fushën e publicistikës e për më tepër e studimeve do të ngrihet në një shkallë më të lartë, kur do të botonte të përkohëshmen "Dituria", një nga organet më me autoritet të shtypit tonë të traditës. Për njëzet vjet (1909-1929) me radhë ajo u kthye në një nga tribunat e pakta të studimeve e hulumtimeve shqiptare, vatër e shkencës dhe e letërsisë sonë, ku kryeredaktori i saj do të mbajë e përballojë barrën më të madhe të shkrimeve të botuar. Nga disa pikpamje, "Dituria" do të zëvendësojë "Albanien" e F. Konicës, po të kemi parasysh që ajo do të fillojë jetën e vetë, kur revista e Konicës do të pushonte së botuari. Nga ana tjetër veprimtaria fletore e L. Skëndos fiton një dimension ndërkombëtar, kur boton në Zvicër revistën dymujore në gjuhën frënge "L'Indipendence albanaise".

Në përputhje me detyrat iluministe që kish marrë përsipër, Lumo Skëndo në këto vite, krahas punës gazetareske-publicistike, do të shqipëronte dhe përshtatste disa vepra të letërsisë botërore, të cilat siç e shpallë vetë që në krye ua drejtonte kryesisht të rinjë shqiptarë. Kështu, brezat e ri do të kenë prej tij në gjuhën amtare "Gaulleme Tell-in" të Lamartinit (1898), tufën e përrallave të F. Hofmanit "Bëje të mirën pa hidhe në det" (1900), romanin e D. Defoes "Robinsoni" (1909) dhe historinë morale të L. K. Aulov-s "Shkurtabiqi i verdhë" (1914). Të gjitha këto u botuan në shtypshkronjën shqipe "Mbrothësia" të Sofies, e cila në fakt u bë e para shtëpi botuese shqiptare dhe këtë fizionomi kulturore ia dha në radhë të parë Lumo Skëndo me botimin e veprave të veta.

Sfondi i pasur i trashëgimisë së Lumo Skëndos nuk mund të merret me mend pa një varg veprash të tjera me karakter historik, politik, social, shkencor, dokumentar. Kësisoj, ai bëhet i

pari biograf i poetit tonë të madh me botimin e veprës "Naim be Frashëri" (1901). Boton libra për shkollat shqipe si "Këndime" (1910). Në 1915 u jep lexuesve shqiptarë përmbledhjen me udhëpërshkrime "Letra nga një udhëtim në Zvicër", që inaguron këtë lloj letërsie në kulturën tonë. Aftësitë e tij prej analisti dhe njohësi të thellë të psikologjisë dhe problemeve të shoqërisë bashkëkohore shqiptare do t'i shpreh në librat "Pritmi i Shqipërisë" (1915) dhe "Plagët tona" (1224).

Mbrojtja e interesave kombëtare, mbi bazën e një dokumentacioni konkret historik do të jenë objekti i disa broshurave politike të Lumo Skëndos të botuara në vitet 1915-1919, kohë kjo e mbarsur me plot ngjarje dhe rreziqe për fatin e shtetit dhe të integritetit tokësor të Shqipërisë. Mjafton të përmendim "L'Affaire de l'Epire", "La population de l'Epire", "Les Albanias chez eux et a l'Etrage", "Albanais et Slaves". Historiani dhe analisti i çështjes shqiptare, poliglotti Lumo Skëndo do të jetë i pranishëm në shtypin ndërkombëtar, si bashkëpunëtor i disa organeve me emër në v.20. Ai do të botojë artikuj të ndryshëm në gazeta dhe revista të Francës, Anglisë, Zvicrës etj. si "Mercure de France", "Les Peuple Libres", "Le Vie des Peuples", "La Paix par le Droit" "Revue Polytechnique", "Tribune Libre des Nouveau", "Le Monde", "Frobenins-Exporter", "La Mercure Suisse", "The New Stratesman", "Foreign Affairs" etj.

Në vitin 1926, Lumo Skëndo do të largohet nga shërbimi diplomatik, ku punoi për disa vjet (ndërsa Faik Konica në këtë kohë do të nis karrierën diplomatike) dhe do t'i përkushtohet studimeve dhe veprimtarisë kulturore - iluministe. Në këtë kuadër duhet parë libreria që ai hapi në Tiranë, të cilën e ktheu në një qendër të vërtetë intelektuale dhe krijimi i një biblioteke të vetën, kryesisht me vepra të rralla albanologjike. Në vitet që pasuan, ai do të vijojë punën krijuese - studimore, por do të shfaqet rallë para publikut. Në fakt punonte në heshtje dhe pa bujë, po ngaherë i vëmendshëm dhe i ndjeshëm ndaj ecures së letërsisë dhe kulturës shqiptare. Në sytë e opinionit shqiptar, veçanërisht të rinisë, Lumo Skëndo do të ishte jo vetëm një rilindas i gjallë, po dhe shembëlltërë e një savanti rrezatim të gjerë intelektual.

II.

Lumo Skëndo, pavarësisht se zhvilloi një veprimtari polivalente dhe u njoh më shumë si studjues e publicist, ai bëri emër të nderuar edhe si shkrimtar. Ai u njoh si i tillë që në shtypin e Rilindjes, por botimi i përmbledhjes "Hi dhe shpuzë" (1915), ku përfshiu gjithë prozën e tij tregimtare të deriathershme e prezantoi denjësisht artistin e fjalës shqipe. Edhe pse "Hi dhe shpuzë" mbeti libri i tij i parë dhe i fundit, në të vërtetë, autori dhe më vonë nuk u shkëput nga letërsia; Burimet arkivore dëshmojnë se në një mënyrë a në një tjetër letërsia do të ngelej për të fusha kryesore e punës krijuese dhe e përjetimeve të thella emocionale.

Lumo Skëndo e nisi dhe e mbylli jetën e vetë letrare, kryesisht si prozator. Sigurisht mbeten për t'u studjuar shkaqet e kësaj lidhjeje krijuese të shkrimtarit me këtë gjini, por parë në një vështrim të përgjithshëm mund të themi se proza e Lumo Skëndos ashtu si ajo e Faik Konicës me shokë u shfaq nga fundi i Rilindjes si domosdoshmëri e vetë letërsisë sonë. Nevojat dhe kërkesat që shtronte jeta dhe stadi i ri social-historik bënte që letërsia të mos qëndronte më në kufijtë e poezisë. Siç kemi patur rast ta kemi thënë dhe gjetkë, jeta kërkonte të hynte në letërsi në përmasa më të gjera dhe në trajta më realiste dhe këtë detyrë do ta përmbushte në radhë të parë proza. Ishte ky një front i ri, tepër i gjerë, me mundësi më të mëdha pasqyrimi, po dhe me vështirësi e probleme të shumta, duke nisur nga mungesa e traditës dhe e përvojës artistike e deri te aftësimi artistik dhe individualizues i gjuhës. Në këtë front të vështirë, që lypte talent, afinitet shpirtëror, ndjeshmëri të lartë gjuhësore, përshtypje të gjalla nga jeta dhe guxim krijues u angazhua dhe Lumo Skëndo qysh në fillim. Ishte

fjala për një prozë të mirëfilltë artistike, larg rutinës së prozës deri athershme, për t'u ngritur mbi prozën publicistike. Proza duhej të kalonte nga hapësirat e një informacioni logjik dhe të shprehjes së zakonshme në hapsira emocionale dhe të një shprehje të ngritur. Lumo Skëndo do të ishte nga të paktët, që do të kontribuonte, përmes një proze të vërtetë artistike, të arrihej ky kapërxim cilësor në letërsinë shqipe. Dhe proza e tij do të fitonte këto vlera falë, jo vetëm trajtimit të temave nga jeta shqiptare dhe mbrujtjes së tyre me idetë e Rilindjes kombëtare, por dhe të mjeshtërisë artistike, të zbulimit të karaktereve, të thurjes së situatave e të përfuturit të një atmosfere të besueshme, të strukturave të ndryshme kompozicionale. Të gjitha këto ai do t'i shprehte dhe mishëronte artistikisht nëpërmjet një gjuhe emocionale dhe individualizuese. Kështu, proza shqipe në pendën e Lumo Skëndos do të njihte disa nga faqet e saj të para më të suksesshme.

Prandaj, botimi i përmbledhjes "Hi dhe shpuzë" ishte një ngjarje për letërsinë tonë. E botuar pas shpalljes së Pavarësisë në shtypshkronjën "Mbrothësia" të Sofjes, ku kishin parë dritën e botimit pjesa më e madhe e veprave të Lumo Skëndos, ajo u fliste lexuesve shqiptarë, sidomos brezit të ri, me gjuhën e vërtetë të artit. Kjo ishte gjuha e Naimit dhe e De Radës, e Fishtës dhe e Mjedës, e Çajupit dhe Asdrenit, veç jo në vargje, por në prozë, në një prozë që dëshmonte për hapsira dhe nivele të reja të letërsisë sonë.

Kur doli në dritë "Hi dhe shpuzë", autori i saj ishte 35 vjeç, por po të kemi parasysh se një pjesë e mirë e prozave të shkurtra dhe trgimeve u shkruan në vitet 1899-1905, ato i takojnë kohës së rinisë të shkrimtarit. Nga ana tjetër, edhe pse ai ishte larguar nga Shqipëria tre vjeç dhe që kthyer në atdhe në moshën 29 vjeçare (1909), kjo rrethane nuk e kish penguar në brumosjen atdhetare dhe ç'ishte më e rëndësishme për të ngritur krijimtarinë e vetë letrare mbi një taban shqiptar. Mjedisi ku kishte lindur e që rritur, ideali i Rilindjes me të cilin ishte ushqyer, atmosfera e ndezur e kolonisë shqiptare të Stambollit e më pas e asaj të Sofjes, lidhjet e gjithanshme që vendosi me lëvizjen kombëtare, jo vetëm u bënë

burimi kryesor i letërsisë që nisi të krijonte, po i dhanë asaj një kahje të drejtë e të shëndoshë. Në këtë sfond do të qenë talenti dhe ndjeshmëria, zgjuarsia dhe natyra vrejtuese, interesat e gjera dhe njohja e thelluarve kulturave të lashta e moderne, etja e përhershme për dituri dhe zotrimi i shumë gjuhëve, ata faktorë individualë që përcaktuan fizionominë e tij krijuese. Veç kësaj, nuk mund të lemë pa përmendur faktin, që në punën e tij letrare i erdhi në ndihmë dhe përvoja që fitoi duke përkthyer disa vepra të prozës tregimtare europiane. Prandaj dhe proza që do të shkruajë do të jetë sa shqiptare aq dhe bashkohore dhe këtë e dëshmon edhe fakti që megjithëse kanë kaluar afro njëqind vjet nga koha që u publikua, prapë ajo i ka qëndruar viteve, nuk është vjetruar, përkundrazi, tingëllon e freskët dhe emocionuese. Në një farë mase proza e tij duke u ngritur mbi konceptet e ngushta të letërsisë orientale të Perandorisë osmane, duke lënë mënjanë skemat dhe konvencionet e saj, ajo do të ishte novatore qoftë nga përmbajtja e re që sillte, nga shkallë e gjerë e pasqyrimin, nga larmia dhe risia e poetikës letrare.

“Hi dhe shpuzë” përmban 15 proza poetike, 11 novela dhe 6 kujtime, të shkruar në një hark kohor prej 16 vitesh (1895-1915). Sigurisht, shtyllën e librit e bëjnë tregimet, ose novelat siç i quan autori, të clat jo vetëm përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit, por përfaqësojnë dhe vlerat e tij më të çmuara ideoartistike. Në tërësi ato janë të përshkruara tejmbanë nga idetë liridashëse të Rilindjes Kombëtare dhe nga shqetësimi e angazhimi total i autorit për fatin e atdheut. Në faqet e tyre është Shqipëria nën pushtimin osman, ndjehet bota shqiptare në netët e fundit të robërisë shekullore, pragu i realizimit të shpresave kombëtare. Të frymëzuara dhe të gatuar me lëndë të gjallë nga realiteti shqiptar, ato marrin jetë, nga karaktere të gjallë, nga situata dhe mjedise me sfond të qartë social-historik. Temat zotruese janë temat tipike të kohës, ato të pajtimit e të bashkimit kombëtar, lufta kundër gjakmarrjes dhe mercenarizmit, qëndresa ndaj dhunës së administratës osmane, demaskimi i mizorisë dhe lakmive të fqinjëve shovenë, përmjekja e librit shqip, evokimi dhe glorifikimi i simboleve të shqiptarëve. Në gjithë prozën tregimtare të Lumo Skëndos gjejmë një gërshetim të temës shoqërore me atë patriotike, ku e para i nënshtrohet të dytës

sepse asnjë problem i shoqërisë shqiptare nuk shihet e nuk trajtohet jashtë kuadrit të kauzës së çlirimit të atdheut.

Që në tregimin e parë "Pika lot" (1899), shkrimtari i ri ve gishtin në një nga plagët e rënda e kronike të bashkatdhetarëve të tij, atë të gjakmarrjes. Meço Guri, një fshatar nga malësitë e jugut, pas tetë vjetësh i ngujuar në shtëpi, vendos një ditë të dalë. Autori përshkruan dramën që përjeton heroi i tij: megjithëse janë vrarë 13 veta nga armiqësia me fisin e Shelëve, ai prapë mendon se jeta është e bukur. Në këto çaste meditim, Meçua gjendet përballë Tafë Shelit, gjakësit, të sapo kthyer nga mërgimi. Atëhere ndodh e pangjara: në vend që Meçua të hakmerret bën thirrje për pajtim. Vitet e vetburgimit e kanë bindur për kotësinë e gjakmarrjes dhe autori duke hyrë në psikologjinë e tij, tregon mjeshtërisht motivet e brendshme të hapit vendimtar që ai hedh. Tërheq vëmendjen fakti që zgjidhja e konfliktit është realiste dhe bindëse.

E njëjta temë rimeret dhe në tregimin "Ora e fundit". Përsëri në një mjedis fshatar, bile malësie, po kësaj here jo në malësitë e jugut, por në ato të veriut. Edhe këtu është në qendër dilema e faljes së gjakut, veç rrethanat paraqiten më dramatike. Gjoka i plagosur nga dora hakmarrëse kalon orët e fundit dhe autori duke u përqendruar në këtë segment kohor vë në spikame dy figura: figurën e nënës, e cila lufton me dhimbjen e thellë që i ka hapur plaga e pashërueshme e të birit dhe ajo e At Pjetrit, që kërkon dhe përpiqet për të falur gjakun. Të vendosur në situata të tensionuara, në çaste për jetë a për vdekje, duke iu përmbajtur një shkallëzimi psikologjik, shkrimtari jo vetëm evidenton artistikisht problemin dhe zbulon karakteret, por përcjellë te lexuesi mesazhe optimiste, idetë e Rilindjes për bashkim.

Plaga tjetër e jetës shqiptare që ka barazpeshë në vëllimin e Lumo Skëndos me atë të gjakmarrjes është drama e kurbetit. Kjo dramë e dhimbshme ka gjetur mishërimin e vet artistik në triptikun: "Udhëtimi", "Kënga" dhe "Po kthehen". Odiseja e kurbetit është dhënë jo vetëm brenda një komize tematike, por deri në një farë shkalle dhe te një heroi të përbashkët. Triptiku hapet me skenën prekëse të nisjes për në kurbet të Meços trembëdhjetë vjeçar, që shkon të zëvendësojë të jatin të vdekur në dhe të huaj. Ky fëmijë i burrëruar para kohe duke marrë me vete imazhin e

dashurtë vendlindjes, pëshpërit me vete këngën e trimit Tafil Buzi. ("Udhëtimi").

Motivi i një kënge patriotike shqiptare, kënduar në mes të Stambollit ngërthen gjithë subjektin e tregimit "Kënga". Të mbledhur kokë më kokë shqiptarët këndojnë dhe jonet e përmallshme të vendlindjes, u sjellin kujtimet dhe frymën e shenjtë të Shqipërisë. Në mes punëtorëve kurbetlinj, autori veçon figurën e Ramit, një intelektual i ri, student i drejtësisë në Stamboll, që duke dëgjuar këngën përjeton çaste të një patriotizmi të thellë. Vërtetësia sugjestionuese e këtij personazhi të bën të mendosh për reminishenca autobiografike.

Mbyllja e triptikut i kushtohet kthimit të katër kurbetlinjëve në atdhe e në mes tyre dhe i Meços. Vendin e intrigës në tregim ("Po kthehen") e zë përshkrimi i gjendjes emocionale, i pritjes së gjatë e i mallit. Në bisedat dhe gjestet, në lëvizjet dhe ankthin e kurbetlinjëve autori, jo vetëm heton dhe përshkruan psikologjinë e tyre të çastit, por zbulon rrënjët e lidhjeve të thella me atdheun. Të gjith këto janë dhënë me një ndjenjë të hollë poetike dhe reliev të qartë.

Tregimet "Kush e ka fajin?" dhe "Tmerri", sado të shkruara në kohë të ndryshme, kanë të përbashkët shqetësimin e thellë të autorit për gjendjen e rëndë të Shqipërisë së robëruar. Në qoftë se në të parin jepen pamje tronditëse nga dhuna dhe padrejtësia që bëhet në kurriz të popullit nëpër fshatra, në të dytin flitet për përndjekjen e pamëshirëshme që u bëhet përhapësve dhe propaganduesëve të librit shqip. Ndërsa në të parin varfëria e tejskajshme dhe shtypja dalin të qarta përmes skenash realiste dhe personazhezh të besueshëm si figura e Tafilit ose ajo e beut apo e zaptijeve që mbledhin taksat me violencë, në të dytin gjejnë pasqyrim tmerri dhe presioni psikologjik që ushtron pushteti obsukrantist mbi njerëzit dhe meditimet patriotike dhe humane, gjendja e trazuar shpirtërore e autorit.

Më shumë se tregim "Ay mal" është një skicë letrare për Tomorin, malin e shenjtë të shqiptarëve, simbolit të qëndresës dhe të besimit në mbijetesën e tyre. Ngjitja për në malin e Tomorit, në këtë prag të qiellit i ngjan një riti të lashtë arbëror, siç i ngjajnë një testamenti fjalët e plakut drejtuar të birit e si mësim të historisë që

brezat i përcjellin njeri tjetrit. Autori këto nuk i jep në mënyrë të thatë dhe retorike, po në sfondin e gjallë të malit të Tomorit dhe të pamjeve piktoreste që hapen nga maja e tij. Është vërtetë madhështor imazhi i konfiguracionit të Shqipërisë, i dhënë jo vetëm si një tokë e shenjtë, gatuar me gjakun dhe djersën e shqiptarëve, po dhe si një vend me bukuri magjepëse. E shkruar me ndjenja të fuqishme patriotike, ku meditimet altemohen me pamje të ndryshme të krahinave Shqipërisë dhe animizimi luan një rol të dukshëm, "Ay mal" është e denjë për çdo antologji shkollore.

S'ka dyshim se majën e saj proza e Lumo Skëndos e arrin me tregime "Si vdiq Selman Todorush" dhe "plaku i Ylyncit". Njeri si tregim realist që ngrihet mbi karakterin e një malësori, tjetri si tregim alegorik që ndërtohet mbi një figurë simbolike. Malësori shqiptar, veçanërisht ai i viseve të jugut ka gjetur te Selman Todorusha thelbin e natyrës së tij, karakterin e fortë, zgjuarsinë dhe urtësinë e përvojës së jetës, njeriun "e rrojtur me nder e trimëri pas zakonit të shqiptarëve". Ai është shembëlltyra e gjallë e plakut patriot lab, fjalëpak dhe autoritar, pjellë e mjedisit baritor dhe e psikologjisë patriarkale. Nuk do të gabonim po të thoshim se me Selman Todorushën, L. Skëndo ishte i pari që i çel rrugën tregimit të mirëfilltë të karaktereve në letrat shqipe. Ai e bëri heroin e vet të lexueshëm psikologjikisht përmes situatash të besueshme dhe detajesh karakterizuese dhe vrojtimesh të holla. Është burrëria e Selman Todorushës para vdekjes ajo që nxjerrë në pah karakterin dhe botën e tij të ashpër, po figura nuk do të dilte e plotë pa figurën e Rakos, e kësaj gruaje që për të treguar dashurinë dhe respektin e saj ndaj kunatit s'e ka për gjë të vetsakrifikohet duke u hedhur në greminë. Duket gati i pabesueshëm gjesti i vetflijimit të Rakos, por ashpërsia e maleve dhe ë zakoneve, pastërtia e saj shpirtërore e ndoshta ndonjë dramë e fshehtë, që vetëm ndjehet, mund të shpjegojë zgjidhjen që i jep autori tregimit.

"Plaku i Ylyncit" është një tregim alegorik, me prirje të qarta filosofike, që i paraqitet lexuesit për të nxjerrë kuptimin konkret dhe idetë që rreh të jap autori në kontekstin social-historik të kohës. Ai pothuajse nuk ka subjekt. Gjithë ajo që zhvillohet para tij, hapet si një tablo sa reale aq dhe ireale, sa e vërtetë aq dhe fantastike. Edhe pse flitet për një vend të njohur të Shqipërisë së

jugut, siç është shkëmbi i Ylynecit, ajo shënon vetëm pikënisjen, lokalizmin formal të ngjarjes që shtjellohet më pas. Lexuesi gjendet para mërgimitarit që kthehet në atdhe, i cili duke u ndalur para shpellës së hapur si një "gojë skëterre" bie në mendime të thella për fatin e Shqipërisë. Është kjo gjendje e fortë shpirtërore që përfton tablonë e një realiteti legjendar dhe bën të dalë prej andej plaku i moçëm i Ylynecit. Në këtë imazh minidantesk, shkrimtari vë në kontrast dy pamje: nga një anë paraqitet ferri, vdekja, koha e kthyer në të kaluar, bota e shndërruar në gërmadhë, ata që kanë rrojtur e s'janë më dhe nga ana tjetër, parajsja, njerëz të gëzuar, vende të lulëzuara, qytete të bukura, e tanishmja plot dritë. Sipas filozofisë së orakullit të Ylynecit, në ferr gjenden njerëzit që vdiqën pa rrojtur, të padenjë për jetën, të dështuarit, qëniet e paafta e të pavlera, në parajsë zenë vend njerëzit që rrojnë dhe e gëzojnë jetën, të denjë për vlerat dhe bukuritë e saj. Tabloja bëhet më e qartë dhe merr kuptim konkret, ajo zbulon kryefjalën e autorit, kur tregohet se në mes dy realiteteve qëndron një foshnjë, në djepin së cilës është gdhendur fjala Sh.Q.I.P.E.R.I.A. Djepi tundet në mes jetës dhe vdekjes, në mes luadhit të bukur dhe vendit të shkretuar.

Tregimi merr një domethënie filozofike dhe historike, që buron sa nga kontrasti flagrant i imazhit aq dhe nga monologu i orakullit të Ylynecit. Plaku i Ylynecit është historia e paanshme, koha në rjedhën e saj fatale, dëshmitare e të mirave dhe të këqijave, e vlerave dhe antivlerave të natyrës dhe të njeriut, koha me alternativat e saj, para së cilës Shqipëria dhe shqiptarët duhet të dinë të vendosin raporte të drejta. Tregimi i shkruar në 1913 dhe i botuar në 1915, vite këto të mbarsura nga rreziqe të panumërta, bartin mesazhin e shkrimtarit, drejtuar shqiptarëve se atdheu i porsaçliruar nga pushtuesit i ngjan një foshnjeje, që kërkon jo vetëm dashuri e përkujdesje, po dhe urtësi e përkushtim, gatishmëri për çdo sakrificë. Varet prej tyre në se ajo foshnjë do të përfundojë "në greminë ose në mbrothësi"

Titulli "Hi dhe shpuzë" u takon në radhë ciklit të prozave poetike me të cilat hapet vëllimi omonim. Ato janë të një kohe me

prozat poetike të F.Konicës dhe shënojnë fillimet e këtij lloji letrar në letërsinë tonë. Kjo lloj proze veç natyrës së saj të veçantë, formës dhe mjeteve të veta të shprehjes të parrahura tek në deñ atëhere, tërheq vëmendjen për brendinë humane intime, për tematikën jashtë angazhimeve të drejtpërdrejta që lidhen me lëvizjen kombëtare. Prozat poetike do të pasqyronin një sferë tjetër të psikologjisë dhe botës shpirtërore të njeriut shqiptar i cili, ndonëse i përkushtuar i tëri luftës për liri, ai e jeton jetën në të gjitha shfaqjet e saj; për të nuk janë të huaja ndjenjat e holla, çastet lirike, meditimet social-filozofike. Nxjerrja në pah e kësaj pasurie shpirtërore e intelektuale, dëshmonte veç emancipimit në radhët e inteligjencies shqiptare, dhe për ato rreze drite që vezullonin në mbretërinë e fanatizmit mesjetar të kohës.

Dashuria është tema që lidhë e bashkon në një të vetëm gjithë ciklin e prozave poetike të Lumo Skëndo. Nëpër të, nën hirin e kohës digjet shpuzë shpirti dhe shkëndijojnë mendimet e njeriut të dashuruar. Ndjenja e dashurisë paraqitet me një spektër të pasur emocional dhe bëhet e dukshme dhe e prekshme përmes një vargu situatash gjendjesh shpirtërore, me drita dhe heje, ku altermohen dhe gërshetohen gëzimi e trishtimi, ëndërra e zhgjëndrra, malli dhe vetmia. Dhe megjithë këto variacione, e gjithë proza ka një heroinë të përbashkët: është e dashura e poetit, vasha e tij, e dhënë nga këndvështrime të ndryshme, po gjithnjë e bukur dhe joshëse, e heshtur dhe plot fshehtësi, shpesh nën një dritë të vagëlluar, parë gjithnjë me sytë e mallit.

Dashuria e poetit është e fuqishme dhe e pastër, e sinqertë dhe delikate. Ajo mban vellon e një tisi romantik dhe karakterizohet nga nota sentimentale, ajo gjallon si një ndjenjë e thellë që buron më shumë nga shpirti se sa nga trupi. Kjo është arsyeja që prej portretit të heroinës ne shohim kryesisht sytë, buzët, flokët, duart dhe ndjejmë më tepër lidhjet shpirtërore midis tyre. Janë këto lidhje që i japin kuptim jetës së poetit, e ngazëllojnë ose e trishtojnë, e ngrejnë në qiell ose e zbresin në tokë.

Dashuria në prozat e Lumo Skëndos nuk mund të përfytyrohet e kuptohet pa pjesëmarrjen aktive të natyrës. Natyra

është pjesë përbërëse dhe sfond i pandarë i saj. Ajo i gjendet dashurisë së poetit në çdo kohë të ditës e të natës, mbushur me mistere dhe kredhur në një atmosferë të mjegulluar. Në peisazhin e tij janë të pranishëm zakonisht qielli, hëna, yjet, nata, mugëtira, shiu, vjeshta, drita të vagëlluara, që në një mënyrë a në një tjetër ndihmojnë për të nxjerrë në relief momente të ndryshme të dashurisë.

S'ka dyshim se prozat poetike të Lumo Skëndos janë krijime origjinale, pjellë e meditimeve e përjetimeve, që zgjoi dashuria te një shpirt e një qenie thellësisht artistike siç ishte ai. Por nga ana tjetër të krijuara në klimën e romantizmit të vonuar shqiptar, ato ruajnë tipare të saj, ndërsa vështruar më gjerë, marrë në përqsasje me romantizmin europian ndihet ndikimi i tij, veçanërisht i letërsisë romantike franceze. Nuk është e rastit që ai përktheu qysh në fillim një vepër në prozë të Lamartinit. Ato janë gatuar me ide dhe imazhe të kësaj letërsie, që vendosi raporte të reja me jetën dhe njeriun. Autori udhëhiqet nga mendimi themelor i romantikëve se çdo gjë në këtë jetë "është e vdirshme"(e vdekshme), e paqëndrueshme, prandaj ajo duhet gëzuar, nuk duhet lënë çasti i lumtur të kalojë. Prej këndej rjedh filozofia hedoniste-epikuriane në marëdhëniet e shkrimtarit të ri me dashurinë, gëzimi që sjell ajo, shpirtmirësia, keqardhja për vrapin e kohës që s'kthehet më. Meditimi i thellë mbi këtë gjendje të pashmangshme zgjon në prozat e tij nota trishtimi, ndonjëherë dhe tone elegjiake, imazhe të zymta, rrëfime të shqetësuar. Fryma meditative gërshetohet me ndjenjën e vetmisë dhe këto përftojnë kujtime që ravijëzohen në peisazhe të mugëta, në hije dhe fantazma, ku ndihen zëra dhe psherëtima. Aty këtu nëpërkëmbet madje dhe idea e absurdit, aq karakteristike për simbolistët francezë, të cilët L. Skëndo i ka njohur si vazhdues të romantikëve. Ashtu si ata, ai të keqen në shoqërinë njerëzore nuk e sheh thjeshtë si kategori historike, po si diçka që fatalisht u bie njerzve.

L. Skëndo edhe pse shkruan në prozë, tregohet poet, një lirik i hollë e delikat. Lirizmi i tij gjen shprehje në harmonizmin e ndjenjave të veta me natyrën dhe bukurinë e saj, në frymën nostalgjike për madhështinë e kaluar dhe trishtimi për humbjen e saj. Prandaj proza e tij kthehet në një rrëfim shpirtëror dhe ky rrëfim tingëllon i singertë, i vetvetishëm, pa poza e artificia, ai del si një psherëtimë dhe ndikon menjëherë emocionalisht te lexuesi.

Kujtimet janë një kapitull më vete në prozën tregimtare të

L. Skëndos. Ato qëndrojnë në mes përjetimeve vetjake, ngjarjeve reale dhe krijimtarisë letrare. Bile për nga fryma dhe ngarkesa emocionale, nga pasuria figurative dhe asociative afrohen me prozat poetike, ndërsa nga temat dhe idetë kanë pika takimi me tregimet. Vetë autori të "Netët" pohon se "kam ca kujtime që të isha poet do t'i vija në vjershë, të isha piktor do t'i përshkronja me ngjyra". Në fakt L. Skëndo gjithë ç'ka ndërë dhe ka përjetuar, i ka dhënë në kujtimet si artist përmes një proze të këndshme, plot detaje e mbresa të gjalla, me një gjuhë të ëmbël dhe rrëfim të shtruar.

Kështu, përcjellja e fundit e Naimit, atmosfera e kësaj dite të dhimbëshme ("Naim be Frashëri") dhe portreti intelektual i Samiut ("Një kujtim") nuk janë evokime të rëndomta të kohës së kaluar, por proza në kufijtë e artit të fjalës. Dy kujtimet e tjera ("Suliotët" dhe "Në Sinop") të përshkruara nga ideali patriotik, sjellin para lexuesit realitete dhe gjurma shqiptare në botën turke, ndërsa të "Netët" shpirti i hollë artistik dhe zemra e ndezur e atdhetarit kanë përfutur imazhe të forta mbresëlënëse. Sipas tij janë të bukura netët nën dritën e hënës në Stamboll, Vjenë, Athinë dhe Athos, po më e bukura natë është ajo, kur tek gjendet në një cep të Shqipërisë, vështron dhe sodit Gurin e Skënderbeut. Edhe të "Pylli", që duket në vështrim të parë si një pejsazh, por magjepsës, përshkënditet nga kujtimi i Shqipërisë.

Proza tregimtare e L. Skëndos shënon pa dyshim një hap të rëndësishëm në rrugën e mundimëshme të prozës sonë artistike. Lënda jetësore dhe historike, njeriu dhe psikologjia shqiptare, filozofia dhe konsitucioni i tij shpirtëror, natyra dhe mjedisi karakteristik në këtë faqe të re të prozës, gjetën një organizim artistik mbi bazën e një gjuhe emocionale-individualizuese, në radhë të parë në përvijimin e karaktereve, po dhe në shtjellimin e fabulës e të subjektit, të strukturave kompozicionale etj. Veçanërisht, puna krijuese me karakteret përbën ndoshta momentin më të rëndësishëm, po të kemi parasysh që historia e letërsisë është tek e fundit, siç thuhet historia e karaktereve. Në tregimet më të mirë, L. Skëndo, ka arritur që të mbahen mend, jo nga emri se sa nga tiparet e qensishme të personazheve, nga tipi social që përfaqëson. Pa lënë mënjanë ngjarjet dhe përshkrimet, proza e tij synon të hyjë në brendi të njeriut shqiptar, ta zbërthejë psikologjikisht e ta mishërojë artistikisht brenda mjedisit të vetë. Personazhe si Selman Todorusha apo plaku i Ylynecit janë nga të parët që kanë hyrë në galerinë e karaktereve të letërsisë shqipe. Pas tyre rrijnë figura të

qarta si ajo e mërgimitarit Meço Guri, e fshatarit Tafil apo e malësorit Gjokë, e studentit Ram, e at Pjetrit, e Shytit etj., pa harruar heroinën lirike të prozave poetike dhe autoportretin e shkrimtarit. Individualizmi i figurave në prozën tregimtare të L. Skëndos është një përvojë e vyer artistike që ai ka sjellë në letërsinë tonë në një kohë kur ajo kish aq shumë nevojë.

Tregimet e veta L. Skëndo i quan novela, kur në fillim të shekullit emërtoheshin rrëfenja ose tregonjëza. Subjektet e tyre janë të thjeshta, pa ndërlikime, me fabula që japin dorë për situata bindëse dhe hapësirë për evoluimin e personazheve. Në strukturat kompozicionale gjenden raporte të drejta midis dialogut dhe aksionit, përshkrimeve dhe pejsazhit.

L. Skëndo është tregimtar i lindur. Rrëfimi i tij zhvillohet natyrshëm, i shtruar, me sens mase, nga kënde të ndryshme vështrimi, me një teknikë novatore për kohën. Ai integrohet e harmonizohet me dialogun, një dialog individualizues, sa informues aq dhe funksional, me ngjyrime emocionale. Nga ana tjetër proza e L. Skëndos nuk mund të mendohet pa pejsazhin, përshkrimet piktoreske të natyrës. Autori e ka të theksuar ndjenjën e pejsazhit, është tepër i ndjeshëm ndaj hijes dhe dritës, ngjyrave të stinëve, relievit shqiptar. Natyra shqiptare ka gjetur tek ai artistin që pikturon aq bukur e saktë me fjalë. Me fjalën e tij të hollë, na ka dhënë malet dhe fushat, pranverën dhe dimrin, florën dhe faunën shqiptare. Aftësitë përshkruese dalin po aq të qarta e të prekshme dhe në vizatimin e portreteve, të mjediseve e të atmosferës sidomos atyre fshatare.

Proza e L. Skëndos u shkrua në klimën e romantizmit shqiptar dhe sadoqë vende vende ka situata dhe tablo realiste, figura dhe zgjidhje të dhëna me vërtetësi, ajo mbetet një prozë romantike me thekse sentimentaliste. Ndoshta, vlera më e madhe e kësaj proze është gjuha¹⁾, e cila i trasoi rrugën artit të fjalës në

1) Ribotimi i librit "Hi dhe Shpuzë" shtroi nevojën jo vetëm të transkriptimit nga alfabeti i vjetër në atë të sotmin, por dhe zbatimin në vijat kryesore të drejshkrimit të ri. Përndryshe, vepra krijonte vështirësi për lexuesin e zakonshëm. Kështu, u shkarkua nga e pazane, aq e pranishme në drejtshkrimin e toskërishtes së hershme letrare, si dhe u ndreqën trajta të tjera arkaike, pa prekur domosdo veçoritë morfologjike dhe sindaktikore.

këtë gjini të vonuar në letërsinë tonë. Në pendën e L. Skëndos fjala shqipe fitoi vlera të reja emocionale, stilistike e semantike. Toskërishtja e prozës së Naimit dhe e prozës historiko-publicistike e Samiut, në prozën e të nipit u pasurua më tej. Toskërishtja letrare e traditës së Rilindjes dha tek ky autor një provë të suksesshme të vlerave dhe aftësive pasqyruese e plazmuese. Ndjeshmëria ndaj fjalës, butësia dhe ëmbëlsia, harmonia e brendshme e frazës, ngjyrimet emocionale janë disa nga tiparet e stilit të L. Skëndos. Stili i tij nuk mund të kuptohet pa ritmin dhe melodinë e muzikës së gjuhës shqipe, pa tonet e saj të larmishme. Ndikimi i L. Skëndos në këtë pikpamje do të ndihet në brezat e ardhshëm letrarë madje deri te M. Kuteli.

"Hi dhe Shpuzë" del në dritë rishtaz plot 80 vjet pas botimit të parë. E vështruar në tërësinë e veprimtarisë së L. Skëndos, ky libër mbetet e vetmja përmbledhje letrare e tij e botuar. Më vonë, ai pak ose aspak iu kushtua letërsisë së mirëfilltë. U mor me studime e publicistikë, me hulumtime të vlerave tona kombëtare. Kështu, "Hi dhe shpuzë" është kthyer dhe në një relikte bibliografike po të mendojmë që u botua dhe jashtë vendit. Megjithatë, tregimet e tij më të arrira, "Plaku i Ylynecit" dhe "Si vdiq Selman Todorusha" asnjëherë nuk munguan nga antologjitë tona shkollore kryesisht në mes dy luftrave.

Autori i këtyre radhëve e quan nder dhe kënaqësi që pati fatin të përgatis për botim këtë vëllim, duke e parë Lumo Skëndon kryesisht si shkrimtar dhe personalitet të kulturës, pavarësisht nga pikpamjet politike dhe filozofia e tij sociale. Ky është edhe një rast për të dëshmuar të vërtetën e njohur se republika e përjetëshme e artit e përjashton mbretërinë e përkohëshme të politikës.

"Hi dhe Shpuzë" u përket atyre veprave të letërsisë shqiptare që koha jo vetëm nuk e ka zbehur dhe rrudhur, por përkundrazi, i ka nxjerrë më në pah vlerat e tyre të vërteta. Kemi bindjen se brezat e ri të lexuesve do të kenë ç'të çmojnë dhe të shijojnë në këtë libër.

Nasho Jorgaqi

Hi dhe Shpuzë

PARATHENIE

Këto gjërat e vogla që po i jap sot këndonjësit, nuk janë të ra. Shumë prej tyre janë botuara në Kalendart kombiar dhe të tjerat flinin gjysmë të haruara në mes të kartravet. Të mos ishte këshilla e disa miqve indulgjentë, padyshim që të gjitha do të mbeteshin të varrosura, të harruara mbase edhe prej meje vetë, si çdo gjë që e than dhe vdjer koha, si gjithë këto gjurma që i prish dhe i shuan moti.

Tani po i shtyp këtu të pandërruara, me atë kujdes që e bën njerinë të dojë ruajtjen e kujtimevet të tij, që e bën të shtrëngohet për të përsëritur ngjyrat gjysmë të shuara.

Sofje 18/31 Janar 1915

EJANI, O KUJTIME!

Ejani, ejani o kujtime, se kam nevojë për ju. Zemra sot ka pikëllim. Ejani se u dua.

T' ëmbël a të hidhur, gjithnjë u kam dashur, o miqt' e mij. Të ngroht' a të ftohtë, si do që kini qenë, zemra u ka pritur me dashuri!

Ini miq të vjetër: m' arrin të mbyll sytë që t' u shoh këtu pranë meje. Ejani, pra, o kujtime.

Kur shpirti më ndjen të ftohtë, kur zemra ndjen veten e saj jetime, u dua, o kujtime, si i varfëri që trazon hin' e vatrës për të gjetur pak shpuzë. Sa t' ëmbëla i duken ato shkëndijat e vogla!

Po edhe në kohë të gazit dhe të shpresës, ahëre kur një e sotm' e qeshur më bën të dua gjithë kohën e shkuar dhe të shoh t' ëmbël dhe të bukur udhën që kam përpara, edhe ahëre o miqt' e mij, dua të trazoj këtë hi të jetës që të shoh shpuzën, ta shoh e të gëzohem e të qesh duk' e flakur n' erë!

Inebull, 18/31 Korrik 1912

A S A J

Si kombet me vetija e me mendime të thjeshtë q' i falen një fytyrë gdhendur në gur a në dru; si kombet më të qytetëruara që rrinë me orë dhe luten përpara një fytyre bërë me ngjyrë vaji a dy copëra drurë të bashkuar; si ata kombe që marrën me muaj udhë që të venë t' i falen gurit të zi; si ata të moçmit q' i falen diellit, zjarrit, shikonin me adhurim të thellë yjtë, dhe bëheshin therorë për perëndit' e për perëndeshat, a si ata që dhe sot shtriten e shtypen nën qere të Budës; ashtu dhe unë, o e bukura ime, dua t' u falem dy yjeve që janë më të bukura se të gjith yjt' e qiellit, dy yjeve që janë syt' e shkruar të tu, dhe të bëhen hi, o e dashuria ime, nën këmbët vogëloshe tënde!

Vjeshtë 1905

II.

Në është vërtet se zëmra jote s' rreh kurrë për mua-ashtu si ke dashur të më duash, - në është vërtet se fytyra ime nuk zë asnjë vënd në ëndërrimet e tu, pse, o e bukura ime, kur më sheh ngadalson çapnë, pse më lëshon vështrimn' e atij syri të shkruar tënt?

Nuk' e di ti si më buçet dhe më zjen gjaknë ay vështrimi yt kaq i qetë dhe i ftohtë? Nuk e di ti si më çpon zemrën ay

vështrimi ngjyrë qielli?

Vështrimi yt është si një shtizë në dorë të një djali që lot me një zok; vuajtjet e shpesit i heq dhe zemëra ime. Të lutem pusho, pusho këtë lodër të gjakëme.

Po ç'them unë! shtjemë, shtjemë syt' e tu, se vështrimi yt, o e bukura ime, m'i fjeshtë se frym e Jehovahjt, i ep gjëllim shpirtit tim.

Prill, 1906

III.

Pse ikën ashtu nga unë? nuk e di ti që dashuria është me krahë dhe m'e shpejtë se vrapi yt?

Dashuria ime të është qepur si hieja. Kudo që të vesh të ka për të rënë pas, kudo që të jesh do të të dalë përpara, dhe kur të na ndajë një mërgim i math, hieja ime prapë të ka për të ardhur pranë.

Malet, fushat, as njerëzit s'na kanë për të ndarë, se shpirti im është qepur pas shpirtit tënt, se trupi im të ka për të kërkuar gjithnjë. Edhe vdekja kur të më marrë nga kjo botë, edhe ahëre hieja ime- e dashur' a e tmerruar - ka për t'ardhur të të gjejë në të mugëtit e në t'errëtë.

Edhe kur për ty - ah, dua që të jetë shumë e largme - do vij' ora që të shuhen ata sy q'i dua kaq, dhe të bëhet hi ay trup i bukur, edhe ahëre, o zemërkeqe, mos pandeh se do të shpëtosh nga ndjekja ime; shpirti im të ka për t'ardhur gjer në varr, se shpirti im është qepur pas shpirtit tënd dhe trupi im ka për të kërkuar gjithnjë; ahëre, brenda në varr t'errët e të ftohtë, eshtërat do të të dridhen, se në dashuri do të jem gjithnjë besnik!

Shënëndre 1906

IV.

Më pyet sa është e thellë dhe a është e përjetshme dashuria ime.

Ahere syt' e tu, ata sy të zez q' i dua kaqë, marrën një shkëlqim, një vështrim të ri, edhe buza jote ka një të qeshur të hidhur.

Pse, o e dashura ime, pse le të hyjnë të tillë mendime të hidhur n' atë kokë të bukur?

· Nuk' e di ti që çdo gjë në këtë jet' është e vdirshme? Nuk e di ti që çdo gjë mi këtë dhe ka një funt?

Prapsi, prapsi, këto mendime. Mos i përsërit këto pyetje.

Të dua me gjithë shpirt, me dashuri të thellë; sot të dua sa për një jetë të tërë. Mos prish gaz' e sotme duke mejtuar nesërimen e errët.

Mos më pyet më sa është e thellë dhe as është e përjetshme dashuria ime!

1908

V.

Më pyete pse të dua, dhe unë qesha.

Qesha, ma tani po mejtohem dhe them: Pse të dua?

Të dua për atë të qeshur të bukur, kur të çkëlqen syr' i kthjelltë nën ballë të qëruar; të dua për ato leshëra ku është pshjellë gjithë thellësi e natës, dhe për atë vështrim ku këndohet gjithë gaz' i ditës, për atë vështrim q' është si një

yll i lumturisë; të dua, se kur flet, ay zë më zgjon në zemrën time gjithë zëret e fshehtë të shpirtit; të dua se pranë teje, e ndjej vethen time të madh dhe të fortë, se në dashurit tënde shoh zbardhëllimin e jetës.

Po të dua se, tekdo, me gëzim të fatbardhësisë, a në t'errët të helmit, se në qeshje të mëngjesit, në tym të të mugëtit, se në ngjyrë të lules a në përkëdhelje të veriut, tekdo, o e dashura ime, ty të gjej dhe ty të shoh; të dua se edhe kur zbres në thellësi të shpirtit dhe në fund të zemrës, edhe atje thellë të gjej.

Gusht 1909

T H E M

Them, pse krimi që sheh lulen e bukur që ndrin në rrezet e diellit e vështron me lakmim, dhe kur zë të ngjitetë n'atë lastar të ngritur me aq guxim dhe madhëri drejt qiellit, këmbët e tij të padukura s'i punojnë, fuqia s'i ndih, dhe të kthyerat e të luftuarat e trupit të tij i venë kot; ahëre krimbi, sytë në qiell dhe në lule, përpiqet dhe një herë, hedh dhe një çap të fundit, dhe bie e këputet poshtë.

Them, pse qeni, me dhëmbët e mprehtë dhe me fuqin' e zjarrtë, sheh një gjah të shijshëm a një armik të shpirtshëm, kërkon t'i hidhet, ta çajë dhe të shpëtojë; kërkon, po dhëmbët dhe kërcinjtë s'thyejnë dot zinxhirë q'e lidh; sulet, dhe ky sulm i gjakos zverkun, dhëmbët i mpihen mbi hekur të zinxhirit; ahëre gryka e gumzhit dhe syri i lëshon flakë.

Them, kush do të kuptojë shpirtin e krimbit të dobët dhe të qenit t'egërsuar; kush do të na thotë vuajtjet e tyre?

TE MUGETIT

Brenda në t'errët shikoj nga finestra perëndimnë. Drita humbet, ca nga ca t'errëtit shtohet, botën e mbulon një mjegull e zezë; n'atë kohë që çfaqet nga perëndimi një flak' e hollë majë malevet, pandeh njeriu se drita, dita po vdesën për gjithnjë.

T'errëtit si tym i zi më hyn në shpirt dhe në zemër.

Mejtohem: pse lind dielli çdo mëngjes dhe pse shuhet çdo natë! them: pse pas dritës na vjen kjo cip' e zezë!

Ca nga ca pushimi bëhet m'i thellë, çdo gjë bje më një qetim. Ahere syt' e yjvet çelen dhe shikojnë dhen' e nxirë, të pikëlluar.

Them: pse shikojnë kështu këta yj? Apo duan të hedhin pak gaz mbi dhet të nxirë, mbi njerëzit. Këta sy ngjajnë me syt' e tu, o njeri. Po të tutë qeshin, qajnë, gëzohen, helmohen, shkëlqejnë dhe shuhen. Ata sipër atje në qiell, ata janë gjithënjë të shkëlqyera.

NJE MBREMJE MBI UDHET

Një mbrëmje mbi udhët të fshatit pashë dy qe që hiqnin një qerre. Udhë ish e bardhë; një pluhur i hollë po e mbulonte, dhe më të dy anët barra dhe driza i epnin një stoli. Ish udh' e gjatë; vinte nga arat dhe vente gjer në fund të fshatit. Lisat e korrikut i bënëin atje tej një gardh të lartë.

Qetë po ecnin me çape të rëndë. Kërcinjt' e shëndoshë po çaponin me ngadalë, dhe, sa herë që lëvizte bishti, një dredhje e fort shkante mbi cipën e zezë ku shkëlqenin qimet e ashpëra.

Fshatari kish ndenjor mbi një thes bar në këtë qerre të gjatë, shata dhe lopata pranë tij.

Qetësi e natës po afrohes; duke pushuar zërat e ditës, zgjohen cinxërit. Në gojë një cingar, bujku kish sytë gjysmë të mbyllur, nën një ballë djegur prej dielli, të rrudhosur prej dyzet vjet pune; duart e lodhura, po të forta i kish lëshuar mbi gjunjët.

Ish i qetë, pa nonjë dredhje mbi atë fytyrë të shëndoshë; asnjë brengë s' dukesh t' i unjinj qafën. Nga një herë një zë, një thirrje arrinte që t' u apë kurajo qevet, se s' kishte nevojë që të marrë në dorë hostenë me thumb në majë. Edhe qetë, të dy zverqetë marrë në zgjedhë, tundnin kokën dhe u shkëlqente hund' e qullur.

Duke parë këta të tre shokë, të dy qetë e zgjedhës dhe fshatarë këmbë -kryq mbi thesin me bar, më pëlqente durimi dhe shpresa e tyre.

Eren-Qoj, 24 Qershor 1910.

EJA MOTER

Eja motër të dalim në kopsht se erdhë kohët e mira. Nuk e sheh që marsi na pru ditët e bukura? A po sheh se qysh qielli duket m'i ëmblë, deti m'i vakur dhe ata malet atje larg, a i sheh se qysh kanë një ngjyrë më të dashur dhe duken më t'afërt?

Eja motër, se qershitë janë plot lule. I mban mend këto lule kur i tërë kopshti mvishesh me të bardhë? Shkuan dhjetë vjet q'ahere! E mban mënd, kur hipnje në drurët dhe qeshnje me mua kur s'të gjenja dot? Se ishe dhe ti e bardhë si dëbora veshur dhe nuk çquanje nga lulet.

Eja motër, të shohim qershitë. Vërtet këta më s'janë ata drurë; ata u thanë dhe humbën. Po lulet janë gjithnjë ato lule!

Eren-Qoj, 5 mars 1912

AH, PO BIE SHI PRAPE

Eja, mike, se po bie shi.

Më duket sikur po qan qielli, sikur po derth lotë të hollë. Edhe zemra ime sot po qan. Jam vetëm; lotët e qiellit rrjedhin jashtë qelqevet dhe po ndjej të ftohtët brenda në

zemër.

E mban mend, mike, kur ishim bashkë sa shumë e donim shinë? E mban mend gazin që ndjenim afër dritares kur binin pikat e mëdha të shiut? Ti i prisnje ato ditë, se e dinje që më pëlqenin; i prisnje ato ditë, më prisnje mua.

Ahere, kur bota mbytesh me lot, ne ishim të gëzuar; ahere, kur bota mbulohesh me ujë të ftohtë, ne kishim të nxehtë në zemër.

Po tani, nga kjo odë gjysm' shikoj pikat që po kullojnë, dhe po mbërdhi.

5/19 Vjesht' e I

PO E SHEH? DRITA VENITET

Po e sheh? Drita venitet, mjegulla trashet. Një hi, një nap' e zezë po mbulon shtëpinë, po më hyn brenda n'odët.

E sheh, mik, këta të mugët të përziçmë? Ky më mbush shpirtin me angusë, më ep dëshirë të qaj dhe të këlthas.

Ah, këta t'errët! Më duket sikur është hapur varr' i shekëllavet dhe po del jashtë gjithë zi e jetës, një zi e jetës, një zi që vjen nga funt' i dheut, ku janë mbledhur gjithë të vuarat, gjithë të qarat e një jete së gjatë.

Ky hi, ky tym më hyn në shpirtit, më duket sikur humba gjithë shpresat, gjithë gazet. Drita, duke ikur u fryn dhe i shoi, na la në kët'errësirë.

Po e sheh? Tani më s'duket fare gjësendi! a jemi në varr, apo mbi dhet? A jemi një i gjallë në mes të vdekurvet, apo një i vdekur në mes të gjallëvet?

Folmë, mik, se dua të dëgjoj zë njeriu, dua ta ndjej veten të gjallë; folmë, a do të mbajë shumë ky zi? Kjo natë a ka të sosur, apo jemi në atë natë pa mëngjes?

10 Vjesht' e II

SHKRETINA

Nga një herë jam si beduini në shkretinë. Më çdo anë shoh qiellin të fshetur në ran' e skuqur: kurrkund një nisi shprese; tekdo një qiell i përvëlur, një tokë shterpë dhe të djegur.

Po ndjek udhën, i prirur prej yllit të venitur që më rrëfen shpresa ime. Po eci oj, dit' e natë, dhe shumë herë këmbët më gjakosen.

Ku vete? Atje tej, më tutje se kjo ran' e shkretë, m'at' anë këtij qielli të errët, po shoh një qëllim; ylli im po më rrëfen një udhë.

Po dal! Një zë më pyet: është një qëllim ay apo një mirazh?

Edhe shumë herë jam si beduini në shkretinë.

4 Vjesht' e III

Oh, jo, nuk lë gjësendi, po zemrën time të tërë.

Pandehnja se kjo zemër ish shurdhuar, ish verbuar. Kaq vuajtje më dukesh se më s'i kishin lënë shpirtit.

Më ngjalle nevojën e dashurisë, më dhe gjithë të dhëmburat, gjithë ndjenjat e saj.

Një herë besova se çdo gjë u shua dhe u çduk rreth meje. Një shpresë e fuqishme më erdh në zemër, më rrëmbeu me krahët e saj..

Sa lark jam tani prej teje, o e dashura ime! Ato orë t'ëmbra, ata ëndërrime, apo qënkan ëndërra?

Lemë të vuaj! Mos u qa. Se zëmra më ka nevojë të ndjejë dhe të vuajë. Mos mallko orën që u njohmë. Bekoje atë orë.

E sheh? Ka njerës që janë bërë për fat të mirë dhe për dëfrim.

Unë jam për vuajtje. S'e di ç'është gëzimi. Po mos më qaj. Se në vuaj sot po vuaj prej teje.

4 Vjesht' e III

TYM' I CINGARIT...

Tym' i cingarit, i hollë dhe i kaltër, bënte rrathë, ngjitesh përpjetë, thellohesh më tepër, pastaj tretesh, çdukesh.

Me një sy të qetë po i shikonte këta rrathë, këto vija. Një dehje e hollë, e lehtë, i kishte pushtuar shpirtin. Ish si një orë ëndërrimi, me një gjysmë gjumë t'ëmbël.

Isht' e qetë pasdreka sot që bën kaqë vapë. Jashtë dielli po djeg e po zhurit; këtu një hije e freskët. Pranë tij, pështetur në fletët e gjelbëra të njoma, mbi tryezën, është kafeja e zezë, me aromën e kandshme.

Hoqi edhe një herë prej duhanit. Shikoi kafënë, zgjati dorën. Po s'e shpuri në gojë lëngun e hidhur kaq t'ëmbël.

Tani dy sy të zes ishin çfaqur përpara. Dy sy nënë një pyll lehra të zeza, me një shkrepim margaritari në mes të

buzëvet; një qeshje në të cilët grua e dashur vë gjithë flakët e dashurisë.

Tani më s' shihte gjë. Kapakët e syve i unji, i shtrëngoi sytë, sikur deshte ta marrë brenda në shpirt të tij fytyrën e dashur, ta marr në të thellë të krahërorit. Një psherëtim' e madhe i zgjeroi brinjët, në një frymë të thellë.

Po ç' ke mik? Pse ky ndryshim përnjëherë? Të dy syt' e zes u çdukën atë çast. Dy sy të hekurtë po sheh tani, dy shkëndija të ftohta, bërë prej një tufë lulesh të shtrënguara në një copë dritë.

"Nuk të dua" i kishte thënë, dhe këto fjalë i dukeshin të pakuptuarshme. Në dashuri t' ashpër të tij, ku kishte vënë gjithë zjarrin e shpirtit të tij, i dukesh që edhe ajo nuk mundte që të mos e dojë.

Edhe i pa t' ecurit e saj, shtati i gjatë - dhe kaq i bukurë - që po i valonte duke u mërguar. Kish pritur se mos kthehet mos hedhë një vështrim prapë.

Tani më s' i mbylli sytë. Po shikonte me vërejtje të madhe, sikur kërkonte një gjë n' erë. Po e shikonte që po largohesh, po ikënte, për të mos kthyer kurrë.

Nga cingari më s' dilte tym. Një hi i zi kishte rënë përposh.

16/29 XII

PSE TE SHOH TE BRENGOSUR

Pse të shoh të brengosur, mike? Të shoh ata sy të mëdhenj të mejtuar, ata sy të mëdhenj që më duken si një natë pa funt, një natë mbi të cilët shket një flak' e hollë.

Pse ma ke të vrenjtur ballët? Ç' është mejtimi që të ka rënduar mi këtë ballë të drejtë?

Dëgjo. dua që syri yt të jetë i qetë dhe pa re, si nat' e

verës, nata që lajmon mëngjes e ëmbël.

Dua që n'ata syt' e tu të mëdhenj të vij dhe të gjej prehjen, si udhëtar i lodhur në kroj i ëmbël, si në hije freskë në vapë të korrurit. Dua që në syt' e tu të harroj gjithë vuajtjet, gjithë lodhjet.

Leri bregat dhe pikëllimet për ne burrat. Lena në hidhërimet, se t'i dua që të kesh vetëm qumështin e jetës.

Se ti, grua, do të na lehtësosh barrën e jetës. Ay vështrim, ajo qeshja jote do të na japë fuqin' e vuajtjesë.

Arrin për ne brenga dhe helmi. Se grua, ti duhet të jesh me dashurin' e qetë tënde, shpirti ynë. Mëmë, duhet që prej teje të lint një djali pa vrerë dhe pa pikëllim.

21.XII.

MOT' I RI

Ika, ika. Qofsh' i nëmur ti që vjen të më urosh motin ri.

Një mot akoma! Edhe me qeshje në buzë, me urime vjen të më thuash se m'u pakësua një mot, më thua për shumë vjet.

Dymbëdhjetë hëna! si dije më duket ay që shkoi, pasta edhe ay më parë, edhe tjatri akoma.

Lumi që rrjeth lëshon zallin, delja që shkon lë gjurmën flaka që digjet lë hinë. Po ti, o kohë, ç'na le? A po këtë h mi kokët tënë?

Qysh pra, gjithë vuajtjet e mëmës sime, gjithë shpresa e saja, shpresat e mija, vuajtjet e mija, gjithë këto kështu do të shuhen?

Vargu i vdekjes po mbushet, kur imi çdo mot po afro

me të këputur. Edhe s' munt ta ndaloj këtë lumë, s' munt ta mbaj këtë jetë!

Edhe ti me ironi, më qeshje në buzë, vjen të më urosh. Ikë, ikë këtej, se s' dua urime unë, jam për rëkim.

1.1

ZEMER, PUSHO

Pusho, zemër, mos u qa! Mos më thuaj vuajtjet e tua, mos qa dhembjet dhe hidhërimet!

Rri dhe duro. Hiq në pushim çdo të keqe.

Pse të qahesh? Kur e ke druajtur vuajtjen, kur je hequr prej hidhërimit? A e ke ndjekur kurrë fatin e bardhë, a e ke dashur kurrë gazin dhe zbavitjen?

Ta kan' ardhur shumë herë pranë të mirat. Jetën munt që ta bëjnë t'ëmbël dhe të qetë si një burim t'ëmbël, si një vijë të kthjelltë.

Po, jo! Qetësisë, gazit dhe fatit, u ke rënë me këmbë. Ke kërkuar gjithnjë të paqenën, të paditurën. Atë që ke pasur pranë i ke shtytur, u je mërguar. Kurdoherë ke kërkuar një gjë më tutje; ke ndjekur atë të paqenën, të padukurën.

Se ashtu që ylli është bërë për të çkëlqyer, dielli për të ndritur, trëndafili për erë, zogu për këngë, zjarri që të djegë, edhe ti, o zemër, ke lindur për të vuajtur.

20.XI

AFREDITA E MILO-S

Fidia më s'pat prehje. Gjumi më s'i çlodhi sytë. Ngrënjes më nuk i gjeti shije. Një ethe çdo ditë i diqte dejtë.

Përpara shkëmbit të mermerit si shkumbë i bardhë, Fidia po punon dhe po mejtohet. Musklet e tij po i xhonglohenë nën çekanin e rëndë, një djersë ethesh po i kullon nga ballët, një zjarr po i ndriton sytë.

Edhe më s'pat prehje. Çdo ditë nga shkëmbi po dilte një formë e re. Punoi, punoi, akoma, me zjarrin e shenjtë... Kërkonte bukurinë, gjithënjë të ëndërruar, kurrë të parë.

Kur u-mbarua vepra, Fidia e shikoi me syt' e nxehtë, me ata sy që s'ishin lodhur kurrë. E shikoj akoma, edhe një herë, dhe i mbylli sytë, se guri i ftohtë j'u duk i gjallë, me një shpirt, me një frymë që s'i kish pandehur.

I lumtur Fidia, m'i lumtur se Hyji! Se mendja jote polli bukurinë e pa vdekur, gruan, gjithnjë të dëshiruarë, kurrë të gjetur.

4, 17 Vjesht' e III

Sadoqoftë edhe s'dihet mirë në Afrëdita e Milo-s është e Fidia-s a po jo. (Shënim i autorit)

NOVELA

PIKA LOT

Tet vjet pa dalë!... Ves' e natës akoma s'ish avulluar dhe shkëlqente mbi bar e mbi fletët, si copëza diamant mbi zymryd; era frynte mengadalë, po pak e ftohtë.

Meçoja qëndroi pak, lëshoi pushkën mbërthe, u pshtet më një shkëmb anë rrugës; gjithë, ç' i shihte syri i dukeshin të ra... dielli sapo kish dalë, lëshonte një dritë si të kaltërt, mbi lisat e këtij vendi t' egër; malet nga perëndimi, ngrinin majat e tyre madhështore gjer në qiej; këto maja ishin kurorosur me mjegulla të natës. Ish vjeshtë.

Meçoja psherëtiti; solli në ment jetën që po shkonte; vetëm, mbi këtë breg, midis lisave dhe shkëmbenjve, mendjes i pëlqen të mejtohet, zemra mallëngjehet.

Ç'ish ky njeri shtatmath, fytyrëbukur, po të verdhë, lesht e kokës hedhur mi supt? Mustaqet e mëdha i epnin një hije trimi, dhe bënin dy pyje të zes mi këtë fytyrë të verdhë; me të parë sytë që shikonin me t'egër dhe me druajtje, me të parë pushkën në dorë, pisqollat në bres dhe jataganë varur në rript, s'munt të themi se veçse është një nga ata njerëz fatkeq që rrojnë jashtë mbledhjevet njerëzish, që s'dinë ç'është fëmijë dhe q'ushqehen me të rrëmbyer gjën' e tjetrit; po në fytyrë të këtij burri, që dukesh t'ish nja dyzet a pesëdhjet vjeç, duke vështruar me re, zbulojmë një gjë fare tjetër nga egërsija që na u duk herën e parë: këta sy si të sylvërt e si të zes, që kishin një ngjyrë hekuri, kishin

një vështrim që dukesh i egër herën e parë, po më pastaj merrnin një butësi, një përkëdhelje, dhe një mejtimit i hidhur përshkruhesh nër ta.

- Ah! Tetë vjet pa dalë! - murmurisi Meçoja. Tetë vjet pa dalë jashtë shtëpisë; kisha harruar pothuaj si është pylli dhe ç'bukuri ka lindj' e diellit mbi këta male të lartë. Është rrotje kjo që bëjmë! Si sot e kam ndërmend, merrnim rrugë me tim vëlla, me tim kushëri, dhe me ata të Shelit; një zihje u ngrit midis tënë; Sheli shkrepiti pushkën, im vëlla ra pa shpirt... q'aher' e tëhu trembëdhet veta nga ne e nga Shelët flejtën për gjithmonë. Trembëdhet njerëz! pa ndonjë punë... Q'ahere u mbyllçë dhe më s'kam dalë; po gjakn, e fundit un' e kam mbi kurris.

Me çape të ngadalshë, zuri të marrë udhë; mori brinjën e malit; rruga shkonte nëpërmes të dushqve dhe të bredhave: dielli që lartësuar dhe një hosten... Përnjëherësh, duke kthyer nga një çip që bënte mali, një pamje e bukur iu çfaq: mbi fushët të vogël, atje poshtë kish rënë mjegullë, një mjegull' e bardhë; pandehte njeriu, se Meçoja ish një shkabë që fluturonte mbi këta re të rënë mbërdhe.

Mori udhë pa qëndruar; era po nxehesh, mjegulla - tret, dhe fush' e vogël dolli në shesh duke mbajtur një lumë t'ergjentë në mest të saj: ky lumë ish Drini i Zi, i cili këtu rrithte me qetësi.

- Tet vjet pa dalë nga shtëpija, thosh me vetet të tij Meçoja; sot pra, dalë për herën e parë; ime motër polli një djalë, më kish kërkuar të vete ta shoh. E gjora, kërkon të më bëjë që të dal nga burgu ku jam futur duke dashur vetë: **po nuk' e di, që mbase kjo ditë të jetë e fundit për mua!** nuk e di që mbase sot mund të vritem me Shelët dhe të më shpien kufomën tek ime motër! e varfëra ime motër, nga gjithë gjërit e saj vetëm mua më ka, dhe unë jam i vdekur për këtë botë! Kush e di me sa gas të madh më pret!

Një pikë lot i rrodhi nga sytë Meços! Kujtoi qysh kish rrojtur, sa kish vuajtur! qysh rronte tani si i vdekur dhe qysh s'ish sigur nga jet' e tij; vdekja i ish varur mbi krye me një pes të kalbur. Rronte si një hije, pa ndërë ndonjë

gëzim nga bota. Gazet, qeshjet, dëshirat, punët dhe kujdeset që na lidhin te kjo jetë dhe na bëjnë të duam gjalljen, qenë të panjohura për këtë që zakonet e vendit dhe egërsi e njerëzve e kishin bërë fatkeq. Ay mbyllur në shtëpi, pa parë gjërit e tij kaqë kohë, ish si një hij' e zezë. Vështronte bukurin' e vendit q' e rrethonte; dëgjonte zënë që bënëin fletët duke tundur nga era; shihte shkëlqimn' e Drinit, majat e larta të malit, kërcunjt' e lisavet... ah, fatkeqi, kish kohë pa parë këto bukuri, kish kohë pa dëgjuar zënë që nxjerrin degat kur i fërkon er' e veriut! I mjeri, sa e ndjente shijen e rrojtës sot! Sa i dukesh e bukur gjithësija; këta mejtime ja shtonin hidhërimin, se i sillnin në mend vetijat e keqe të njeriut, ato vetija që bënëin të heqi një njeri nga shoku i tij. Të rrojë njeriu si i shuar; mos guxojë të dalë jashtë, të vejë të shohë t' afërmit dhe të marrë pjesë nga gëzimet që Zot i math përhap mbi botët të tërë! Ah, sa e bukur është bota! gjithë të këqijat i bën vetë njeriu! Për pak gjë, fare pa shkak, zihet, vritet.. Dielli dritën e ergjëntë, bima kallin e florintë, lulja erën, zogu këngën, na i ep vallë që të kemi zihje dhe grindë midis tënë?

Udhëtonte duke mejtuar, sytë poshtë, kur përnjëherë, m'anë të djathtë të rrugës - u dëgjua një zë: fletët u drothnë; Meçoja me vrap unji pushkën nga supi, u bë gati; pastaj zuri qeshi, se kupëtoi më ç'anë vinte zëri; disa turtuj trëmbur nga udhëtari, fluturuan me tmerr! Meçoja u qas atje ku kishin qëndruar turtujt: nj'uj' i kulluar buronte; rreth krojt bari gjelbëronte; e kish marrë etje se ish vapë, ish lodhur se kish katër orë q'ecëte; u unj, piu nj'ujë të ftohtë, ndënj të çlodhesh; ahëre kupëtoi q' e kish marrë dhe uriya; nxori nga trasta buk' e djathë.

Si u nginj piu dhe nj'ujë, pastaj i çlodhur, nisi prapë udhën; rruga ish e ngushtë, tërë gur; m'anë të djathtë ish pyll dhe driza; aty këtë ca shkëmbenj të mëdhenj; m'anë të mëngjër zgjatesh, atje poshtë, fusha me ca fshatëra që dukeshin fare lark, dhe majat e maleve të lartë i bënëin një mur kësaj pamjeje. Dielli qe ngritur gjer në gjysmët të rrugës qiellore që përshkon ditë- për- ditë. Meçoja arriti

më një vënt të rrugës, ku ajo zgjatesh shumë pa ndonjë gjë përpara; atje udhëtari ynë pa se largu dy njerës që po vinë drejt tij. Që kur kish dalë nga shtëpia, s'kish hasur njeri, andaj një dridhje i eci në tërë trup; tetë vjet pa dalë nga shtëpia dhe pa parë njeri të huaj, e kishin bërë të ketë dyshim e frikë dhe nga një hije; për fat të mirë, ca driza ndërmjet të tij e të dy udhëtarëve, bënë q'ay i shihte mirë, po këta s'e shihnin dot.

Meçoja e pa t'udhës të hiqet më nj'anë të rrugës, të fshihet prapa një shkëmbi, e të pres sa të largohen të dy udhëtarët.

Vate prapa shkëmbit dhe zu të mejtohesh, i kish harruar fare udhëtarët, po kur ngre sytë ata i pa t'afruar afro një qind çape. Përnjëherësh u droth; u verth; fërkoj sytë që të shohë më mirë.

- Ay është, ay thosh me vete të tij. Po, ay Tafë Sheli; gjaksori që më vrau vllanë... ay tjetri është Gjoka, një katundar.

Ahere një nga një i erdhë përpara syvet ngjarjet e tetë vjeç më parë qysh Tafë Sheli i ra të vëllajt, qysh ky volli një gjak të zi nga goja dhe ra mbërdhe; sa vrasje që ngjan ndërmjet të tij dhe të Shelëve i kujtoj një pas njëje; jet' e zezë që kish rrojtur nga shkak' i kësaj vrasje, j'u duk sot m'e tmeruar dhe m'e errëta; dhe gjithë këto të këqija për shkak këtë njeri që vinte drejt tij.

Ç'do të bënte tani Meçoja? ç'kish për të bërë? Meçoja s'mënoi aspak: vëllaj tij duke vdekur i kish thënë: "Meço, mos më lërë pa shpaguar!" fytyr' e këtij vëllaj tani i çfaqesh përpara dhe sikur e shtynte të mir shpagën e gjaksorit të tij. Meçoja s'mënoi pra: mori pushkën në dorë, e vështroi një herë, a ish mbushur; nxorri dhe pisqollat: u bë gati për luftë; më parë i kish për të rënë gjaksorit të vëllajt, pastaj, në duhesh do t'i binte dhe Gjokës, dhe kështu do të shpërblehesh gjaku.

Pshteti pushkën në supt, vuri grykën mbi shkëmb; vuri veshnë se dëgjoi që udhëtarët kuvendonin. Gjoka i thosh Taf Shelit:

- Kështu pra, ke shumë kohë pa ardhur në shtëpit tënde?

- Tet vjet, ah, tet vjet! që kur ngjau një vrasje ndërmjet tënë dhe të Meço Gurit; n'atë ngjarje, që ish pothua pa ndonjë shkak, u vra i vëllaj i Meços dhe Meçoja vetë u plagos; q'ahere e tëhu kam qenë larg Shqipërisë; ah, sa më kish marrë malli! s'kisha më shpresë të shihnja këta vende të bukur, këta male majëlartë ku kam shkuar djalërinë time...

Meçoja tani po mendonte; dora i dridhesh; ish i verdhë sikur kish dalë nga varri; s'shihte kulluar. Një pikë lot i rrodhi nga sytë.

Ç'e gjeti pra Meçon? a u - trëmb? ay që ish kaqë trim dhe që shënonte aqë mirë? një ditë - kishin shkuar katërbëdhjetë vjet, që nga ajo ditë, - më një dasmë, kish dalë i pari me të shënuar dhe kish fituar një dem të bukur!

- Tet vjet pa parë këta vend! tet vjet pa parë njerëzinë time! pa nisur për këtu mora një letër nga im' atë, nga plaku i varfër që më thoshte se fëmija e tërë, mëma, ime shoqe, motrat dhe djemtë q'i lashë të vegjël, dëshërojnë të më shohin. Ah, ku na shpie marrëzia jonë, sa të këqija i bëjmë shoku shokut nga...

Nuk sosi; një klithje dolli ng' an' e rrugës. Të dy udhëtarët u tmerruan. Meçoja kish flakur pushkën, kish dalë mbi rrugët dhe, me krahë hapur:

- TafShela! - thërriste, unë jam Meçoja; gjer më sot janë vrarë trembëdhjetë njerëz nga shtëpia ime e nga jotja; lotë që kanë derdhur shtëpit tona bëhen sa ujët e një pellgu; gjithë gjithë këto fatkeqësi vinë, siç e thua edhe ti, nga marrëzija jonë! unë po ta fal gjakun, falma dhe ti! eja të pajtohemi!

Tani s'ish vetëm Meçoja që kish lot në sy; po që të tre këta burra qanin si gra, dhe putheshin si foshnja.

Gjoka duke rrjedhur lotë thosh:

- Rroftë dashurija! rroftë shpirtmadhësija!

21 Gusht 1899

KUSH E KA FAJIN?

Moti njëmij' e tetëqind e nënd-dhjet e tetë, u bë mot i zisë për shumë vise të Shqipërisë. Mon e parë ngjau lufta ndërmjet Turqisë dhe Greqisë; njerëzia van ushtarë dhe kafshët e tyre merrte me pahir qeverija për të ngarkuar të duhurat e ushtrisë.

Burrat që van' ushtarë si ndenjné disa muaj në punë, u kthyen prapë në shtëpi të tyre, po me një hall q' e shoqe dhe em' e tyre më s' i njihte: lëkur' e eshtër dhe lakuriq! Si rrinin n' ushtri urët e pastrehë, lëshoheshin lakuriq, se rrobet e çqyera q' u epte qeverija sa ishin në shërbim, ja u mbante prapë. Bukë me të shumë, s' gjenin n' ushtrit, po duke vjedhur nginjnin, jo nginjnin po mbanin pak barkun! Sa hoqnë këta të mjerë shqiptarë që vanë të lëftojné me armikn' e mëmëdheut të tyre, dhe sa të paudha e punëra të papëlqyera punuanë mb' udhë dhe në vënt të mundur! Po kush e ka fajné? Eshtë ushtar, nuk ka të hajë: vjedh gjën' e fshatarit të varfër; urija s' dëgjon këshillë! Pastaj, kur vjedh pashaj, ç' e mban neferë?

Në Janinë shiteshin kuajt' e qetë për pesë grosh; ay që i shitte thërriste: Ka kocka, lëkurë, edhe pak shpirt! Nga Manastiri e në Janinë mb' udhë duhesh të zinje hundën se ish plot kërmë kuajsh e qesh. Më të shumë e fshatarëve lidhnin kafshën me një dru, dhe thoshin që s' ish e tyreve; se qeverija mirrte kafshën dhe të zonë që ta ngasë; "Në Janinë do të març të hollat" i thosh; po kur arrinin në Janinë, kafsha, ka a kalë qoftë, që kish ecur një tok udhë pa çlodhur e pa ngrënë, s' kish fuqi të bënte asnjë çap më

tej, dhe shitesh për pesë grosh; këto të holla i merrte zabiti!
I zot i kafshës kthehesë zbathur e i rreckosur në shtëpi dhe
dy muaj me rradhë shihte ëndërr sikur vinte n'angari.

Mon' e dytë s'u bë drithë: s'kish as ka, as njeri që të
lërojë dhenë!

* *

Tafili ish fort i varfër, si më të tepërit e shqiptarëvet; sa
kish të vëllanë punonte dy tri ara, mbante ca krerë dhën;
shkonte jo dhe keq; po tani që ka të vëllanë ushtar, është
fare keq; arat ishin pa punuar nga dhëntë kish therur tri.

Një ditë i thotë së shoqes:

- Ajo dhi me vesh të zes s'është.

- Na i vodhë! thërret e shoqeja e tmerruar, se një dhi për
një fëmijë të varfër është pun' e madhe.

- Ashtu duket, edhe më ngjan që ta ketë vjedhur Sinani.

- Oh, qoft' i mallkuar! më kish ardhur aq keq për të!
vajç' e pashë fëmijën q'ish urët e lakuriq. Po këtë nuk marr
vesh qysh e muar ushtar, me qënë se është' i vetëm dhe
s'kish kush të shikonte t'ëmën dhe fëmijën. Të shihje sa
kishin mbetur për lumë! Unë u kisha dhënë ca pastërma e
misër; edhe ay guxon të na vjedhë dhinë!

- S'jam fare sigur, po kështu më duket.

Pas ca ditësh Tafili i thotë së shoqes:

- Grua, po deshm' e i ram' më qafë Sinanit, dhija është
vjedhur prej të tjerëve, po s'e di prej cilit. Tani kemi vetëm
tetë dhi.

* *

Nga të tetë dhinë, dy i therrë për pastërma; e shoq'e
Tafilin bëri ca petë, ca bollgur, ç'lipseshin për dimër. Tafili
ng'ara s'mori gjë të madhe, se më nj'anë s'e kish punuar

dot të tërë, m'anë tjetër s'kish rënë shi. Një ditë u përfol pak me të shoqen, se kjo i thosh që sikur të kish punuar ca më shumë, dhe të mos ish përtac, do mirrnin më tepër drithë. Tafili u zemërua pak, po kuptonte që të drejtën e thosh e shoqeja.

Dimri po qasesh, kohët zunë të prishen. Tafili vinte të bënte dru për vatrën dhe gjethe për dhitë, kur të mos dalin dot nga dëbora. Kthehesh më shtëpi i lodhur, i këputur. Të ftohtët nga një herë ndjehesh mjaft i fortë, dhe lara dhe rrobat i ishin grisur! Sa mundime hiqte i mjeri n'ato baltë, n'ato udhë të këqia! e ç'udhë? ashtu si ka bërë Perëndia, sa edhe dhia mezi shkonte. Kur vinte më shtëpi, sikur ta pritte ndonj'e mirë! ah, jo, as në shtëpi s'kish ndonjë prehje; atje i dukesh halli m'i zi, se kish kohë të mejtohesh. Sa herë i ish mërzitur shpirti për të cilin hiqte gjith' ata mundime! Sikur të qe vetëm, - s'do t'ish aq fatzi, po e varfër e shoqeja...

Një ditë kthehesh nga puna, kërcinjte në baltë, kurriz' i qullur nga shiu, duart të rjepura; n'atë ditë të vrenjtur e me pak shi, mësoi që kish ardhur koshadheja për tahsil.

Vetëm emr' i koshadhes arrin për të shtënë tmerr në zemrat e njerëzvet të varfër... edhe në të pasurët: të varfërit kanë frikë se do t'i shtrëngojë për pagesa; ata që kanë pakë gjë, kanë frikë se do t'ushqejnë ata njerës "me rroba të zeza" që s'ngjinjen kurrë!

"Njerës me rroba të zeza, njeriu i mbretit", sa fjalë t'egëra! foshnjat kanë frikë nga gogoli, të mëdhenjtë dridhen nga këto fjalë! edhe ata njerës me të zeza si luvgetë, kanë qenë shoqt e fshatarëve gjer dije: tani të pinë gjakun.

Bota fëshëllinin vesh më vesh: Paska ardhur tel te kajmekani që të mblidhen shpejt të hollat, se paskëshin nevojë të madhe në Stamboll. Nuk' e di për ç'punë duhen të hollat, dhe do të dërgohen të tëra në fshat të math.

Zaptijet rrinë disa ditë në fshat të Tafilit; mbledhin ca të holla ng'ata që kanë, marrën ca ryshfete nga të varfërit

që s'kanë gjetur dot mjetin për të paguar, dhe hiqen më një fshat tjetër.

Po, pa shkuar shumë, çaushi me zaptije të vijnë prapë, dhe këtë rradhë pagesatë duan numëruar!

* *

Tafili bën hesap me të shoqen sa ka për të paguar. Kish një herë të hollat për udhë; të dy vëllezërit nga 12 grosh, bëjnë 24; të gjashtë ditë nga katr' e gjysmë, njëzet e shtatë grosh; po m' e rëndë qenë pagesat e arës; qeverija kish bërë hesap sa ipte ara, kur punohesh mirë, dhe nuk shihte që këtë mot ish zi: arat kishin mbetur lëndinë dhe kohët kishin vajtur liksht.

Çaushi po e shtrëngonte Tafilë; ky çaus kish qenë armik me Tafilë dhe kërkonte t'i nxjerrë hidhërimnë; i flitte shumë dh' e trembte ta shpinte në burg në Kazat.

Në shtëpi që mirr erë më të katër anët, me pakë zjarr në vatër, më një kohë të ftoht' e me dëborë, Tafli mejtohesh me të shoqen.

- Ndryshe s'ka ç'të bëhet, tha e shoqeja me zë të mallëngjyer; sot është dita që do të na shtrëngojnë për herën e fundit, dhe më s'na presin. Ka dy muaj që po presin: sot, sido të jetë, duan paguar.

- Do të vete te Dajlani; them se ay do të m'apë gjë hua; në mos gjeça nga ay do t'i bije murit me kokë, do bëj si të bëj e të gjej hua, se e kemi fare keq.

Hodhi larën mbi shpatullat, mori pushkën nënë sqetull.

Me kokë t'unjur, i mejtuar, e me helm në zemër, çapëtonte nëpër mes të fshatit. Shtëpit q'u shkante pranë dukeshin veshur në zi.

Arriti në ndënjët të Dajlanit. Kjo shtëpi ish pak m' e mirë nga ato që kish afër.

Tafili i thirri nga dera. I zot' i shtëpisë' e thirri brenda.

- Tungjatjeta Dajlan! tha Tafili; vij të lutem për një

punë.

- Mirserdhe, Tafil; ç' do? n' e kam në dorë...

- Më kanë shtrënguar për pagesat; e di edhe ti se sa i kanë pa udhë këtë mot; me t'udhës, me xhelep, me të dhjeta, me ato që na marrën për shkolla, më bëjnë më tepër se një qind grosh! a munt të më huash kaq të holla, pa nga moti që vjen t'ia ap me faide, se ahëre më vjen vëllai, shes dhe ca kecër e të pagoj huan.

Dajlani mbet i mejtuar.

- Dëgjo, Tafil; më vjen liksht që s'të kam për të bërë dot kaq punë; mbase s'më ke për të besuar që sot jam pa një ovull. Vërtet kam dy vëlleqër në kurbet pranë dy bejër, po që të dy kanë kohë që s'më kanë dërguar gjë, se dhe vetë s'kanë marrë rrogën. Veç kësaj, ca të holla që paçë i dhashë për pagesa, edhe - këtu Dajlani unji zënë - të them ty se të kam mik, pesë ditë më parë i dhashë H. beut gjashtë lira; se më thirri e më tha se më kërkonin ushtar vëllanë që kam këtu; më tha që n'i dhënça gjashtë lira do ta shpëtojnë. Mbase s'ish vërtet që ma kërkonin vëllan' ushtar, po beut i duheshin të holla; ka urdhër nga mbreti që të japin iane, domethënë të ndihin me para gjithë bota, dhe këto para thonë që do t'i prishin për ushtrinë' pra, beu s'i mbet keq... Ç' të bësh Tafil, i forti ha të dobëtin, shkaba ha pulën, ujku ha delen.

Tafili u mallëngjye; Dajlani ish shpres' e fundit për të. I mjeri sa ish për lumë! do t'i vinte dhe ati në kokë, ç'u kish ardhur kaq të tjerëve, do t'ia rjepin shtëpinë e ta lënë kërcu.

- A munt t'i kërkoj Kolës? dëgjova q'i ka ardhur i biri nga Stambolli, dhe do t'i ketë sjellë ca të holla.

- Vërtet Meçi i solli nga Stambolli ca të holla, po nga ky shkak duke dëgjuar këtë, myltezimi i kërkoi tri lira të dhjeta për një selishte që ka përpara shtëpisë! veç kësaj i varfëri Kolë, ushqeui katër ditë zaptijetë, në shtëpit e tij.

*) Këto pagesa janë ato q'u mblodhë me mijëra lira në Shqipëri, nën emër iane-i-asqerie, dhe veç djalli e di më ç'verë vajtnë. (Shënim i

autorit).

Tani s'më duket t'i ket mbetur gjë. Po në më pyeç mua hiq dhe kërko nga beu, ay munt të t'apë.

Tafili, m'i helmuar akoma, mori rrugën e shtëpis' së beut; kjo shtëpi ish e madhe dhe mbi një brek. Kur j'u qas i rrahu zemra: oh, sa herë kish ardhur në këtë shtëpi, për punë, për të gjitha herët me dëm kish dalë.

Oborr i shtëpisë ish tërë baltë; një tok dhoga të thyera e plaçka të vjetra ishin hedhur andej këtej.

Nga ahuri dilte një zë i pakupëtuar; kur hyri n'odët, bëri një tok kohë sa të çquajë ata q'ishin brenda; oda ish plot tym, nga vatra e nga cigaret e trimavet. Trimat ishin disa rjepacakë, që rrinin te beu për bukë goje. Dhogat e odës kishin një pëllëmbë baltë.

Tafili u dha të falur trimave dhe ndjenj mënjëanë. Ata bënë sikur nuk e panë, dhe s'e prishnë të qeshurit e të kuvenduarët.

Tafili i shikonte me rradhë, po sytë j'u qepnë mbi Shabanë; ky ish trim i vjetër i beut; i kishin frikë gjithë fshatarët, se bënte ç'donte: beu e dëgjonte, dhe kajmekami ish mik i beut.

Shabani po i rëfente një gjë shokut që kish pranë dhe i thosh: - E dëgjove që Sulo Çaushi ka mbledhur në këtë muaj më tepër se njëzet lira, për vete të tij? Sa janë të lumtur zaptijet! vërtet kanë rrogë të pak, po me një të dalë për tahsil, me pak të shtrënguar fshatarët, mbushin xhepin me lira! i thashë beut që të shkrojë tim vëlla; më ka dhënë fjalë, po të shohim.

Tafilit i dridhesh mishtë duke dëgjuar këto; si priti dhe pakë dolli beu; vajti n'odët.

- Tungjatjeta bejm t'u rriçin ditët!

- O, mirserdhe Tafil, pa të shohim ç'është? - pyeti beu gjysmë me të tallur.

Tafili j'u qas beut me të dridhur; ja tha me pak fjalë e me zë t'unjët hallin, dhe ju lut t'i huante pesë mexhitka.

- Të të them, tha beu; tani edhe unë jam pak shtrënguar...

- Të lutem shumë, bej, se sot është dita edhe më s'më presin! më kanë ardhur kaqë herë, më kanë shtrënguar, unë me sot me nesër i kam mbajtur.

- Në ke gjësen të lesh penk munt të të gjej të hollatë që kërkon, po ndryshe nuk munt.

Këto fjalë të fundit beu i tha me një zë t'ashpër, dhe Tafili kupëtoi që të luturët më tepër s'hynte më ndonjë punë.

Me nxitim kthehesh më shtëpi. Po mejtohesh të lërë penk te beu ca plaçka të së shoqes, koburen dhe sahatin, një sahat të vjetër, që ia kish lënë i ati. Ish më të ngrysur; nga perëndimi afër qarkut ish hapur qielli dhe buronte soje një drit' e kuqe. Dëborë kish mbuluar dhenë, po të ftohtët ish zbutur se kish pushuar era.

Kur hyri në shtëpi Tafili mbet si i ngrirë: asnjë plaçkë s'ish në vënt, sikur kishin hyrë kusarët; e shoqja qante me një çip.

- Ç'është? pyeti Tafili me të çpejtë.

- Nukë sheh? tha e shoqeja; zaptijetë erdhën prapë; u thashë që keshe dalë, po Sulo Çausi nuk besoj; rëmuar gjithë çipat; si s'të gjenë, muarë dhinë, tenxheretë, ç'gjenë, dhe po i shpien në hyqmet.

Tafili mbet pak si i trullësuar, nuk kupëtonte dot ç'ngjau; nga pak nga pak erth në mënt, shturi një sy të pikëlluar, në këtë shtëpi q'ish tani si e shkretë; pastaj përnjëherësh j'u qas së shoqes, e puthi në ballë, gjeç i tha me zë të ngadalshëm, dhe dolli jashtë portës.

Tani ish afro fare errët; nga perëndimi sa vinte qielli çelësh më tepër dhe rrëfente që do të bënte një nat' e kthielltë po e ftohtë. Këmbët e Tafilit bënë zë mbi baltë e mbi dëborë, po ca më pastaj u shua dhe ky zë. Tafili humbi në t'errët.

* *

Nja dy muaj pas kësaj ngjarjeje që rrëfyem, më një fshat afër atij të Tafilit, dy çupa të ra kuvëndonin më nj'odë. Pranvera kish ardhur me gjithë gazet e bukurit e saj; dheu gjelbëronte, drurët veshur; ca lule zbukuronin luadhet; zoqtë këndonin e ja thoshnin, të dehur nga ngrohtësia, nga drita e nga ushqimi q'u sillte moti.

Si zoqtë mbi degët, ashtu bylbyronin dhe të dy çupat brenda në shtëpi.

Njëra ng'ato po qëndiste një gjë të bukur, me shumë kujdes.

- Siç duket këtë me kaqë kujdes, po e qëndis për pajën tënde, i tha shoq' e saj.

Ajo u kuq; edhe këta të kuqur ja shtoi bukurinë.

- Akoma s'kam nisur, tha.

Pastaj për të trazuar fjalën, hapi një tjetër.

- A e di, Diliko? njëditzaj iu- dëgjua që Sulo Çaushin e paskan vrarë, edhe duket q'i shoq i Minekos, Tafili, e paskësh vrarë. Sulua qënkësh armik me Tafilë, dhe këtë dimër paskësh vajtur në shtëpit të tij për tahsil, e paskësh punuar njëmij... E varfëra Mineko, është në derë të tet. Tani si u bë kështu, më s'e ka për të parë dhe një herë të shoqnë; po edhe për Sulon më vjen keq, se la një çupë kaq të mirë!

Dilikoja unji kokën dhe mejtohesh; pastaj tha si me vete të saj:

- Sulua a Tafili, kush e ka fajnë?

Vjesht' e fundit 1900.

TMERRI

Mbrëmanet kishim kuvenduar me ca miq për punët që ngjajn' në Shqipëri, për vrasjet që bëhen në vend tënë, për varfëri dhe për fatkeqësi e kombit tënë.

Pastaj thamë se frikë kanë marrë bota për të kënduar gjuhën e tyre. Miku im më tha që, ca ditë më parë, kishin zënë një shqiptar dhe e kishin hedhur në burg nga shkak që kish ca libra shqip.

Mbi këto u ndamë, vëmë të flemë, se dhe ditën kishim ecur' dhe ishim lodhur shumë. Ish natë vere, nat' e nxehtë, shumë e nxehtë. Pas nja dy orë gjumi, u zgjuash prapë; kisha një zagushi të madhe. U ngriç nga shtresa, hapë finestrën: yjtë shkëlqenin më një qiell pa hënë. Nuk e di sa ndënjta përpara finestrësë, po më duket se pa shkua shumë më zuri përsëri gjumi.

Po nxitonja dhe qeni po më ndiqte. Nxitonja me vrap të madh dhe s'guxonja të kthej sytë nga frika se mos i shoh gojën e kuqe dhe syt' e zjarrtë që i ndritnin në faqet së zezë.

Mora një të përpjetë; dheu ish gurishte: qeni ish një pesëdhjetë çape lark meje, po unë e ndjenja që, sa vinte kafsh' e egër po më qasesh. Tani më dukesh sikur frym' e tij më diqte krahët, aq e pandehnja afruar; kisha zënë dhe

të lodhem, mushkëritë m'ishin ngusur, mezi mirrja frymë; po prapë vraponja me akull në zemër.

Në kryet t'udhës që ngjitesh, ishin një tok driza e ferra edhe rruga pritesh; po në mes të drurëve të vegjël kish një shumic' udhësh të ngushta. Shpejt u fuçë në mes; degët e feravet piqeshin nga maja; unë nga nxitimi s'shkonja gjë, po vraponja si i marrë, edhe majat e degëvet dhe gjëmbat më çirrnin turinjtë, më gjakonin faqet.

Përnjëherë ndjeva sikur më ra një poplë mbi kokë: një deg' e trashë më kish prer' udhën; shpura dorën në ballët; ndjeva një qull të ngrohtë dhe një plagë të hapur. Pa dashur qëndrova, kërcinjtë m'ishin prerë, mushkërinjtë më s'punonin, zëmra më rrihet dhe më bënte plagë krahëror. Me tmerr të madh hodha sytë prapa, po qeni nuk ishte, as zëri i dëgjohesh; kuptove që kafsh' e ndyrë më kish humbur toruan dhe mora pak frymë.

Më të katr' anët kisha driza dhe gjëmbe, degët e të cilëvet ishin pleksur si fije hekuri; drit' e diellit hynte me mundim, dhe ca lule t'egëra mezi çquheshin. Plag' e ballit dhe të

çjerrurat e turirit po zënë të më djegin, po prapë jam i lumtur se shpëtova nga ndjekja edhe nga goj' e kuq' e qenit.

Një zë në mes të ferravet më bën të kthej kokën. O tmerr! Qenin që pandehja se shpëtova soje, qenin në dhëmbët e të cilit m'ish varur jeta, tani e kam përpara!

Më s'paçë kurajo as t'iknja, as të thërrisnja; sytë m'u errë, laqet e këmbës m'u zgjidhë, mbeçë si i ngrirë! tani më s'shihja gjë, vetëm veshët më dëgjonin një të lehur me një zë të mbytur, dhe - sado që sytë s'më shihnin, më dukesh se qeni më skërmitte dhëmbët dhe po bëhesh gati të më hidhesh. Oh, qysh po ja ndjenj dhëmbët që po më coptojnë supnë sa i shëmtuar të lëpirat e gjuhës dhe të çqyerët e dhëmbëvet.

Of, sa ëndr' e ligë! Me sa gas sheh njeriu që duke hapur sytë, gjith' ajo hije e zezë fluturoi. Tani e marr vesh pse më dukesh sikur po më shqyente qeni; supi m'ish mpirë! Po hieja akoma s'u zhduk, se prapë dëgjoj qenë që leh, dhe tani po leh me një zë të çqyer, dhe t' egërsuar. Ç'është kjo, ç'është ky qen? Eshtë qeni ynë. Po pse leh, kujt i leh?

Me një tmerr të ri u-ngriçë, se tani një tjatër mejtim m'erdh në mend: kush ka ardhur afër shtëpisë, në mes të natës?

Kurdoherë që leh matanë, pa dashur më dridhet trupi; gjithnjë dëgjojmë që ven' natën dhe shkelin shtëpin' e njerit e të tjaterit, zënë botën në gjumë dhe i shpien në burg. Vallë dhe sot mos erdhë të na shkelin shtëpinë? Një fërshëllim' e hidhur dreth napën' e zezë të natës! A nuk është kjo fërshëllimë e polisit që breth natën!

Ngrihem, dal në ballkon dhe shtie një sy në kopsht; s'ka njeri! Qeni po leh afër portës dhe me zemërim i sulet murit. domethënë jashtë murit ka njeri, vallë se mos duan të thyejnë derën, të vinë të më ngren' nga shtresa dhe të më shpien më një vend me lagësirë, me krimba e me minj? Po, na qeni e zbut zënë, pakëson të lehurit, pushon, edhe shoh që d' njerës, me çape të qetë, largohen nga mur' i kopshtit.

Tani pra hieja u- hoq fare, s'kam më ç'të trëmbem. Mënd të marrë frymë çliruar.

Era ish ftohur, ndjenja të mardhura. Hëna, më të mbaruar, kish dalë, dhe cop' e verdhë dh'e zbet' e saj çkëlqente mi një pirq plepash, që ngjiteshin lart në qiell si luvget' të zes. Më tutje, në mes të detit, drit' e hënës, binte mbi ujë dhe ay vend dukesh si shpuzë në mes të hirit. Një

qetësi, një pushim i madh mbretëronte tani; dukesh që gjithë ç'ka në botë po flinin; vetëm yjtë në qiell që kapsitnin sytë.

* *

Në mëngjes pa nxehur koha, dolla të bëj një shëtitje të vogël. Sa ëmbëlsi ka shëtitj' e mëngjesit në një fshat!

Ecnja më një udhë të ngushtë, anosur me drur dhe me gjelbërim; këtu këtje kish lule me ngjyrë dhe m'erë të bukur.

Më nj të kthyer t'udhës pashë një mik, që kish dalë dhe ay për të gëzuar nga thjeshtësi e erës dhe nga bukuria e barit dhe të drurëvevet. Pas nja dy fjalë, miku më tha përnjëherë:

- A e mësove që mikun tonë.. pardje e zunë dh'e hodhë në burg?..

Hij' e natës s'ish akoma çdukur!

1905

I.

U D H E T I M

- Nesër po nisen Rrapushi, Hodua dhe shokët, dhe mua më thanë të jem gati.

- Nesër, biro do shkosh dhe ti me uratëzën e Perëndisë, tha e ëma me një vështrim të mallëngjyer. Nesër.

Këto fjalë bëheshin më një shtëpi të vogëlë mb' anë fshatit. P...; dhoma ish e vogël, e shtruar varfërisht, po e pastër; vatra ish zbardhur, e re me këlqere, një vatr' e bukur me gllanik të zbrazët, se vera kish ardhur dhe të ftohtë ish hequr. Më një tavlë mbi vatrët ish një kanaçe prej bredhi, stolisur me peronda e me yj të verdhë, me rradhë të gjerë dhe me një zënje bërë prej tri fijesh të verdhë, të pleksur si një gërshet e artë. Afër kënaçes një pllockë bërë dhe ajo me shumë stoli, e gdhendura në dru: ca fletë të holla në të cilat ishin pirogusur lëndë dushku; këto të gdhendura ishin bërë me hollësi dhe dora q' i kish punuar, do t' ish e djathtë dhe durimtare.

Më të dy anë të vatrës ishin minderë t' unjëtë, të mbuluar me velenxë të leshta, velenxa të holla me fund të kaltërt e me lule të verdha mbi të; anët ishin të bardha. Në mur' mbi mindert q' ish m' anë të mëngjër të vatrës, ish varur një pushk' e vjetër, një pushkë që dukesh se kish disa vjet që s' ish zënë me dorë. Dhogat e kësaj dhome ishin të pastra, pa ndonjë njollë dhe dukesh që zonj' e shtëpisë ish punëtore.

Kjo ish një grua e thyer që kish shkuar verën e moshës dhe po i qasesh dimërit, dhe dëbor' e kohës i kish rënë mbi kokë; fijet e bardhë rrëfenin veten në mes të leshttravet të zeza, mbuluar me një shami të zezë.

- Ndarja do të të duket e keqe, Meço, mua do të më këputet një copë nga shpirti. Të rronte yt atë, do të mbanin akoma pranë; në shkurt mbushe trembëdhjet vjeç; erdh koha të dalç në kurbet; mejto Shegën dhe Lulon...

Në këtë çast u hap der' e dhomës dhe një djal' i vogël nxitoi brenda, pothua u rrugullis si në lëmë.

- Nën u lodha; do dalë! dhe duke hedhur duart vogëloshe më qafë mëmës, kalli turinjt' e vogël të t'ij, këta turinj të kuq ku ndrinin dy sy të zes, në gushë të s'ëmës.

Ky djal' i vogël, kjo lule me shpirt, ky shpirt i lulëzuar, ish Lulua, djal' i vogël i kësaj gruaje së ve. Lulua tani ish dy vjeç e gjysëm; i ati s' kish arritur t' i dëgjojë fjalët, po e

kish parë t' ecënj me çape të ngadalshë, e të tundur.

Mëma mori Lulon në prehër të saj, e mbuloi me piqin' e rrobes së zezë që kish veshur dhe i përkëdheli faqet e vogëla q' i ishin bërë të flakta duke nxituar në luadh; pastaj u ngrit, zuri të birë prej dore.

- Unë po vete të piqem me shokët, tha Meçua, dhe dolli jashtë shtëpisë.

* *

Sikundër kish thënë dh'e ëma, Meçua kish mbushur trembëdhjet vjeç në shkurt, më 17 të shkurtit, dhe tani ish mez' i majit. Ish një djal' i holl' e i gjatë, sy gështenjë, leshtra zi; vështirim ish plot fuqi dhe faqet plot me një gjak të kuq e të fortë.

I at' i Meços kish katërmbëdhjet muaj që kish vdekur jashtë shtëpisë, larg vatrës. Kish ardhurë nga kurbeti për të shkuarë dimërin në shtëpi, për të parë gruan dhe djemtë, për lumturinë e të cilëve ish larguar nga fshat i dashur që t'u sjellë një rritje pak të bardhë. Në kohët që vinë dallëndyshet i at' i Meçosë ish kthyer në Stamboll, po një sëmundj' e papandehur' e kish çkëputur nga kjo jetë; dhe letr' e parë që vati në fëmij' e tij ish kënduar me kuje e me vajtime.

Meçua si dolli nga shtëpi e tij mori nëpërmes luadhit të vogël që sapo ish korrur; si shkoi luadhe, u afërua ca shtëpive të vogla, të rrethuara me një mur t' unjët; në

kopsht një kumbullë e madhe dh'e zezë ish ngarkuar me kumbulla të kuqe. Kur arriti përpara derës së kopshtit Meçua thirri:

Aty ini djem!

Njeri s'j'u përgjigj, vetëm qeni lehu me një zë të trashë dhe madhështor.

- Aty ini, djem! pyeti prapë Meçua. Këtë rradhë një zë gruaje i foli së brendëshmi:

- Kanë dalë, janë me bagëtinë.

Bëri më të djathtë dhe mori rrugën anë rripe, pastaj u ngjit më një kodër, e kapërxeu dhe arriti më një luadh anë një fushe; s'andejmi pamja çlodhesh në fushë, pastaj ngjitesh më ca male që mbyllnin këtë shesh të gjërë, si gardh' i një kopshti.

Në luadh të vogël që thamë, në mes të barit e nënë hije dy rrepëve, kullotnin nja pesëdhjetë krerë. Cqept' e zes të mëdhenj, me mjekër të gjatë dhe me brirë të mëdhenj, kishin këmbora me zë të trashë; desht' e bardhë dhe me brirë të përdredhur, kishin zile me zë të hollë.

Shokët e Meços ishin katër, të katër dymbëdhjetë gjer më katërmbëdhjetë vjeç. Dy nga këta losnin lajthi; ay që goditte dhjetëshin, q'ish majë peronde mirrte një grusht lajthi.

Meçoja u qas dhe u tha:

- Nesër po shkoj.

Shokët j'u mblodhë dhe shikuan njëri jatin, pastaj m'i madh' i tyre, Kiçua, tha:

- A je i gëzuar që do të dalsh për fitim?

- Nëneja më tha sot që duhet të punonj, se kam një motër dhe një vëlla të vogël. Do të vete; të shohim ç'zanat do të zë; në Stamboll kam ungjërit, ata do të më gjejnë një punë. Kush e di kur do të kthehem prapë...

Rrotulloi një vështrim; dhëntë ishin qasur, sikur donin të dëgjonin dhe ato fjalët e këtyre djemve.

- Sa qenka rritur kjo kërthi breskë; është bërë një ftujëz e bukur ... dhe përkëdheli me dorë dhin' e vogël.

Ndënji atje, kuvenduan po nuk lojtën ; ishin mbledhur

atje këtë ditë, po nesër më s' do të mblidheshin dot.

Kur u kthye Meçua në shtëpi, ca dritë skuqnin në finestrat; fshanë në kët mugët, e kish mbuluar një ngjyr' e zezë dhe tymi që dilte nga oxhakët mbulonte shtëpitë me një pëlhurë të hollë dhe t'errët. Dy zëra ngriheshin nga ky pìrg i errët, dy zëra si t'ardhur nga varri: zilet e lopëve bashkuar me këmborët e dhenët, dhe të lehurat e qënit, të lehur të trashë, me zë të majmë; më çdo të lehur përgjigjesh një lehje tjetër, pastaj pushimi bëhesh i thellë dhe nap' e tymit zgjerohesh akoma mbi këto shtëpi të varfëra, po të qeta.

* *

Të nesëmen e mërkurë; fshati u zgjua me të zbardhëllyer dhe veç foshnjet, gjithë sytë panë rrëzat e para të diellit.

Pas tetë orë gjumi, pas tetë orë varrimi, fshati tani po zgjuhesh, me zë të qeshur dhe me jetë të re; drit' e bardh' e diellit tani po ngjallte çdo gjë, dhe shpresa vetë ngjallet kur ka dritë në qiell, kur ka ngrohtësi në zemër dhe qeshje në buzë.

Shqipëtarat llërë përveshur milnin bagëtinë dhe vedrat e kusitë mbusheshin me lënk' e shkumbtë; burrat kishin marrë dhiqelë dhe shatën mbi supt e me çape të shëndosë venin n'arë; plakat kishin munguar më parë, se ata sy që shohin varrë s'afëri kanë frikë nga gjumi, dhe po fshinin e pastronin oborrë dhe shtëpinë.

Shkëndij' e parë e diellit i gjeti më këmbë njerëzit në

shtëpi të Meços. E ëma ndreq trajsenë me plaçka; numuroj dhe një herë linjë të, çorapetë; palosi peshllinë, dhe, në mes të këtyre teshave vuri një brez të qindisur më dorë të saj, të qindisur me lesh të gjelbër dhe të kuq; Meçua m'anë tjetër lithte valenxën me kokë t'unjurë dhe me gojë të kyçur.

Kur erdh' udhëtarët, e ëma me të birë sapo kishin mbaruar së lidhuri barrët e vogëla; i hodhi në një kalë, Meçua puthi dorën e s'ëmësë.

- Të lë të mirë, nënë.

- Udh' e mbarë, biro; paç uratën e Zotit dhe timenë, mos turpërosh as tët atë, as veten tënde; udh' e mbarë, edhe mos e nxirr kurrë nga zëmra e nga mëndja fshanë tënd.

Shega, e motr' e Meços, kish dy pika të ngrohta në qepalla, dhe dy të tjera po unjëshin poshtë faqeve; i puthi dorën e të vëllajt, dhe ay e puthi me mallëngjim duke mbajtur lotët.

- Mirë mbeç nënë, mirë mbeç, Shegë.

Meçua hyri në mes t'udhëtarëve, dy kuaj përpara.

Kur arriti majë bregut të vogël, në perëndim të fshatit, Meçua qëndroi u kthye dhe shikoi shtëpinë; dy qint çape më poshtë, shtëpis' së tyre i nxinin drasat në mes të kumbullavet dhe të manevet; e ëma bashkë me Shegën ishin akoma përpara portësë. Kjo grua që kish aqë kurajo përpara të birit, tani që më s'kish frikë se mos mallëngjente zëmrën, e djalit që po dilte në kurbet si burrë, tani e ëm' e Meçosë po qante, dhe, me ata sy të trubulluar, po shikonte udhëtarët.

Meçua pa t'ëmënë dhe motrën, nuk pa lottë, po vetëm kish sytë qullë.

- Ecë, se duhet të arrijmë në K.. pa zënë vapa! tha Rapushi, dhe i ra kalit me një purtekë.

Tani udhëtarët po ecnin me çape të fortë.

*Erdhi kartë nga Korfuzi,
Thonë dolli Tafil Buzi!*

Këndon Hodua, më gazmor i të pes' udhëtarëve që lanë fshatthin e tyre për të dalë në kurbet.

Udha ish shesh, me ara më të dy anët. Kur arrinë në Gur' i zi djaloshi qëndroi; ishin dy shkëmbinj të mëdhenj, të zes si pisë, të prerë si me thikë, dhe, tek qaseshin, bënë një portë, portë të madhe, të fortë, të tmerruar.

- Vjet këtu e vranë Çelon; më 18 të korrikut, si sot e kam përpara syvet; tre plumba në kraharor; së prapsmi, në kafkët, ish një plagë sa dora dhe trut' ishinë derdhur; na këtu ish shtrirë dhe rrëfeu një vend pranë një guri.

Hodua këndonte:

Erdhi kartë nga Korfuzi!

Po Meçua s' dëgjonte, ish kthyer dhe shikonte.

Fshati kish mbetur lark, mjaft lark. Në mes të këtyre shtëpive anë rripesë, në mes të këtyre shtëpive humbur nën fletët e drurëvet, djaloshi ynë me syt' e mprehtë kërkoi vatrën e tij; na atje, anë fshatit, ndërmjet këtij qiparisi të thyer, në majë të të cilit kish folenë një lejlek, dhe atyre plepave të lartë, duket një shtëpizë mbuluar me drrasa; nga një an' e pullasit dilte një oxhak i bardhë si një cop' pëlhurë. Ajo ish shtëpia ku kish lindur, ku kish lojtur, ku e ëma e kish përkëdhelur; përpara shtëpisë ish luadhi, ay

luadh i gjerë ku kish bredhur e kish lojtur cingli me shokët. Një nga një kujtoi t'anë kur vinte dhe shkonte në shtëpi nga një dimër më dy tre vjet një herë; kujtoj herën e fundit, kur erdhi - dhe u la t'u - mirë mbeçën e fundit. Pastaj j'u kthyen sytë dhe pa luadhë, kujtoj shokët, kujtoi lodratë, kujtoi dhëntë, dhitë, kecët, shqerat. Po prap syt' i erdhë n'atë pullas mbuluar me drasa të zeza, n' atë oxhak të bardhë, dhe fytyr' e s'ëmës dhe e së motrës ju ngrehnë përpara; fytyr' e Shegës e mallëngjeu dhe një lot shkau poshtë faqes.

- Shpejtoni, djem, thirri Rapushi, dhe u ra kuajvet.

Udhëtarët me kërcinj të hekurtë ju nishn' udhës me një fuqi të re; si shkuan Gur'e Zi fshati humbi si prapa një muri, një pamje tjetër u zgjat përpara tyre.

Udha që kish zën' e unjesh pak, tani kish më të dy anët panja të mëdha, dhe fletët e gjëra dhe të gjelbëra bënë një hije të freskët.

Fshatra të rinj u çfaqën majë bregëvet, dhe shtëpitë zbardhnin së largu si shkëmbinj majë mali.

Dielli ndrinte në këtë qiell të majit dhe shkëndijat e tij binin si shigjeta. Në mes të këtyre udhëtarëve q'ecnin me fuqi në gjak, zëri i Hodosë këndonte:

*Thonë që doli në Vlorë
Me tre bajrakë në dorë.*

Dhe gjithë tok çaponin në këtë udhë që zgjatesh përpara tyre, gjer atje ku piqesh dheu me qiellë.

Selanik, Qershor 1906

II.

KENGA

Ishin njëmbëdhjetë, ndenjtur qark; në mes kishin një fron të vogël, dy qelqe me një lëng të kuq në to.

Dyqani, ku ishin mbledhur këta miq, ish një dyqan i vogël, gjysëm kasapi, gjysëm zarzavatçi: copa mish të mëdha ishin varur në grepet e hekurt, mish të kuq me copa dhjamë të verdhë, copë të ngrirë pothuaj, se ish stin' e veriut të ftohtë. M'anë tjetër lakra, hauçe, selina dhe të tjera barishtëra dhe rrënjë ishin radhitur në koshat mbërdhe a mbi dhogatë. Megjithëqë plot mish dhe lakrishtera, dyqani kish një pamje të pastër dhe njeriu s'i vinte ndohtë të hyjnë brenda.

Të njëmbëdhjetë shokët kishin ndënjtur mbi frone. Midis tyre çquanin mustaqet e bardha të Meçit, burr' i lashtë, i thatë, i pakë, po i shëndoshë, syri pishë, faqe të thata, kocka të dala, kokë dhe ballë rrumbullake.

Edhe kënga po zjente.

- Pini dhe një, djem! edhe shëndoshë në vilajet, tha Meçi, duke mbushur kupat. Lëngu i kuq u qas në buzat dhe kupat bënë fir përnjëherë. Një zjarr i ri në miqt' e mbledhur

atje, dhe kënga që pushoi një mënt, tani zuri m'ë fortë dhe m'ë nxehtë.

Meçi i kish ftuar këta shokë në dyqan të tij.

Ishin dhjetë, thamë, të gjithë si ay, lebër, nga fshatrat e Zagorisë, të tërë punëtor në këtë kurbet.

Meçi, me gjithë të dyzetat e shkuara dhe të pesëdhjetat e afëruara, po mirrte këngën: të tjerët me radhë sicilido pas zërit që kish, po e priste, dhe kështu këng' e Labërisë po gumzhinte në këtë dyqan të vogël në mes të të madhit Stamboll.

- Pa ja merr dhe një herë ti, or Hekur; merja asaj kënge: Moj burbuqe!

Ay që quhesh Hekur ish një djal i ri, jo më tepër se njëzetepesë vjeç, sy bardhë, lesh verdhë, pak i vogël nga shtati.

Kënga u nis e re dhe dilte e shëndoshë prej mushkërivet: Bubur burbuqe, o moj burbuqe.

Hekuri po këndonte e po mejtohesh. Këtë këngë e kish dëgjuar herën e parë në Sheper, kur kishin vajtur të marrin nuse. Ish Maj ahëre, dhe kishin shkuar gjashtë vjet. Sa kujtim i mirë! Edhe ahëre ish në kurbet se kish dalë që më katërmëdhjet vjeç; po kish vajtur të shkojë një verë të tërë te mëmëdheu i tij. Edhe kishin shkuar t'ëmbël ata të gjashtë muaj, me shoqëri të mirë, dhe me gaz të madh..

Po Hekuri s' u ndal shumë në këta kujtime, se q' atë çast mejtoi veten e tij, të vluarën që kish në Labëri dhe fshanë, shtëpinë, gjërinë që do vente t' i shohë për katër muaj.

- Edhe në dasmë! - thirri Piti, dhe ngriti kupën, Zoti na e bëftë si ma do zëmra, edhe me gjithë të mirat.

Gjithë shikuan folësin, heshtën dhe kthyen kupat. Piti ish një burrë i thyer, pak i majmë, sy të zez; një sy ku ish një vështrim i mallëngjyer, sikur ish varur një pikë lot në të. Dalë që djalë në kurbet, kish parë Misir, Vllahi, Bullgari, Anadoll dhe Rumeli, dhe tani ish hedhur këtu në Stamboll pa ndonjë fis, pa farë, jo vetëm në këtë qytet të moçëm që themeloi Kostandini, po pa shpresë dhe në

Shqipëri.

Duke parë që erdhi pakë pushim, djaloshi Kiço mori kurajo dhe guxoi:

- A nuk ja marrim një herë Për mëmëdhenë?...

- Unë s'e di këtë këngë, tha Piti.

- As unë, s'e di, thanë Rrapua dhe Guri.

- Un' e di, se dëgjova vjet në Korçë: e këndonin gjithë djemurija, tha Llambi.

- Merjani një herë, djem, tha Meçi; dhe hodhi dy gisht në funt të kupavet.

Ahere në mes të tymit që kishin bërë cigaret, në mes të dritës' së llambës, brenda n'atë dyqan të vogël, kënduar prej krahërorësh të shëndoshë, zuri dhe gjëmoi kënga:

- Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë, vraponi djema...

Kënga me qënëqë ish pa iso, të tre djaloshët e dinin e muarrë përnjëherë : të tjerët po dëgjonin dhe, ca prej tyre, sadoqëqë po e dëgjonin për herë të parë, prapë ndjenin një shije dhe një gëzim në këto nota shqipe. Kur u mbarua kënga:

- Vërtet qënka një këng' e bukur, me zë dhe me fjalë të mira, tha Kiçi. Tani merja ti Puli, edhe ti Rako mbaje!

- Rrëzë malit, rrëzë malit një thëllëzë!

* *

Jashtë ish errët dhe ftohtë. Ish natë janari, dhe dëbora kish zënë të bjerë, më të perënduar dielli, Flokët binin të rrallë dhe të mëdhenj, dhe afër fenerve t'udhës dukeshin si flutura të bardha rreth dritës. Mbërdhe po shtroresh një pal' e bardhë si pambuk i hedhur.

Rami këtë natë po ngjitësh më këmbë rrugën e përpjetë që vete në shtëpi e tij. Ardhur në Stamboll gjashtë vjet më

parë, tani pas të tjeravet, kish mot-mot që mësonte në shkollë të drejtësisë.

Vetëm, pa ndonjë njeri në këtë kryeqytet të gjerë, bir' i vetëm i një babai të pasur, Rami, i ri dhe i gazshëm, që kur kish ardhur në Stamboll, po më tepër tani të dy vjetët e fundit po shkonte një jetë pa kurrfarë brengje, i lumtur dhe i kënaqur.

Sot Rami kish mbetur për darkë te një mik në Stamboll, një shtëpi e madhe dhe të bukur në Sylejmanije. I bir' i të zott' shtëpisë ish nxënës në shkollë të drejtësisë dhe shok i Ramit, dhe kështu një miqësi e lidhte ne kjo shtëpi, një nga më të vjetërat e shtëpivët të Stambollit.

Pas darke, gjer më një orë të përparuar e shkuan me kuvende. Rami kish prej natyre mëndjen të çelur, kërkonte të nxërë çdo gjë, donte të dijë të gjitha, se të tëra çfaqjet e mëndjes e interesonin; kohën që i mbetesh nga mësimet e shkollës, e shkonte me studime literature dhe diturake, studime që i forconte dhe me kuvende me miq, miq të mënçëm që i zgjidhte me kujdes në mes shokëvet të shumë që kish. Them i se kish shumë shokër, po miq të numuruar, se të parët gjënden lehtë dhe tekdo, po të dytët janë të rrallë. Edhe ish për çudi që Rami këtu në Stamboll s' kish as shok as miq shqiptar, thotë njeriu se kish prerë çdo marrëdhënje me mëmëdhenë.

Në ndjenjat të tij poetike, Rami e donte këtë të sotme, këtë dëborë që hidhte palët e saj të buta dhe të ftohta. Edhe nga Stambolli u nis më këmbë për në Bejoll, ku e kish shtëpinë. Pshtjellë në palltot të shëndoshë, djaloshi tënë këta të ftohtë i epte një gaz, i dukesh si një goditje mi trupt dhe mbi nervat e tij, se, sadoqë rritur në qytet të math dhe me pekul, në rrëmbat e tij rrithte gjaku i malësorëve të thëllimit, i prindërve të tij.

Ura që ndan Stambollë me Gallatën, vaporret e pirgosur m'anë të djathtë, trarët e anijevet të rradhitura më të mëngjër në Haliç, kjo mëng' e ngushtë, dritat e mëhallavet të Stambollit, të Kasem Pashasë dhe të Bejollit, drita të

venitura si syt' e yjet në mes të mjegullës, sa gjëra të bukura për një njeri që ka sy e sheh, që ka zemër dhe ndjen! Rami u ndal pak mbi urët, shikoi detin më të mëngjër dhe më të dajhtë, Stambollë dhe Bejollë, prapa dhe përpara.

Një herë përtej urës, Rami ndjeu të ftohtë dhe desh që t'ecënj akoma më këmbë, pa shikuarë as fare karocarët që e pyetnin.

- Araba istermi, bejim?

Në Gallatë, miku ynë zuri udhën e tramvajit, udhë që shkon në mes t'atyreve shtëpivët të mëdha, banka, rezhija, dhe kaq shoqëri ku zien jeta ekonomike e këtij qyteti të math.

Pa arritur ne karakolli Shishhane, Rami u kthye më të djathtë, për të marrë të përpjetën, që ta shkurtojë pak rrugën. Kish ardhur tre çape për të hyrë brenda në rrugët, kur qëndroi përnjëherë.

Një zë i ndryshë, i erdhi në vesh. Në krye pandehu se ish një fotograf dhe u çudit mbi këngët që thosh. Pa vonuar shumë, Rami kupëtoi që ish këngë njeriu, u kthye prapë, kapërxeu udhën dhe u qas te dyqani nga dilte ky zë i nxehtë dhe i shëndoshë.

- S'ka dyshim, po këndojnë shqip, mejtoi djaloshi, dhe afëroi kokën në penxhere e vogël e dyqanit që të shohë ç'po bëhet brenda; edhe pa shokët e Meçit që po bënë muhabet. Edhe ndënj të dëgjojë.

Rrëzë malit një thëllëzë"! Pa dal ku e kish dëgjuar herë tjetër Rami këtë këngë? Që kur e kish kujtim?

Përnjëherë kujtimi j'u kthjellua, mejtimi u kullua. Rami u kujtua se dhjet vjet më parë, ahëre kur ish fare djalë, më një gosti gazmore, burra të rinj dhe të hijshëm e kishin kënduar këtë këngë, në qytet Z... ku, kishin vajtur duke kaptuar rrëke dhe duke shkuar nga shkëmbenj e nga driza...

- Rrëzë malit një thëllëzë, thosh me vete të tij, duke u larguar prej dyqanit, dhe me sy të mejtuar po shihte gjëra të shkuara dhe gjysmë të haruara, po që tani ngjalleshin

përpara, ata kalorës që kishin kënduar dhjetë vet më parë këtë këngë, edhe ata shkëmbenj, edhe arat e gjelbëra, edhe hijet e drurëvet, mbi, ujë të ftohtë.

Stamboll, 10.XX.1910

III.

PO KTHEHEN

- Shiko, shiko me sa vrap po bën not!
- Edhe sa shumë po hidhetë jasht detit!
- Më duket se këta pishqe po ndjekin vaporrin tënë!
- Ky i këtejmi duket më trim nga të tërë.

Këta që kuvendonin kështu ishin katër shqiptarë që po kthehen' në vent të tyre.

Sadoqë vjeshtë, dielli sot po diqte dhe përvëlonte si një diell korriku. Vaporri me t'ecur të shpejtë po shkiste mbi ujët e detit, i qetë dhe i shkëlqyer si një pasqyrë e fshirë me kujdes. Er' e hollë që çfaqesh nga udhëtim' i vaborit sikur pakësonte një çikë vapën' e kësaj dite së përvëluar.

Ishin pshtetur në anët të vaborit dhe që të katër po shikonin delfinët' e mëdhenj që po bridhnin rreth vaborrit. Vrap i pishqet dhe të hedhurit e tyre mbi ujët i çudiste dhe i zbaviste miqt' tanë që kishin qepur syt mbi këto shtazët pa vërejtur fare njerëzit që brithnin posht' e lart në vapor, si bletët rrotull kosherës. Llostromët e vaborrit, duke vajtur posht' e lartë, duke shpënë kofina me plehra a enë

me gjellë, sa herë që shkonin pranë këtyre të varfërve u binin me bryl a u shkelnin me këmbë, dhe më çdo herë fjalë t' ashpëra dilnin prej gojës së tyre.

- As na kanë fare në radhë të njerëzve, këta llostromët e vaporrit, tha Meçeja duke shikuar shokët e tij.

- Kur shëtit njeriu në vend të tretë si ne, këto heq në vaporr.

Meçeja që u qa nga sjellj' e njerëzvet të vaporrit, se një llostrom i kish rënë me një kofin në sup, ish një djalosh shtatëmbëdhjetë vjeç. Përgjigjen' e kish dhënë Roka, me mustaqet e verdha të mëdha.

Këto dy fjalë të paka bënë shqiptarët tanë që të heqin sytë nga deti e nga pishqet dhe të vështrojnë rreth tyre.

Kuverta ku rrinin ish një vend i ngushtë në mes të vaporrit; më nj'anë ish vend'i maqinave dhe vendi tek piqeshin gjellët e vaporit, tjetër ish brinj' e vaporrit vetë. Në këtë vend katër çap' e gjysmë të gjerë ishin mbledhur një shumicë të varfër; kush kish hipur nga Stambolli, tjetri nga Izmiri; gra, burra, pleq dhe djem ishin gju për gju, shoq mbi shoq në këtë vent që po shtypesh nënë dhogat e kuvertës së lartë. Pranë njerëzve ishin plaçkat e tyre, plaçka varfërije, jorgan, shilte, hejbe, dhe nga nonjë sandëk i vogël.

- Pa shih, Melo, se si është nxirë nga thëngjilli ky i mjerë, tha Meçeja duke rrëfyerë një njeri që po ngjitesh nga shkall' e hekurtë ku ish vatr' e maqinavet.

- Me të vërtet i mjerë, - u përgjigj Melua, një burrë njëzetedy vjeçar, me mustaqe të vogëla, të zeza; - pa e shih si ka dërsirë, uj' i kullon fanella. S'është jetë dhe kjo që heqin këtu.

Njeriu i zi dhe qull në djersë ndënj mbi dhogat e vaporrit, fytyrën kthyerë drejt detit, gojën të hapur për të marrë pak frymë. Shikoi ca kohë detin me ata syt' e lodhur pranë zjarrit, vështroi njerëzit që kish përçark, pastaj nxori një shami të bërë sterrë, dhe fshiu turinë ku pluhur' i thëngjillit dhe hiri ishin tretur në djersë.

- Pa dyshim këta njerës janë më për t' ardhur keq se ne, tha shoku i katërt, Sulua që po dëgjonte dhe shikonte nga vëndi që kish zënë që në krye.

Njeriu i zi u unj prapë në dhomë të oxhakut, n'atë vend të nxehtë dhe të flakët si një copë skëterrë.

Një zë kambane tëngëlliti në vaborr, si një këmbor' e madhe. Ish kohë dreke dhe udhëtarët e vendit të parë, një tok njerës, gra dhe burra, me kësula të ndryshme, mbi kokë, zbritn' nga shkallët e ngushta dhe zunë të mblidhen' në sallon të math, ku natën dritat e shuma të tavanit, duke u ndezur përnjëherë, hidhnin një dritë të shkëlqyeshme. Shqiptarët tanë tani këtë sallon s'e kishin parë përveç se nga vrim' e shkallës, t' asaj shkalle me dhoga të shkëlqyera si ato të nj' arke dhogash arre.

- Shiko ata që po unjen poshtë, sa janë të kënaqur dhe të fatshëm; se ata janë të pasur, kanë të holla, tha Meçeja.

Po këto fjalë mbenë të padëgjua, se miqt' tanë dhe udhtarët e tjerë, që ishin dhe ata në kuvertë, ishin kthyer prapë nga deti dhe po vërenin delfinët që s'ishin lodhur akoma së ndjekuri vaborrët. Në mes të tyre ish një që ecte fare afër vaborrit dhe dukesh m'i madh se nga gjithë të tjerët.

Sa herë që hidhesh ky delfin, ngrihesh aqë shumë përpjetë sa pandehesh se do të binte brenda në vaborr; ahëre i zbardhte barku i pastër si dëborë, dhe kur binte mbi ujë, me atë sulm të math, thosh njeriu se do të bëhesh copë nga vërtiku. Po edhe brenda n'ijë prapë i dukesh kurriz i zi dhe turinjte me majë, ku dhe dhëmbët e mprehtë i çquheshin. Sadoqë vaborri merrte një udhë të mirë, peshku me ata krahë të vegjël dukesh sikur fluturonte, dhe ky nxitim që kish nisur që tre or' e tëhu, as dukesh fare që ta kish lodhur.

- Eshtë më tepër se katër kut i gjatë, - tha Meçua.

- Në Stamboll kam punuar një mot të tërë në Bugaz, - tha Sulua, po kurrë s'më janë dukur kaqë të mëdhenj këta pishqe. Në Bugaz kur nisin e shkojnë, duken si një kope,

se qenë njeri pas tjetrit, dhjet' a njëzet. Ahere barkarët i zë frika dhe thërresin "Jonus ballëk, jonus ballëk!"

Po tani peshkut i kish dalë një zbavitje tjetër që gëzonte udhëtarët: ca prej tyre, grekër hipur nga Izmiri, kishin zënë dhe po hidhnin copëra buke në det, dhe delfini me vrap të math vërtitesh m' i të dh' e kapërcente. Kjo zbavitje duroi gjysm' ore, po delfinët sa vinin po mbeteshin pas.

Shqiptarët tanë ndjenj' akoma ca kohë të pshtetur anë vaporrit, pastaj Roka vështroi orën dhe tha:

- E, nesër, djem, ju të dy që me natë dilni në Sarandë

- Edhe pasnesër do të jemi në shtëpi, tha Meçeja me një të qeshur.

* *

Këta të katër shqiptarë, të cilët u zunë ngoje emërat më sipër, i kish pjekurë fati në vaporr. Që të katër po ktheheshin nga kurbeti për në shtëpi të tyre.

I shkreti kurbet! E cili shqiptar s'ka hequr hidhërimet e mërgimit, kush është' ay që s'ka ndjerë mall' e shtëpisë dhe të dashurët të tij, larg fshatit dhe mërguar nga Shqipëria?

Melua me Meçen jan' nga Gjirokastra po secili nga një fshat më vete. Melua, sadoqë njëzetedy a njëzetetre vjeç, ka tetë vjet që ka dalë në kurbet, tetë vjet të gjatë që po punonte pranë një kasapi në Stamboll. Meçeja, djalë me fytyrë të hollë që edhe s'munt të quhesh akoma burrë, ay që thamë se ish shtatëmbëdhjetë vjeç, ay kish tre vjet që shërbente, edhe ay në Stamboll, pranë një zarzavatçiu. Roka me mustaqet e verdha të mëdha ish nga Shkodra dhe ruajtës pranë një të pasuri. Sulua me shtat të vogël dhe me pakë mustaqe, kish gjashtë vjet që punonte në ara dhe në kopshte të Stambollit, me diqel' e hekurtë, si gjithë shokët e tij nga Mati.

Që të katër këta i kishin hipur vaporrit në Stamboll. Të vuajturat e kaqë vjetësh tani ishin haruar, se çdo orë po i qaste te fëmija dhe te fshati. Kaq vjet kish punuar pa u qarë asnjëherë, pa u ardhur aspak rëndë, se e dinin fort mirë, që në kishin dalë në mërgim, në kishin lënë mëmat dhe motrat e vëllezërit, këtë e kishin bërë për të fituar të holla që të mbajnë fëmijën e tyre dhe të mos i lënë të vuajnë. Hidhërimet, malli dhe vuajtjet e kaqë vjetëve do të harroheshin dhe do të shpërbleheshin në gaz që do të ndjehesh këtë dimër brenda në fëmijët të tyre. Me sa padurim po e presin orën e fundit kur do të qasen te port' e shtëpisë dhe kur do të mundin të shtrëngojnë në krahët e mallshë, të tyre ata veta të dashur!

Kini qënë mërguar ndonjë herë, të dashur këndonjës, prej fëmijës suaj dhe a e keni ndjerë gaz e të kthyerit, gaz e asaj dite dhe ku e dini se për kaq orë do t'ini në mes të rrethit të fytyravet të dashura? Sa i dhëmbshëm të jetë malli, aq m'i ëmbël dhe m'i math është gas i të kthyerit, aq më të forta janë rrahjet e zëmrës!

Këto gjëra po i ndjenin që të katër shokët tanë, po më tepër se nga të tërë djaloshi Meçe, i cili që kur kish lënë shtëpinë ish her' e parë që po kthehesh prapë. Po për të tjerët, sadoq larguar dhe afruar kaqë herë te fëmij' e tyre, a munt të themi se zëmra u rrinte e qetë dhe e ngrirë?

"Nesër në Sarandë, pasnesër në shtëpi te mëma dhe te motra" kish thënë Meçoja pa zënë gjumi, dhe ky mejtimit ju bë një ëndërr e bukur.

* *

Nata ish' e thellë dh'e qetë. Sikur të mos qe zër'i maqinës, të gërhiturit e avullit dhe të trënditurit e vaporrit, do të thoshnim se nata ish në pushim; po megjithë këtë veç vaporrit, çdo gjë ish në heshtje të madhe edhe në det ishin pasqyruar yjtë që kishin një shkëlqim më të madh në këtë

natë vjeshte dhe pa hënë.

Udhëtarët të gjithë po flinin. Të mos ish kapedan dhe timonieri me nja dy llostromë dhe me maqinistët e gjorë, do të pandehte njeriu se ky vapor ish një djep' i madh me njerës të fjetur brenda. Udhëtarët e vendit të tretë, miqt' tanë dhe shokët e kuvertës, po flinin, kush i shtrirë mbi një shilte të vogël dhe i mbuluar me një jorgan të varfër, kush kokën mbi një torbë a mbi një hejbe, të mbuluar vetëm me një pallto, sadoqë nata dh' er' e lehtë bënin një të ftohtë q'ë kafshonte në kurriz njerinë.

Nga të gjithë të fleturët Melua u zgjua i pari; shikoi orën: kish vajtur dymbëdhjetë, edhe një orë akoma dhe do të skuqesh lindja.

- Ngreu, Meçe, se po arrijmë.

Gjysëm i zgjuar, Meçeja u ngrit, hapi sytë plot gjumë, u shtri dhe shikoi rreth e rrotull. Ajo që pa, s'ish veçse një mbledhje njerëzish të fletur të cilëvet një fener i venitur u ndriste trupat gjysëm të shtrirë, gjysëm të mbledhur si kulaç. Gjum' i Meçes edhe s'i kish dalë, se djali shtatëmbëdhjetë vjeç s'nginjet kurrë me gjumë; desh të bjerë prapë dhe të flerë, po pa i lënë kohë, Melua përsëriti:

- Për ndonjë orë edhe do të jemi në Sarandë.

Këto të paka fjalë, djaloshnë tënë e zgjuan fare; me vrap shkoi rrobat, u ngrit vështroi mbërdhe se mos shkelë këmbën e kokën e ndonjë prej këtyre njerëzve që po dergjeshin n' atë vend të ngushtë, dhe nxitoi n'anë të brinjës së vaporrit.

Hëna në katërzim të fundit kish dalë ndonjë hosten dhe shkëlqente në qiell si një drapër i kuqur në zjarr të kovaçit. Pranë hënës yll' i mëngjezit, Afrëdit' e shënjtëruar, po lëshonte një shkëndijë të fortë; në iqell akoma të zi sterrë, po ndrinin yjt' e mëdhenj të dimrit, dhe deti i qetë bënte një rrugë të zjarrtë atje tek shkonte vaporit dhe hidhte dritën e saj hëna.

Po syt' e Meçit, s'vanë as te hëna, as tek e bukura Afërditë: vështrim i tij kërkoi steren që po nxinte pak larg,

më të djatht' të vaporrit.

- Na se ku prapa neve mbetet Korfuzi; tani për një orë a për një or' e gjysmë, do hedhim hekur në skelë.

... Nata ca nga ca po ikte përpara agimit. Nga lindja nap' e natës kish zënë dhe po humbiste ngjyrën e saj të zezë pisë; pa shkuar shumë n' atë dritë të bardhë që mezi dukesh, zunë të çfaqen shkëndijas të kuqe, që duke goditur ca re të holla lart në qiell, zunë të bëjnë napë të flaktë. Yjtë një nga një u venitën si feneri që i shuan era. Po drapër i hënës dhe syr' i Afrëditës ruanin shkëlqimin që kishin.

Në zbardhëllimin të mëngjezit syt' e djaloshit nisnë të shquajnë fort bukur zall' e Shqipërisë dhe malet e veshur që lartësoheshin mbi atë vend të dashur, edhe zëmra e tij i buçiti sikur që përpëlitet një zok që kërkon të dalë jashtë kuvlisë.

... dielli sapo kish zënë të nxjerrë kokën e tij të shënjtmë prapa malevet të Shqipërisë, kur vaporri gjëmoi prej zërit të verigavet të hekurit që po lëshonin në det. Edhe përnjëherësh qëndroi.

- Arritëm, thirri Meçeja.

Tri barka u çkëputën nga skela dhe më një çast u qasnë te vapori si tre zoq deti.

Meçeja nxitoi te plaçkat, lidhi hejbenë, i shkoi dhe një herë tërkuzën një arke së vogël, pastaj i ndihu Melos. Tani që të dy ishin gati.

- Mos na nxirni nga zëmra, vafshi shëndoshë, u pjekshim shëndoshë! Këto ishin uratat që po shkëmbenin tani të katër shokët, të dy që po dilnin në Sarandë dhe të dy të tjerë që do venin më larg. Të katër shokët u përqafoshën shqiptarisht, shtrënguan duart. Po dukesh se ishin bërë vëllezër sadoqë pesë ditë më parë as e kishin parë shoku shoknë.

- Të piqemi prapë në Stamboll dhe me zemër të gëzuar,
- thirri Melua nga barka.

Stamboll, 5 Vjesht' e III 1911.

SI VDIQ SELMAN TODORUSHA

Si ngriti dollin' e fundit, Selman Todorusha fshiu mustaqet e zbardhura të gjata, la kupën, shikoi dhe njëherë ata që kish pranë:

- Po, jo, do të ngre dhe një dollari tjetër. Do të pi për dashurinë që kemi në mes të fëmijërisë!

Të dy miqtë, i vëllaj, i kushëriri, mbushnë kupat. Zonjat ishin qasur se do të ngrihesh tepsija e do të vihesh buka.

- Për shëndet të dashurisë në këtë fëmijë! Edhe sa gjall me nder!

Pas këtij urimi që tregonte gjithë dëshirat e zëmrës, kupat u qasnë dhe lëngu i bardhë u derdh në gojë.

- Tani ngrini rakinë dhe sillnani darkën, - dha urdhër Selmani. - Po as më thoni, kush më do mua më tepër?

- Të gjithë të duam, se veç së mirës nuk' kemi parë gjë tjetër.

Ky zë dollari nga gjithë gojat, nga burrat si dhe nga gratë, një zë i trashë e i math, që tingëlliti n'odë të madhe, n' atë odë ku flak' e vatrës që bubullonte hidhte një drit' të kuqe më të madhe se e dy qirinjve.

Vetëm kunata e vogël s'kish folur. Si u bë pushim, la çipin e napës që po shtronte, ngriti kurrizë, hodhi kokën

prapa dhe shikoi Selmanë.

- Më duket se unë të dua më tepër, aga.

Selmani vështroi kunatën e vogël, e shikoi me sy babaj për të bijën. Një qeshje plot mirësi i zgjeroi atë fytyrë të nxirrë e të rrudhosur ku çdo mot kish lënë brazën e tij.

- A vdes ti për mua, Rako?

- Të rrosh me shëndet e me gjithë të mirat, aga.

Mësalla ish gati, mishi në mes, thelat bukë ishin ndarë. Pranë vatrës buka shkoi gazmore, një darkë plot bekim për këtë fëmijë të lumtur.

* *

Me kohët e mira të verës kishin ardhur dhe kopetë nga vërrija. Dhëntë me shqerrat e tyre tani po kullotnin në bregoret e gjelbëruara, mbi këtë bar të zgjuar prej gjumit të dimërit.

Rakojë atë ditë kish dalë dhe ajo me stan ku ish përhapur tufa, se kish parë mëngjez' e majit shumë më të bukur, pa donte të shihte shelegët dhe ftujat. Shumë në mes të dhenëve Rakojë i njihte: syskë, rudë, kalesh, katarosh, më të shumëvet u kish vënë shenjë, dhe zilet e këmborët më të mira ja u kish varur vetë.

Tani kish ndenjor mbi një bregore të vogël, një bregore të shkëmbtë në mes të luadhut ku ish hapur bagëtija.

Po nuk' e di pse Rakon e zu një angushë kur dëgjoji që ranë dy dyfekë? Zëri ish dëgjuar më të djathtë, atje tek zbardhnin ata shkëmbënj nën rrepet e mëdhenj. Përnjëherë, pa dashur u ngrit. Barinjtë ishin atje pranë, bashkë me qent' e tyre. Po edhe ata ishin ngritur e dëgjonin. Dy pushkë të tjera u dëgjuan, pastaj një pushim i gjatë. Po këta dy kërcëllime të fundit gjëmuan me zë të shëmtuar.

- Mbase është ndonjë gjahtor, tha grua e re me vete të saj, dhe u qetua pakë.

Po, jo, e gjora Rako, nuk është kërcëllim pushke gjahtori,

është plumb gjaksori ay që dolli nga dyfeku i shkretë.

Pse Rakoja s' rri dot në vend? Pse tani po shikon nga an' e shkëmbënjeve e të drurëve, ç'kërkon të shohë, ç'gjëmë të zezë po pret?

Na se ku po e shpin të vrrarin, të shtritur mbi dy dega. Tre miq po e shokërojnë, dy mbajnë lesën, i treti po ecën pranë.

Cilët janë këta, cili është i vrari? Pse Rako, ke syt t' egërsuar, pse shikon me kaq frikë? Ç'është ky bari që po vjen duke nxituar pa frymë?

- Thua-më, cili është?

- Selman agaj, zonjë...

Nga kraharor' i Rakosë një zë, një thirrje dolli. Shikoi akoma, ngriti krahët, vështroi të vrrarin që po e shpinin atje tej. Edhe nxitoi, se më nuk shihte.

Shamija i fluturoi nga koka, një thirrje tjetër u dëgjua, dhe trup' i saj humbi poshtë shkëmbit të lartë.

* *

Më shpejtë se nga valët e lumit që buçet, dhe se nga ret' e zeza që shtyn era, m'e tmerruar dhe nga flaka që breth mbi bart të një luadhi të tharë prej gjithë vapëvet të korrikut, gjëm' e vrasjesë ish përhapur dhe kish vajtur në shtëpi e Selman Todorushës. Kur shpunë dhe Selmanin të shtrirë e tërë grarija ish në vaj dhe shtëpija gumëzhinte n' ulurimë.

Ish kulm' i shtëpisë, ish plaku i njerëzisë, ky Selman që kish rrojtur me nder e me trimëri pas zakonit të shqiptarëve! Edhe tani një plumb i vogël e i zi, atë njeri të gjall' e të shëndoshë po e shtrinte në dhe.

Po jo, Selmani edhe s'ka vdekur. Një gjak i kuq po i rrjedh nga ijet dhe i ngjyen fustanin; po syri akoma s'ka humbur dritën. Kur e vunë n'odë të madhe i plagosuri mbante me dorë ijën e djathtë, ku i keqi plumb i ka hapur plagën e kuqe.

- Mos më qani pa vdekur, gra! Duroni edhe pak.

Edhe shikoi këto fytura të dashura që në mes tyre kish gjetur gaz' e rrojtesë. Një nga një, po gjysëm, të mbuluara me një tym të zi, pa jetën e shkuar, ata gjashtëdhjetë vjeçët e tij. Po nuk ndjeu as fare dobësi në zëmret, se ish trim Selmani.

- Mos ma lini pa marrë shpagën. Po ku është Rakoja? Ajo thosh se më donte më shumë se të tërë.

- Kish vajtur në stan sot në mëngjez, se..

Fjala s'u mbarua, se një kujë u dëgjua së jashtmi. Kjo s'ish kuj' e Selmanit, po ish e kunatës që i sillnin shtanë të rënë prej shkëmbit.

I plagosuri s'kupto i ç'po bëhesh. Ngriti kokën e rënduar dhe fytyra ju verdh më tepër.

- Pse ky ulurim?- pyeti, dhe më s'pat fuqi të flasë më shumë.

Po qënka thënë, o Selman, që të shohësh dhe një vdekje tjetër sa pa mbyllur sytë për jetë. Kur suallë m'odë dhe Rakon e vdekur, gratë përnjëherë hodhën një klithmë.

Selmani shikoi u pështet mbi dorë të mëngjër, ngriti kokën, psherëtit, pastaj foli me zë të kthjelltë, me zë të plotë sikur atë çast i erth një shpirt i ri; syt tani po hithnin shkëndija.

- Pushoni, gra. Rakoja mbajti fjalën. Unë vetëm do të qaj.

Një vaj Labërije, një nga këta vaje ku malësorkat tona dinë të vënë kaqë poezi heroike, një të tillë qarje në vjershë, nisi i plagosuri, me zë të ngadalshëm po të shëndoshë. Gratë kishin urdhër që të mos qajnë, dhe dëgjonin, dëgjonin vajin e këtij që gjer ahëre s'kish kënduar veç këngë trimërije.

Po vajtonjësi nuk mbaroi. Zëri përnjëherë ju rëndësua, syri humbi shkëlqimin, koka ju varr mënj'anë, edhe u shtrit. Nga ij' e djathtë një shkumb' e zezë buçiti. Edhe më s'u dëgjua gjë tjetër.

Kështu vdiq Selman Todorusha nga Progonati.

Eren-Qoj, 25 Mars 1912.

Ngjarjen e Selman Todorushës na e ka inspiruar një copë këngë që na ka thënë një mik. Na ca stanca të asaj kënge, ashtu të metë si e kam dëgjuar:

*U-tunt mali, u -tunt fusha,
U- vra Selman Todorusha!
Katër xhika Zeliha
S'lanë vark në dynja;
As e bija për babanë,
As e motra për vëllanë,
Po kunata për kunanë,
çika, çika bëri shtanë!
Që nga shkëmbi u hoth re,
Qysh t'u derth ajo peçe,
Pas jelekut kadife.*

PLAKU I YLYNECIT

Kur arritmë ne ur' e Ilias Lamesë, pa dashur qëndrova: më dukesh se kisha përpara meje një prej ato tabllove të rralla të moçme që figurojnë një pamje pitoreske.

Vjosa këtu kish zën' e po ngushtohesh, e shtrënguar në dy zaje të shkëmbtë; mbi atë pellg të kaltërt që bënte lumi ngriheshin shkëmbenjtë; nënë shkëmbinjtë ura; kjo urë kish m'anë tjetër një grykë guri, një farë shpelle në mal. Edhe shikova, dhe prapë e shikova ujët e thellë më të

mëngjër, urën e vogël anë lumit, dhe grykën' e gjerë më të djathtë.

- T'ecim,- thanë qiraxhinjtë, edhe kuajtë muarë çapnë.

Përnjëherë nisi një e përpjetë, një gurisht, një shkallë.

- T'i zbresim, - tha qiraxhiu, se erthmë.

Tani po niste shkall' e Ylynecit; kuajtë dhe mushkat u varguan, këmbësorët hodhë gunatë mbi samar, dyfekët u vunë mbi dy supat, prapa qafës, dhe kërcinjët u gatitnë për një udhë të rëndë.

Shkalla do të shkonte prapa Shkëmbit t' Ylynecit, duke lënë këtë pìrg të fortë m'anë të mëngjër, si një port' e hekurt anë lumit. Sa ngjiteshim, duke dhënë gjithë fuqin, e kërcinjët, Vjosa po unjesh, ngjyr' e saj bëhesh m'e kaltërt, dhe ngjante me një liqen të shtrirë.

Çapet që venin po ngadalësoheshin dhe qiraxhinjtë po shtynin kafshët me fjalë, pa guxuar të përdornin shufrat e trasha. Mbërdhe një gur, një truall guri, me copëra, të shtruara si fletë të thata të një pylli; më të dy anët t' udhës gurë, prapë gurë, si mur, dhe udha po gjarpëronte, herë tërthor, herë më të djathtë, herë më të mëngjër, herë thikë, këmbët duke u rëndësuar gjithnjë.

Tek udha arrinte kulmin, ndënja mbi një shkëmb atje anës: udha që kishin ecur ish e tërë nën meje, e humbur në gurët; tani m'e fundit e mushkëvet kish kaptuar qafën, këmbët dhe zilet e tyre po zbresin m' anë tjetër. Jam fare vetëm.

Pranë meje një mur i gurtë, si i bërë prej njerës të të një tjetër kohe, të një tjetër bote; edhe ky mur ish ai me copa gurë, me vija, me katrëçipje, ca të vogla, ca të mëdha. Më shumë vende një bimë, një bar, një myshk kish dalë nga këto të çara, kish hapur duart e saj të gjelbëra dhe po lipinte erë e dritë jashtë këtij burgu. Këtu atje një farë e hedhur prej fatit të verbër kish mbirë mbi atë shtrat shterpë dhe kish nxjerrë një druth; rrënjët kishin ecur mbi gurt, ishin shtrirë, kishin gjetur një të çarë, ishin shtrënguar gërxeëlluar, dhe, me një forcë të madhe, kishin kërkuar

dhen' e fshehur nën shkëmb, dhenë që do t'i japë një çik ushqim, dhenë prej të cilit do gjeje pak shpirt; edhe rrënjët e shkurtuara e të trashura, ishin shtrënguar e ngjitur pas shkëmbit me dëshpërim të vdekjes, me ashpërsinë me të cilën çdo e gjallë është lidhur te rojtja, me atë tmerr që mërgon nga vdekja.

Oh, jeta, jeta, kjo jetë që na lidh kaqë shumë në vuajtjet, në mundimet, në lodhjet, jeta për të cilën durojmë të gjitha të këqijat edhe që i ndaheni me aqë tmerr, me aqë hidhërim!

Përpara meje ish shkëmbi i Ylyncit! një pìrg i trashë, i madh, madhështor, me një bukuri t' egër e të çudiçme.

Përnjëherë shkëmbi u hap dhe goj' e zez' e një dere mbeti e çelur.

S' dinja ku ishe, kisha mbetur nën habi, kur një plak doli nga shkëmbi. Kish mjekër të bardhë si dëborë mali, syt' e kaltërt si ujët e Vjosës. Sa vjeç do qe? A ish gjashtdhjetë, nëntdhjetë, a po njëqind? Apo dyzetë? Se nën flokë të bardhë, kish fytyrën e një djaloshi, plot shpirt e shëndet në sytë dhe në faqet e tij.

- Jam plaku i Ylyncit, më tha edhe më zuri prej dore, si një mik i vjetër, si një shok djalërie.

Pastaj më shikoi në sy. Çudi, ëmbëlsia dhe bashkë me të hidhërimi, butësia dhe keqësia që ishin në këta sy. Ahere i vura re: kish veshur një palë rroba të holla, një farë nape të gjatë, po të bërë me fije të ndryshme që ngjanin të hekurtë! Edhe nga fund' i napës pashë këmbët e çelnikta - po të vogëla e të bukura - të plakut, me thonjë prej rame! Më dukesh se ëndëronja, po s' isha fare i çuditur.

- Ç'ka aty brenda? pyeta.

- Do të shohësh? Eja!

Edhe më zuri prej dore: m'u duk se një frymë, një dredhje gjallimi më rendi në dejet.

Kur u qasmë te dera një mjegull e errët, një tym i hidhur më zuri sytë dhe më dogji gurmazë. Po plaku më preku me dorë, dhe atë çast sytë m'u kthielluan.

Vështrova dhe pashë gjëra të tmeruara!

Poshtë, atje poshtë, fare thellë, shkëmbit kish një shpellë të gjerë, të hapur si një gojë skëterre. Atje ish një shesh mbuluar me gërmadha, me gremina: mure të rrëzuar, gurë të përndarë, lisa të shtrirë mbërdhe, hithra të mëdha si lisa; edhe në mes të gjithë këtyre, nën çdo gur, rrëzë çdo hithre, kufoma, kufoma dhe eshtëra njerëzish, skeletë të tërë dhe të copëtuar, të hedhur shoq mi shoq, të përzjerë me skelete kafshësh, pirge, pirge! Edhe mbi të një gjëllim vdekjeje ish çfaqurë: krimba, perçollakë, gjarpërinj po shtriheshin e shkaraviteshin me gaz të math, duke tundur këto eshtëra, po venin gërmadhë më gërmadhë, si në një pelegrin mortjeje, herë mbi skeletë, herë mbi hin' e trashë që kish mbuluar këtë truall të vdekshëm. Më nj'anë ish një pellg, mbase një det, po i zi e i trumbull, si baltë dhe si serë; buzë këtij pellgu një grumbull prishurina: anije të copëtua, njerëz të mbytur, plaçka të thyera, rroba të çqyera.

Një pluhur i mugët po mbulonte këtë shpellë të vdekjes dhe mbi një kullë gjysëm të rrëzuar pashë një huruvejkë me sy të mëdhenj e rrumbullakë.

Plaku më tha:

- Kanë rrojtur; tani më s'janë.

Një dridhje më nxitoj mbi trup të ngjethur.

- Tani shiko edhe këtu.

Plaku më kish zënë prej krahu, më ktheu më të djathtë pak: Një fushë e gjerë ish hapur përpara syvet të mij.

Pashë një copë qiell fare të kulluar mbi këtë fushë, dhe era m'u duk e mbushur me një aromë të hollë. Luadhet, brigjet, kopshtet e këtij vendi m'u duknë të gjelbëruar dhe tekdo lule, pemë, drurë dhe vijëra me ujë, me atë ujë që jep shpirt, shëndet, gaz dhe gjallim.

Një shumicë qytetesh të zbukuruar kishin dalë nga kjo tokë pjellore dh'e bekuar. Edhe tekdo njerëz të gjallë po lëvrinin, po vinin e vinin, me një punëtorësi të palodhur; atje kafshët bënin një shokëri gëzimi, edhe të gjithë tok, njerëzit dhe kafshët po punonin dhenë, dhen' e bekuar që ushqen dhe gëzon. Aty këtje, nga qytetet e zbukuruar një

tym i kaltërt po lartësohesh drejt qiellit, jo tym prishje dhe rrezimi, po tym pune plot bekim.

- A po i sheh? tha plaku. Po rrojnë.

- Cilët, ç'janë, ç'më thua?..

- Njerëzit, njerëzija; atje ishin ata që rrojnë dhe vdiqnë, dhe ata që vdiqnë pa rrojturë: të dështuarët. Këtu ata që po rrojnë, që po gëzohen dhe shtohen.

Vajta të flas po Plaku ma preu fjalën.

- Këtu e kam; shikoje! - dhe më preku me dorë në ballët.

Një djepe e vogël me një foshnjë të bukur. Foshnja sapo ish zgjuar nga gjumi dhe kish hapur syçkat e bukur si dy këngoj të çkëlqyer; një dorë të butë dhe të kuqe si trëndafil, e kish shpënë në gojë.

- Apo sheh? - më pyeti Plaku. Edhe mbi djepët, në krye të foshnjës, këndova me shkronja të çuditshme **SH.Q.I.P.R.I.J.A.**

Shikova plakun me mirënjohje: fytyr' e tij m'u duk me një ëmbëlsi të pafuntme dhe plot inoçencë si fytyr' e kësaj foshnjeje. Edhe leshrat e mjekr' e bardhë i bënte një brerore të ndritsh, e asaj fytyre dhe atyre syvet plot mirësi.

Po, o tmerr! Ahere vure re se djepeja ish vënë mbi një mur të hollë si kartë, si presë brisku: mënjanë të murit ish ay vënt' i shkretuar i vdekjes, dhe n'anë tjetër luadh i bukur i rrojtjes. Edhe djepeja po tundesh në të dy anët, si një zemberek sahati.

M'u duk se zëmra më qëndroi në kraharor, m'erdhi sikur më ngriu gjaku në rrëmbat. Një frikë më zuri: vallë ku do të bjerë, në hi dhe në serë të kësaj skëterre, apo në luash me bar të njomë t'asaj bote me shpresë. Edhe pa dashur zgjata dorën.

Po një gjë e fortë më shtrëngoi krahun.

- Qëndro!

Shkëmbi u mbyll përnjëherë dhe nuk mbeti veçse faq' e ftohtë dhe' e fortë e tij.

Edhe Plaku më shikoi me sy t'ashpër e të ftohtë: përnjëherë ish çdukur ëmbëlsi e tij dhe tani kish marrë një

fytyrë të keqe e të ngrirë; ahëre i vura re se dhe dor' e tij që më dërmonte krahun, ajo dorë që m'ish dukur aq' e bukur dh'e butë, ish prej guri dh'e ftohtë. Edhe me tmerr e pyeta:

- Po ti, ti cili je? Të njoh, të di, të kam parë, po thuamë kush je?

Plaku më lëshoi krahun, hoqi dorën: i kishte lyer me gjak gishtërinjtë; fytyra i mori një ekspresi të gurtë, shtati j'u rrit akoma. Tani m'u duk si një gjigant, dhe sikur po e shihnja për herën' e parë fare. Pastaj foli mengadalë, duke çkoqur fjalët, dhe me një zë të largët.

- Jam koha. Jam i keq dhe i mirë. Kam nomet e mij. Kam vdekjen dhe gjallërinë. Brenda në këtë shkëmb po ruaj botën. Sa gjëra kanë ardhur e kanë shkuar gjer më tani! Sa popuj kanë lindurë dhe kanë vdekur! Sa yj, sa diej, sa dhe kanë shkëlqyerë dhe janë fikur. Ta dish sa gjëra kam parë, sa gjëra di, sa gjëra shoh, dhe sa të fshehta njoh që do të vinë! E sheh, vetëm Vjosa të kish gojë do të thosh një mijë gjëra. Kjo Vjosë plakë, ky lum i qetë, sa ngjarje ka dëshmuar. Ajo ka parë çetat e Pellazgëvet, ushtërit e Pirosë, legjonet e Romanëvet q'u - goditnë me Filipin, ushtarët e Skënderbeut, allajet e Tyrqeve, njerëzit e Ali Tepelenit, shokët e Tafil Buzit... edhe gjithënjë po ushton e rënkon, se ka parë shumë të këqija, ka vuajtur shumë, i ka ardhur shumë keq, ka qarë. Po edhe ajo është si unë: e kam motër dhe shikon e vuan, po nuk ndërron dot gjë. Se jam koha. Jam i keq dhe i mirë. Kam nomet e mij. Kam vdekjen dhe gjallësinë.

Vlorë, 11 Mars 1913.

OR' E FUNDIT

Një mënd u pandeh se u shua, kaq j'u zbe fytyra dhe mbeti pa frymë; sytë i kishte të mbyllur dhe mustaqet e mëdha të thinjura u epnin buzëve të tij një hije t' errët dhe i rrëfenin akoma më tepër pa shpirt.

Të dy të tjerët u shikuan, me një pyetje në sy, pa guzuar të flasin: në këtë vështrim që të dy kishin tërë ato fjalë, të ngjira mbi buzët.

I sëmuri përnjëherë çeli kapakët e syve dhe u çfaq një vështrim i venitur; pastaj mori një frymë të thellë, një farë psherëtime të hollë, të ngadalshme.

- Si je, Gjok? A je pak më mirë?

I sëmuri ktheu sytë, shikoi t'ëmën dhe, në vend të përgjigjes nxori edhe një psherëtim.

E ëma më nuk pyeti gjë tjetër, po ndënj pranë vatrës. Atje mbi një shtres prej bari ishte shtritur dhe Gjoku, kryet nga muri, mbi një trajsë me bar, këmbët nga vatra; një zjarr i pakt po digjesh, se vjeshta akoma s'i kishte sjellë të ftohtët e saj.

Plaku ndreqi pak zjarrin dhe shikoi të birë. I gjatë, me një trup të shëndoshë, mustaqet pak të thinjura dhe të dëndura, flokt e kokës akoma të zes dhe të shkurtë. Gjoka ngjante të kish në mes tridhjet e pesë dhe dyzet vjeç. Nga brakeshat i ish-in zgjatur këmbët me një palë çorape të tjerura me lesh të kuq e të verdhë; mbi çorapet këputat e qëndisura kishin një ngjyrë më të thellë, duke bërë një rreth të gjerë në mes të bardhët e brakeshavet dhe ylberin e çorapevet.

Gjoku tani kishte çelur fare sytë dhe në këta drita po kthehesh pakëngapak, u epte ngjyrën e vërtetë, dy sy të vegjël larush, me një palë vetulla të dëndura dhe të gjata përmbi ta; vështrimi dukesh pak i egër, si një shkëndijë nëpërmes të një dushku, sado që tani i dobëtuar, nën ballët të ngushtë dhe të fortë.

- Më dhemb, tha Gjoku, dhe shpuri dorën e djathtë në ijët.

Fjalët ishin thënë fort me ngadalë, si një murmurim të shokëruar me një psherëtim, një të marrë frymë të thellë.

Plaka shikoi, u ngrit dhe j'u qas të birt.

- A të dhëmb, Gjok? Po mos ki frikë, Marku ta ka lidh mirë dhe nuk është plag' e rëndë.

I sëmuri s'e kishte silahun në brez, dhe atje ku kishte shpënë dorën, nën xhamadan dhe jelekun, dukesh një lidhje e madhe, e gjakosur, e gjerë.

- Do të shërohet, tha Gjoku, si me pahir, me një zë më të lartë dhe të kthiellët.

Mëma ndënj pranë të birit nga kryet; është një grua e thatë dhe ligur, shtati i shtrënguar në xhokën e ngushtë, flokët fare të bardhë, të shtrënguar më një shami, fytyra e rrudhur, po e shëndoshë, me energji, syri i mprehtë, sado i lodhur pak prej një jete të gjatë.

Nga ç'kishte pasur në jetë tani vetëm ky djalë po i mbetet. Një çupë e ka të martuar në bajraku fqinjë dhe ka gjashtë vjet ta shohë. I shoqi, edhe plaka kurdoherë që zë ngoje emrin e plakut të saj e ndjen veten madhështore, ka më tepër se njëzet vjet që është varër, me një goditje, më një luftë në mes dy fiseve; kishte mbetur e ve me Gjokun, me të bijën Maro dhe me Hillin, djalin e math të saj, shtylla dhe pshtetja e shtëpisë,

gjithë shpresa e saj. Po edhe Hilla dy vjet më parë ish vrarë, ahëre kur u derth kaq gjak për shkakun e shtëpis' së Dedës, dhe ku ranë kaq trima më të dy anët. Të dy djemt' e Hillit, Prenku me Gjeloshin, janë në Shkodër, punojnë, fitojnë për veten' e tyre, se e ëma u ka vdekur tetë vjetë më parë.

Plaku këtu po mban shtëpinë, me Gjokun, i vetëm i një barku dhe i një brezi.

- Pak ujë, nën, foli i plagosuri.

- Epi një, Mark! - tha plaka me një zë që kishte qënë kurdoherë urdhëronjës.

Ay që quhesh Mark kish ndënjur më një çip të odës, mbi një shkam me tri këmbë dhe pinte cingar. U ngrit, mori stamnën nga polica, u qas në shtrat të Gjokut dhe, duke vënë gjunë mbërdhe, ja prieri grykën në gojë të sëmurit; ky piu tri gëlltime, dhe shikoi Markun, me një sy miku, sikur për t'ju falur nderi për kujdesin që mirrte dhe kishte marrë për të, sikur dhe për të pyetur qysh ja sheh plagën.

- Kurajo pra, tha Marku, do t'shkojë, nuk a gja.

Pastaj, vajti dhe vuri stamnën në vend, duke tundur xhufkat të guberës; dhe ndenj prapë në front, me cingarin e trashë në gojë.

Një pushim i thellë erdh në odët. I plagosuri po shikonte trarët e nxirë të tavanit, i thelluar dhe ay më një farë ëndërrimi, me një shikim të palëvizur. Plaka kishte zënë të dy gjunjë afër krahorit, dhe dukesh e drobitur, po syt' e s'i ndante nga fytyr' e të birit.

Përnjëherë dera u çel dhe një zë i ngadalshëm e i butë u dëgjua:

- Qolldo Krishti!

- Gjithmon e jetës! - thanë përnjëherësh plaka dhe Marku; e para vetëm kryet ktheu, Marku ishte ngritur.

- Si je Mark, si është i sëmuri?

- Ma mirë, at Pjetër.

I ardhuri ishte një prift, me rroben e gjatë të zezë, me mustaqe të verdha e të holla. J'u qa të sëmurit dhe e shikoi.

- Je mir, Gjok? qoft' e shkume!

- As po nji farësendi, atë.

- Mramë vonë e digjove si ngjau puna, edhe sot po vij me t'pa. Po mos u tut, tash qi ke Markun, aj të shëron, se kurrkush nuk di ma mir se ay ilaçet e varrave. E ti nanë, si shkon?

- Djali, atë Pjetër, djali.

- Zoti do ta bajë mirë.

- Nuk e ndjej fort mirë veten, më duket se jam liksht, tha Gjoku.

Prifti ju qas Markut dhe e hoqi fare në çip t'odës; ndënjë mbi dy shkam të vegjël.

- Lere kafen tani, ma ban pastaj, po kallxoma si ngjau puna.

Edhe Marku një nga një, me ngadalë i rrëfeu gjithë ç'dinte mbi varrimin e Gjokut: ky dje kishte dalë herët të vejë në katund Dardhë, ku ishte thirur për një gjyq, si plak; kur kishte arritur në kufi të Pukës, tek shkonte nga dushqet e mëdhenj, prapa gurëve që varen mbi liqenët, ishin hedhur pesë pushkë, dhe Gjoku kish rën' i plagosur.

- Si e ka plagën, Mark?

- Besa të rëndë. Plumbi është i martinit dhe ka mbetur brenda. Kujtoj se mir ja kam lidhur, po Gjoku sot asht fare ma i dobët se dje.

- A kujton se e kanë vra djemt' e Palokut?

- Po besa, bash ata, Mirashi me Gjeloshin, për me marrë gjakun e plakut tyne; vendi ku ka kris pushka atë kallzon, dhe Gjoku nuk i ka uha tjetër kujt noj' gjak.

- Mirë, Mark, tash mbaroma nji kafe.

At Pjetri ndenj i mejtuar. Syt' e tij të kaltërt shikonin në erë, shikonin pa parë gjë. Kur i ktheu këta sy mbi Gjokun dhe mbi t'ëmën të pshtjellë pranë shtratit të birt, një mëshirë dhe një trishtim i thellë po këndohesh në ta.

Prej s'ëmës së tij at Pjetri ishte kushëri me tan' e Gjokut. Ish edhe ay një djal' i këtyre maleve shkëmborë, në këta pyje dhe mbi këta gurë kishte bredhur kur ishte i vogël, bashkë me kecët e zes. Fati ca kohë e kishte hedhur në Shkodër, me t'ungjin; n'atë qytet kishte hyrë në shkollë, duke qarë dhe padashur, dhe pastaj kishte marrë shijen e mësimit; djali i egër i kecëvet ishte bërë një shkollar i butë dhe i rregullshmë; kishte hyrë në shkollë të fretnëvet, dhe duke dalë me një diplomë të mirë ishte çuar jashtë, në një

shkollë të madhe të marrë një diplomë më të mirë dhe më të lartë. Kur ishte kthyer në Shqipëri, Pjetri i ri, mezi njëzetetrevjeç, po kthehesh me ide fare të ndryshme, fort të largëta prej idevet që kishte pasur si djalë kur bridhte prapa kecavet, shumë të pangjara me mendimet që dëgjonte në shtëpi të tij prej t'et dhe prej miqvet, me ato histori të vrasjeve dhe të gjakëve të pa reshtur kurrë.

Marku i pruri filxhan' e kafesë dhe i ndënj pranë. Prifti zu të pijë kafenë dhe nuk i foli. Prapë mejtohesh dhe nuk shikonte gjë. Prapë një pushim mbretëroi ca kohë në odët. Pastaj Pjetri përnjëherë tha:

- Dëgjo, Mark! Puna tani është fare e kthielltë. Gjoku u varru nga shkaku i gjakut që kishte hua. Tani kujtoj se nuk mbeti as për të dhënë, as për të marrë, sadoqë Gjoku kishte hua një vdekje dhe vetëm u varrua. Po edhe ti më thua se është keq, tepër' rënd' i goditur. Edhe un' ashtu e shoh. Dua pra që të mbyllet zihja sa është gjallë, sa pa vdekur. Si jam kushëri me të, edhe ti një fis i afërm je. A thua se munt t'i pajtojmë? Të thërresim Mirashin.

- Thui, pra, njëher, tha Marku; edhe mua më pëlqen qi të pajtohen.

Prifti u çua më këmbë dhe shkoi së largu të sëmurin. Edhe ky nga vendi që ishte rënë po e shikonte, sikur donte të përgjojë fjalët dhe mejtimet e tij. Prifti në këta male kishte një emër të mirë, kishte më tepër se dhjetë vjet që këta vende që punonte për shpirtin dhe për zëmrën e të varfëre malësorë, kishte lënë qytetin dhe kishën e Shkodrës për një çelë në këto bjeshkë.

- At Pjetër, tha Gjoku me zë të dobëtuarë. Epmë bekimin tant.

- Zoti të ndjeftë, vëlla, tha prifti duke shënjuar.

Pastaj mori nga muri një kryq, një kryq prej dru arre të moçme, mbetur në këtë shtëpi prej pleqet.

- Të ndihmoftë Zot' ynë, Gjok, - edhe ja qasi në buzët, mbi krahërort. I sëmuri e puthi kryqin dhe psherëtiti; një çast dy vija të gjata ju formuan më të dy anët të buzëvet,

ballët ju rudh, dhe shtrëngoi dhëmbët. Dukesh që ishte nënë kafshim të një dhëmbjes së madhe.

- Dëgjo, Gjok, tha Pjetri pas një pushimi. Ke simbolin e Zot' ynë që është kryqëzuar për të shpëtuar në fajtorët. Krishti ka thënë që fajet e armiqtet t'ja u ndjenë. Ti ke besim ne Krishti, o Gjok?

- Po, at.

- Pra, Gjok, kujto shpirtin tand. Mundet që të thërritesh sipër në qiell. Unë dua që të thërresim Mirashin me Gjeloshin dhe të pajtohi, t'ja duroni shoqi- shokut.

Gjoku shikoi priftin dhe çeli sytë, si një njeri që s'kupton ç'i thuhet.

- Po ata më kanë vrarë!

- E di, u përgjigj prifti; po edhe baba yt u kishte vrarë atin e tyre. Tashti ata gjakun e vet muarnë. Unë kam lajme se ata duan me u pajtu me ty. Gjaku u la, dhe kjo punë të mbarohet.

Gjoku s'foli. E ëma ishte ngritur më këmbë, dhe Marku ishte qasur; i sëmuri i shikoi që të dy, me pyetje në sy, dhe me çudi, Sikur s'kuptonte ç'i thoshte prifti.

- Mirë thotë at Pjetri, është drejt, tha Marku.

Plaka nuk foli. Për atë gjithë puna ishte jeta e të birt.

- Dëgjo edhe ti mëmë. Zot' yn Krishti ka shogruar veten e tij që të na shelbojë neve; ka vdekur mbi kryq, ka derdhur gjakun e tij për mëshirën e njerëzisë, për të na shpëtuar prej fajit. Dhe ky Krisht ka urdhëruar mëshirën e njerëzve, durimin e fajeve, dashurin e përgjithëshme. Vetë Zot' ynë u ka duruar fajin e atyreve që e munduan, që i derthnë gjakun e tij të perëndishmë. Edhe mbi kryq, ahëre kur trupi i tij ishte çpuar me thumba, edhe ahëre i lutesh t'et në qiell që të përdëllejë dhe të ndjejë njerëzit. Këtë mëshirë dhe këtë durim ma ka urdhëruar Krishti. Këtë po i urdhëroj dhe unë Gjokut në emër të Krishtit, në do që të shelbojë shpirtin e tij dhe të vdesë si një i vërtet i Krishterë. Folë dhe ti, plakë, se je mëmë e këtij njeriu.

Plaka shikoi të birë, Markun dhe priftin, me radhë.- Ke

të drejtë at Pjetri, tha.

I sëmuri s'po fliste. Dhëmbët i kishte shtrënguar dhe sytë i kishte të vegjël dhe të shkëlqyer tani.

- Mirë, at edhe unë do ta fal.

Mbi këto fjalë Gjoku bëri të ngrihesh pak, u pshtet mbi bryllt dhe drejtoi kokën. Shikoi priftin Pjetër. Pastaj prapë, e një zë të unjët foli:

- Po më dhëmb... Mirashi me Gjeloshin le të vinë... Po ata më vranë, ata!

Fjalën e fundit e kishte thënë me zë të fortë dhe kishte ngritur kryet. Po shikonte vrimën e tymit në tavan, të nxirë dhe ngarkuar me blozë. Pastaj pat një klithje, një zë të egër.

- Ata më vranë, të dy. Jo, nuk' i fal. Ah!...

Fytyra i ishte kruspulluar, sytë egërsuar. Këta sy i qepi mbi Markun, e shikoi ca kohë. Pastaj koka ju var; me një psherëtimë të hollë u lëshua mbi jastëk. Sytë i qenë mbyllur dhe faqet i ishin zbehur.

- Zoti u ndjeftë! tha prifti dhe u shënjua.

Shkodër, 25 maj 1913.

SHTEPI E DJEGUR

Më një ditë të nxehtë të qershorit, një nga këto ditët ku vapa duket dhe m'e madhe e m'e padurueshme se kurdoherë, dy udhëtarë po shkonin udhës, hipur më dy kuaj. Dielli sot diqte me shkëndija të prehtë, një vapë ishte përhapur në atmosferë, një i vërtetë zjarr i hollë. Era nuk frynte aspak, dhe njeriut i dukesh sikur s'merr frymë erë, sikur i mungon një gjë për mushkëritë.

Të vrarë nga dielli i pamëshirshëm, edhe kuajtë kishin unjur kryet; koka u rëndonte mbi zverkun dhe çapet i hidhnin me pahir në një ecje të përtuar, si në ëndërr, me këmbë të lodhura. Edhe shumë herë befas qëndronin, të mërzitur prej udhës dhe prej barrës.

- Kurrë s'kam ndjerë kaqë vapë në këtë udhë. Edhe kuajt e gjorë mezi ecin.

Edhe i ra kalit pak me këmbë.

Askush nuk dukesh mbi këtë udhë. Një pluhur i hollë kishte mbuluar shosenë, më shumë vende të prishur dhe me gurët jashtë. Më të dy anët bar' i thatë, i verdhur; ca gjinkalla cinxëronin me një zë monoton, një cinxërim pa asnjë farë ngjarje me një zë të gjallë, sikur ishte një shkërvitje hekri, një kërcëllimë dy copë metali.

Arat, pak më tej sapo kishin zënë të verdhen, dhe kallinjte po unjin edhe ata kryet e bekuar të tyre drejt tokës' së zezë, drejt asaj balte që i kishte rritur dhe tani po i ushqente.

- Shiko, Mark, edhe Drini po duket i zi; nuk ngjan fare me ujë.

- I ngjan njeriut se do të jetë vaj i zjerë, - u përgjigj shoku. Nganjëherë me të vërtet dukesh Drini me një ujë të pak, shpesh një pjesë e madhe e shtratit të tij në të dalë. Edhe ata ujë të pak sikur nuk' ecte, flinte, mbytyr prej vape.

Pas pak udhë, ish një copë shose ku më të dy anët ngriheshin disa shelge, kur arritnë këtu, në hijet që bënë drurët, kafshët qëndruan përnjëherë, vetvetiu, pa pasur nevojë që t'u flasë i zoti.

- Nevoja po i bën të mënçëm kafshët, Shyt; shiko si qëndruan!

Të dy përnjëherë muarë një frymë të thellë; u dukesh sikur po hynin në një botë tjetër. Hija po thua se mbulonte gjysmën e rrugës për së gjëri, dhe kuajt kishin me të vërtet majft mend që të qasen rrëzë trungjeve. Në mes të fletëvet sikur donte të këndonte një zog, i lodhur e i rënduar. Asnjë fletë s' lëviste, po hieja kish freskërin e saj.

Të dy udhëtarët tanë kishin hequr kësulata e tyre të mëdha me strehë të gjerë. Fytyrat e tyre të skuqura dhe të qullura, duallë në shesh. Një ndjenjë lehtësimi e çlodhi trupin, të lodhur prej kalit dhe prej diellit.

Tani munt t'i shuqajmë udhëtarët. që të dy ishin sy gështenjë. Leshrat me ngjyrë të thellë, po njëri, ay që dukesh pak si m'i math, i kishte më të zes. Ky do t'ish afro njëzetedyvjeç; një mustaqe e hollë i zburonte buzën e sipërme. Tjatri, m'i riu, s'mund të kishte më tepër se tetëmbëdhjetë vjeç. Që të dy kishin fytyrën të skuqur, të ligur, po me një cipë të kthielltë, me një të dukur simpatike, dhe, vëllezërit e tyre dukesh që së largu, kaq ngjanin me njëri tjetrin.

- Tani edhe pak udhë na mbeti, tha Marku, m'i vogli i vëllezërve; afro edhe gjysm' ore. Do të jemi pra në vend më parë drekës. (Pas një pushimi): Bëmë liksht që s' duallmë ca më herët nga Shkodra; s' do të kishim hequr kaqë vapë.

- Po sa mban Barbullushi? - pyeti Shyti.

- Më këmbë është afro katr' orë; po edhe këta kuajt sikur ecin më mirë... Mjaft qëndruam, më mirë të shkojmë dhe

të mos humbasim kohë. Atje ka hije më të mirë.

Udha tani kishte nga një dru aty këtje, dhe mal' i Barbullushit kishte zënë të afrohet, ky brek i ngushtë e i gjatë, mbuluar me gurë.

- Shiko, Shyt, u duk kisha!

Me pak mundë arritnë përpara kishës. Eshtë një godi e shëndoshë më të mëngjërë të udhës, rrethuar me një mur katërçiptë. Përpara, në mes flatores dhe rrugës, një vend i vogël, një luadh mbjellë me bar, mbetur i njomë dhe i gjelbër, nënë hien e gjerë të një lisi shekullor.

Atje kuajtë prapë qëndruan, po jo më tepër se dy minuta.

- T'i ngrahim, - dha urdhër Shyti.

Edhe të dy vëllezërit ecnë pak më poshtë, pastaj bënë më të djathtë.

Dukesh që ishin në fshat, kishte drurë, mure, gurë dhe qeramidhe mbërdhe, edhe ca gjërra të zeza si dhoga, si rrecka të djegura.

- Do të shosh, Shyt, afëro gjysmën e fshatit e kanë djegur! Nuk' arritnë sa na bënë që të vuajmë brënda në Shkodër, me ata topat e tmershëm që nga shtinin dit', e natë, po na doqnë dhe shumë fshatra. Tani edhe mirë s'e di, po më duket se e doqnë të dy bashkë, edhe serbët edhe malazestë.

Shyti po dëgjonte pa dhënë përgjigje, edhe po shikonte. I dukesh sikur po i shihte për herën e parë fare këta vënde. Këtu kishte lindur, këtu kishte zënë të ritë. Gjer më tetë vjeç s'kishte dalë fare nga ky fshat; pastaj kishte shkuar' afro dhjetë vjet në Shkodër, dhe më vonë kishte qënë jashtë Shqipërisë, në dhe të huaj. Atje, në dhe të huaj, çdo ditë kishte ndjekur në gazetatat e mëdha luftën e Malit të Zi kundër Shkodrës, sikundër që kishte gjurmuar dhe kryengritjet, goditjet e malësorvet me ushtrinë turke, djegjet e shtëpive prej kësaj ushtrie, të vuarat e atyre malësorëvet në Mal të Zi.

Në kohë të rrethimit Shyti kishte rrojtur një jetë plot

hidhërimet lark shtëpis' së tij. Çdo ditë i dukesh sikur gjyle e armikut po vente dhe pëlciste mbi shtëpin' e tyre, n'atë Shkodër të gjerë, në shtëpit' ku e dinte që kishte zënë vend i ati dhe' e ëma, vëllai dhe të dy motrat. Me të mbaruar lufta, Shyti ish nisur që të kthehet në Shkodër, po ishte ndaluar në zall tjetër t'Adriatikut, të pres sa të dalin malazeztë prej qytetit shqiptar, të vej' e ta shohë vendin e tij të pastruar prej armikut. Edhe më të dalë shqau, me vaporin' e parë kishte rendar në të dashurën Shkodër të tij. Të dashurët e tij i kishte gjetur të ligur dhe të verdhë, shumë të vuajtur, po gjallë. Për fshatin dhe shtëpinë, tani vjen t'i shohë.

Hynë në një rrugë, e ngushtuar në mes dy nureve t'unjur bërë pa gëlqere, një çip i tyre i rrëzuar.

- Na shtëpi e Dedës! Harrova të vete ta shoh në Shkodër. Si i ka djemtë, Mark Ndujin me Ndrenë?

- Janë mirë tani, po vuajtnë fort shumë; një çup' e vogël e Ndujit vdiq urije, dy javë para se të bjerë Shkodra.

Shyti më s'foli; një pikëllim i kyçi gojën. Vapa më nuk ndjehesh, se drurë të mëdhenj epnin një hije të trashë.

Pas asaj shtëpie që Shyti e kishte njohur për të Dedës, të dy vëllezërit bënë më të mëngjër; më s'ishte rrugë; kishte një farë gjerësije dhe në ballët ishin dy shtëpi, dy gërmadha që kishin qënë njëherë ndënjtje. Të zezët e finestrave, mungimi i pullasit, rrëfenin që dhe këtu ishte shfryrë keqësia e shqehve.

- Të mjerët Kolë dhe Lekë, tha si me vete të tij Shyti. Kali bëri dhe disa çape, e ktheu më të djathtë, hyri më një si oborr. Të dy qëndruan dhe u zbritnë kafshëve.

Shyti zuri fren' e kalit dhe mbet më këmbë:

- Zot, qysh qënka bërë!

Nga shtëpi e tij vetëm muret kishin mbetur, mure të thatë me tri finestra, si tre syre të verbër rrethuar me nga një rreth të zi. Dera e çelur, a më mirë vendi ku kishte qënë dera, dukesh si një vrimë e hapur me shatë, e prishur në mur.

Edhe Shyti mbet si i ngrirë, pa guxar të flasë, pa lëvizur nga vendi.

Marku po lidhte kalin në një fik, erdhi mori edhe kafshën e të vëllajt dh'e lidhi në një degë tjetër.

Me kokët t'unjët, Shyti, mendruajtje të madhe, kapërxeu prakun e asaj që kishte qënë një portë. Hyri brenda: trualli mbuluar me hi, me ca vjetërina të shkumbëzuara, ca copë drasa gjysmë të djegura, dhe një tok qeramidhe, gurë dhe gëlqere të rënë prej pullasit dhe murevet. Kishte qënë një shtëpi me dy kate; tani katër mure të çpuar dhe të zbuluar, një vend i zi e me pluhur.

Dolli prapë jashtë, me zemër të thyer. Në kopsht drita ishte e fortë dh'e shkëlqyer. Dhe ndënj mbi një gur.

Shikonte muret. Atje kishte lindur edhe vetë, edhe i ati. Afër tij, përpara këmbëvet, pa ca purteka hekuri; i hoqi me dorë, dolli një hekurishte me një copë llamarinë.

- Mangalla që binim zjarr.

Edhe e la prapë atje, në mes të tjegullavet e të hirit.

Prapa gurit ku rrinte ishte një shegë, një dru i vogël, i shhkurtër po i dëndur, degat e dënrura mbuluar me gjethe, një gjeth i gjelbër dhe i shëndoshë. Lule të kuqe çelnin palët e shkëlqyera të tyre drejt dritës' së diellit, e shikonin zjarr e math drejt në sy dhe thëthinin ato shigjeta të flakta, me kurajo, me energji, të kënaqur prej kësaj vape. Përpara këtij shkretimi të pikëlluar, bima po ngjallesh në jetë, dhe pemët e kuqe me lëng, po lidhnin farat e tyre, plot bekim, me vullnet të rrojtjes dhe të prodhimit.

- Sa shegë t' ëmbëla që na ipte ky dru!

Marku s'foli; edhe ay ishte në hije të kësaj peme, afër të vëllajt.

Shyti i ndau sytë nga muret e shtëpisë, vështroi më të mëngjër. Pak çape më larg, ndarë me një mur t' unjët prej shtëpisë së tyre, ishte një godi tjetër, pothua si e tyreja, edhe ajo e djegur, me finestrat e zbrazura si sy të verbër, me rathë të zes.

- Edhe të Llesh Prenkës e paskan djegur! pastaj shikoi

me më tepër vërejtje finestrën e sipërme, atë që ishte nga ana e kundrejtme e shtëpis' së tyre, dhe shtoi: Përpara asaj finestre ish një kuti plot borzilok. Mara e ujiste çdo mëngjes.

Mbet pak i menduar. Mara ishte një syzezë, e gjatë me gërsheta të trasha, një çupë me një gjak të gjallë në vështrim e në buzët. Mara ishte pothua e vluara e Shytit.

Marku kishte qasur kuajtë dhe guxoi:

- Më mirë të nisemi, që mos të vonojmë.

U hipën kafshëvet, dhe potkonjtë zunë të goditin gurët e udhës dhe të tronditin thyerishtat e shpërndara mbërdhe. Pa u mërguar fare qëndruan një mën kafshët dhe shikuan. Më duket se Shyti kishte syt' të njomur, kaqë hidhërim kishte vështrim' i tij.

- T'i bëjmë prapë, dhe munt t'i ndreqim më mirë se ç'qenë, tha Marku, si një ngushëllim për veten' e tij.

Shyti s'foli, po ecën, shkuan prapë prej atyre rrugëve nga na kishin ardhur, panë prapë ato shtëpi, ca më këmbë dhe të paprekura prej zjarrit, ca të shkretuara prej flakës. Përnjëherë Shyti foli:

- Jo, Mark; më mirë t'i lëmë kështu. Të mos harrojmë ç'na bëri shqau.

Në vapor midis Shëngjini dhe Vlorë.

3/16 Qershor 1913

AY MAL

- E sheh atë mal, biro, atë majë të shkëlqyer? E sheh si ndrit nga dielli? A e vë re qysh kryt vete gjer në qiell, më lart se retë?

Ay është Tomorri, mali plak i Shqipërisë tënë. Synë e ka gjithnjë mbi këtë det tënë. Ecë më të djathtë, biro, ecë më të mëngjër; shko nga fryn veriu i freskët, nga vjen jug' e vakur e ke për të parë majën e tij, që del mbi malet e tjerë, që ngrihet mbi fushën e gjerë.

Eja, biro, të vemë ne mali plak. Edhe im' atë ka vajtur atje. Edhe gjyshi im, edhe gjyshi i gjyshit është ngjitur n'atë majë. Më kanë thënë të moçmit tanë, ata që na kanë ruajtur dhe na kanë lënë këtë dhen' e Shqipërisë, venin atje sipër si në një vend të shenjtëruarë, venin të vizionin atë majë të zbardhur dhe të shkëlqyer prej viteve.

...

- Udhë po bëhet e rëndë, kam frikë mos lodhemi.

- Ecë, biro, mos shiko gjithnjë përprjetë; shiko dhe një herë poshtë. Shiko sa udhë kemi marrë, sa jemi ngjitur. Edhe pak' kurajo e do jemi në majët.

Ky që përgjigjesh kështu është ati. Të dy, me të birë, kanë marrë udhën e malit, veshur lehtë, një shkop në dorë, një trajsë në kurris. Djali do ish nja dymbëdhjetë vjeç, i ati nja tridhjet' e pesë.

Edhe po ecin që të dy me gëzim, si dy shokë, jo si at' e bir. Të dy janë të shëndoshë, dielli u ka skuqur faqet, një djers' e hollë u njom ballë të gjera, të çelura, se kësulën e kanë hedhur prapa, dhe flokë leshi dalin nën të, leshra më gështenjë si dhe syt' e tyre. Thotë njeriu se janë dy vëllezër,

aqë janë të qeshur. Një të penguar, një trap për të hedhur, një shkëmb përpara udhës, një zok që u priste udhën, një drizë e kërrusur, një vij' e vogël që rrëkëllesh nga brinj' e malit, të gjitha i vinin në gaz, i bënë të qeshin. Thoshte njeriu se nuk lodheshin, po sa ngjiteshin aqë më tepër një fuqi dhe një zell të ri gjenin.

...
- Puth dhenë, djalë, se jemi në majë të malit. Kok' e një mali plak s'mund të shkelet si një kodr' e fushës; këtu jemi në prak të qiellit.

Mos u tremb s'na prish kjo erë. S'është' er' e moçalit, as er' e luginës së thellë. Dëbor' e qiellit vjen çdo mot dh'e pastron këtë krye të venerishme. Këtu çdo gjë ka një bukuri; duhet respektuar si një gjë e bekuar.

Shiko tani, djalë. Nuk sheh a? Na, merr këto qelqe dhe shiko.

- Atë po shoh tani fort mirë; më duket sikur më dhe një palë sy të rinj.

- Janë syt' e zemrës, djalë.

...
- Shiko më të gjith' anët. Këtej sheh Shqipërinë tënë. Na më të mëngjër këtë det të kaltërt që na pushton gjithë tokën e perëndimit. E sheh si është' i shtrirë, i qetë dhe i butë! Ky është' Adriatku, i kaltërt si një rrobë mëndafshi, i kulluar si një copë qielli.

I sheh ata male atje tej? Thotë njeriu se janë vëllezrit e këtij plaku të bekuar. Ata janë malet shkëmborë të Shkodrës; janë si një varg ruajtës besnikë në mes tënë dhe t'armikut të përjetshëm. Rrëzë tyre është shtrirë, afër atij liqeni të gjatë Shkodra, e mbuluar me gjethet e drurëvet.

Eja më këtej, djalë. Vëri re mirë kësaj majë që ngrihet mbi ata male rrëmujë: është mali Kavanjë, afër të cilit është mal' i Skëndërbeut. Mos zër ngoje kurrë kët' emrë të math pa një respekt të thellë.

I sheh ata brigje, atje sipër Shkumbinit? Ata janë malet e Dibrës dhe Matit, ujitur me shumë gjak shqipëtar, gjak

të ndershëm dhe të bekuar që rrodhi për mprojtjen e mëmëdheut.

...

- Shiko fushën e Myzeqesë, shih Beratit t'ënë që duket si nën këmbë të Tomorrit, nën hije të tij, me ato kisha të moçme brenda në fortesë.

Kthehu nga jugu. A i sheh atje tej malet e Sulit, të Filatit, të Janinës... E sheh sa e bukur është Janina, mbi atë liqen të kaltërt, me atë xhami të bukur mbi fortesët...

- I shoh, at, po shoh edhe ca njerës që më duken të huaj.

- Pusho, djalë; mos lëndo një plagë. Edhe ata male duhet të jenë ruajtësit midis këtij vendi tënën dhe t' armikut të përjetshëm!

Ngjitu tani drejt burimit të Vjosës, të këtij uji të kulluar tënë. Vazhdo fushën e gjerë që kemi nën këmbë, ecë lart atyreve grykave t' egëra, po të dashura, dil në Pind.

Tani ktheu nga lind dielli në mëngjes, dhe shiko mirë djalë, se janë kaq' gjëra të vërejshme.

E sheh edhe Gramozin e madh, me ballë mbuluar me pyll. Andej buron Devoll i uruar që na shkon këtu pranë. Sheh pastaj edhe këto të dy tepsit' e ergjënta? Ata janë liqenët e këndshëm të Prespës e të Ohrisë, ujë të kulluar si ergjënt i derdhur.

Lere Drinin e vjetër, le të oshëtijë në gryka e në male; lere, le të vejë afër Shkodrës. Shiko atë mal të gjatë, më të gjatë dhe më të madh edhe se ky Tomorr; është Shari, madhështor në mes t' atyre fushave pëllore, t' asaj Kosove që ujit djersa e atyre njerëzve të shëndoshë dhe të gjallë.

- At, më duket se edhe këtu ca këmbë të huaja...

- Pusho, djalë, mos lëndo një plagë. Më tej atyre fushave, ata male të vegjël, ata ndajnë dhen' e bukur të Shqipërisë prej truallit t' armikut.

...

Që të dy po shikonin. Rreth tyre ish një pushim i thellë. Shkëmbenjt e moçëm thua se kishin vënë veshin dhe po dëgjonin. Nga çdo anë dheu i bekuar po zgjatesh, në fusha,

në brigje, në male, i vijosur prej lumenjëve, me ca njolla të kaltërta si ergjënt i derdhur.

Të dy tani dukeshin si të rritur, dukeshin si dy shqiponja të varura në qiell. Dheu u dukesh kaq larg dhe kaq poshtë!

- Merr këtë erët të pastër, biro, se më s'ë ke për të gjetur përposh. Edhe shpes i malevet këtu vjen dhe kërkon fuqi për krahët; shqiponja këtu e mpreh sqepin, kaprolleja këtu u ep ujë këmbëvet të çelnikta, ret' e qiellit këtu vinë dhe mbushen me shi, dëbora këtu zbardhet, rrufeja këtu e merr zjarrin.

Rri e patundur kjo majë. Po ruan Shqipërinë. E kapushtuar me shikimin e saj.

Djali po dëgjonte i mejtuar sytë atje larg. Përnjëherë një hije shkoi përpara syvet:

- At, sa e vogël qënka Shqipëria jonë!

- Mos blasfimo Perëndinë, - thirri i ati i keqësuar. Mos poshtro veprën e të madhet Zot. Kjo Shqipëri që të duket e vogël, është dhurat' e Zotit, ka një vleft' të madhe ne zemërt tënë.

Kjo baltë që sheh është mburjtur me eshtërat e të parëvet tanë, me qindëra gjyshër e stërgjyshër' që nga kohët e errëta të shkuara. Këtu në këtë baltë kanë eshtërat e tyre të bëra pluhur, të lagura prej shiut, që dërgon ky mal.

Gjithë këtu janë të lumtur, a të vuajtur, gjithë mbi këtë dhe kanë mbirë dhe atje janë shtrirë në fund. Ky dhe ku është pluhur i parëve, kjo baltë mbi të cilët piqet kalliu dhe ngrihet dushku i hekurt, ky truall ku tingëllin fjala "Zot" në gjuhë të shqiponjës, kjo tokë është Shqipëria jonë, e lënë prej të parëvet në kujdes tënë, që ta ruajmë, se është e bekuar, është mëmëdheu ynë.

Sofia, 25 9-brë 1914

NAIM BE FRASHERI

Akoma s'ish zbardhëlluar kur u hap dera; se pa marrë përgjigje, pritnja të më thoshin të ren' e ligë; Naim beu është fare keq! Këto pesë fjalë më dredhin mishtë. Naim beu është keq! Kishim katër vjetër e gjysmë q' e qanim këtë njeri të madh; e dinim që sëmundja s'i kish shpëtim! Po kujt i vente goja? E dinim, po s'donim të besonim...

E shtuna në familjen tënë është dit' e nëmur, dit' e zezë. Ashtu shoi të shtunën me dy orë të mëngjesit, 7 Vjesht' e 2-të 1990, një jetë që kish nisur më një të natës duke gdhir' e hënë, më 13 të Majit 1846, në Frashër.

Na' ku është ky njeri i dashur! Na ku rri shtrirë! vjen të pyes si je... shiko po më përgjigjet... po më thotë, pas zakonisht që kish, me zë t'unjët e të ëmbël "Prapë ashtu jam!... ah, ç'them unë! ato buzë më nuk lëvizin, ata sy më s'shohin! S'i kemi për të dëgjuar më zënë! Kur të kemi ndonjë hall, më s'kemi kë të pyesim! s'ka se kush të na japë këshilla! S' ka kush të na japë kurajo dhe shpresë!

*) Ja

Këtu fillosofia dhe mëndja s'hyjnë më punë; nj' e tillë mënxyrë s'ka ngushëllim; këtu njeriu le ç'ka mësuar, le stërvitjen, le mëndjen dhe bëhet foshnjë; zëmra zbulohet nga pëlhurët. e njerëzisë dhe bëhet siç është te foshnjeja, ashtu si e bëri Perëndija! Buzët janë pa zë, po zëmra qan! Njerëzit e shtëpisë janë të gurosur, vetë, lottë u rrjedhin, krahorët po psherëtitjnë! Sa zi, sa helm mbi këtë fëmijë!

Me Naim benë nuk humbasim një gjëri të dashur, një të madhin e fëmijës, po një mësonjës, një këshillonjës, një atë! Edhe jo ne vetëm, po gjithë Shqipëria.

Tërë dita tërë nata shkon në helm e në mejtime; s' duam të flemë, duamë t' i rrimë pranë, se... kjo është nat' e fundit! Paskëtaj syt' e trupit më s'kanë për të par' atë Naim! Vetëm mëndja e ka për të kujtuar dhe ka për të qarë.

Një nga miqtë nxjerr nga xhepi "Lulet e verës" dhe na thotë: Paskëtaj për ne këto fletë janë Naim; ay shkoi vate te e vërteta, po këto mbenë! Këndon "Të vdekurit". Në këto vjersha zemëra dhe helmi na gjen nj' ushqim:

*Po vallë ku vanë?
Për jet' u mërguan?
Apo u ndryshuan?*

E djela gdhiet, kjo është dit' e fundit; sot do vihet në gjit të dheut, të këtij dheu tek i cili venë gjithë njerëzit, të mir' a të liq. Sot do të fshihet për jetë nga bota fytyr' e këtij njeriu të dashur e të rrallë! Sot do lihet të kalbet më pak kohë ky njeri që natyra ja ka të rrallë shokët, dhe s' i pjell veç se më ca qind vjet një herë.

Shikoni këta njerëz! Sa helm ka mbi fytyrët të tyre! Shihni se janë të shumë: ka nga çdo fe, nga çdo vërsë, e nga çdo radhë.

Këta e njihnin në gjallëri: vinin e i kërkonin këshilla, vinin e pyesnin për çdo punë. "I varfërë vinja te Naim beu, i pasur shkonja; i urët vinja, i nginjët shkonja; pa shpresë vinja, plot shpresë shkonja; me shpirt të sëmurë vinja, kur

shkonja ndjenja vetnë të gjall' e me shpirt; fjalët që na thoshte na shëronin zëmrën!" thotë një ng' ata.

Këta njerëz që kanë sytë me lot, këta janë ng' ata që kanë parë të mirë: kush kërkonte ndihmë, kush kish punë, kush kish djal' e çupë për në shkollë: kushdo që kërkonte ndihmë, s'kish ndihmës më të madh e më të mirë se ky Shqipëtar i madh që po varrohet sot!

Këta të tjerë mbi fytyrë të cilëvet është shkruar helmi dhe zija, këta të gjorë s'kanë pasur fatin të shohin në gjallëri Naimnë; po i kanë kënduar librat shqip, i kanë mbajtur në zemër vjershat; ato vjersha u kanë dhënë dashuri për mëmëdhe e për njerëzi, ato libra u kanë rrëfyer ç'është mirësia, dashuria, puna dhe jeta! Këta të gjorë janë të helmuar që s'e panë dot sa ish gjallë, po kjo nuk' i ndalon të kenë nderim dhe dashuri të madhe për Shqipëtar' e madh që po shpihet në varr.

Këta të tjerë s'janë shqiptarë, po nga komb tjetër: turq, grekër, etj: kan' ardhur me nder të madh, se kanë pasur fatnë të kuvëndojnë me Naimnë dhe janë çuditur me diturinë, me mëndjen me sjelljen' e bukur të tij!

Na se ku po ecin me krye t' unjët gjithë këta njerëz; nga nderi arkën e mbajnë mbi kokë, me të lartë! Ecin me ngadalë, se trëmben të venë në dhet këtë njeri të dashur: duan ta mbajnë! Dhe sikur të munt t'i epesh shpirt përsëri, e cili do kursente të tinë?

Ora shtatë! Arritmë në varr! Këtu na pret një helm i ri: jemi përpara varrit t' Abdyl beut; kështu pra, këta të dy vëllezër që kanë rrojtur bashkë, kanë punuar bashkë, kanë pasur një qëllim e një mëndim, që janë përpjekur tërë jetën' e tyre për Shqipërinë, janë dhe pas vdekjes ngjitur në varr!...

Shikoni, o njerës! Na se ku s'vihet në varr Naimi! Naimi, babaj i shqipëtarëvet, Naimi, babaj ynë, Naimi mësonjësi ynë! Dy kut dhe arrinë për këtë njeri të madh e të dashur! Na, humbi trupi! Dheu po e mbulon! Më s'e kemi për të parë, më s'e kemi për të dëgjuar!

O njerëz, gjithë kështu do vdesim! Do vijë dita që të mbulohemi më një gropë, që të na kalben e të na bëhen hi dhe eshtërat! ahëre s'na ka për të mbetur gjë nga këto poshtësit' e dheut! ahëre nga lakmimi, nga ligësitë, nga poshtërsitë, nga djallëzitë, nga marrëzitë, s'do të na mbesë fare gjësen; vetëm një kujtim do të mbesë të njerëzit: si lum ata që do të kujtohen për të mirë, si mjer ata që do të zihen ngoje për të ligë! Si mjer ata që kanë qenë të liq, si lum ata që kanë qenë të mirë! Perëndia do na njohi gjithë punët.

O njerëz, mirrni pjesë nga ky varr që po mbulohet përpara syvet: Naimi shkoi për jetë! Shkoi për ne, po vate te Perëndia! Neve na mësoi të bëhemi të mirë, të duhemi, të punojmë, të duam Shqipërinë!

Mirrni pjesë nga ky njeri përpara varrit të cilit po rrimë me sy të lotuar! Mbani mënt fjalët që na thosh, këshillat që na jepte! Kijeni për shembllë, se ish i mirë, i virtutshëm, vetijëmirë, shpirtmirë, i ëmbël! Tek ay çdo njeri gjente një ndihmës, një këshillonjës, një baba!

O shqipëtarë! Në doni të nderoni kujtimn' e këtij njeriu të madh që po e qan sot e tërë Shqipëria, mbani mënd fjalët e tij: Jini të mirë, vetijëpastër; doni mëmëdhenë dhe gjuhën tuaj.

U mbarua dhe shërbim' i fundit q'i bëjmë këtij Shqipëtarit, të cilit i kemi detyra të mëdha e të paharuara sa të rrojë Shqipëria dhe gjuha shqip. Tani gjithkush ng' ata që kish ardhur të vërë në gjit të dheut trupn' e Naimit, merr nj' udhë për të kthyer po me kokë t'unjur e të mejtuar.

Nga një breg kthejmë dhe një herë tjetër kokën: na se ku, atje tej, n'atë fshat më tej Ysqydarit, dy orë lark nga Stambolli, në Merdiven- Qoj, mbi një breg, atje janë të dy varret: njëri i ri, tjetri bërë më 11 të Vjeshtës' së 2-të 1892, n'ata varre janë mbuluar trupat e vdirshim të dy vëllezërvet; atje n'atë fshat të vogël, larg nga Shqipëria, flenë për jetë dy njerëz të shtrenjtë për ne; larg ng' ajo Shqipëri për të cilën rrojtne!

Po do vijë dita - oh, kemi shpresë të fortë - që të lirohet dhe të lulëzojë Shqipëria, dhe ahëre, do të shpihen' eshtërat e këtyre dy vëllezërve në Shqipëri, dhe t'u gëzohet shpirti duke parë - qoftë pas vdekjes- prodhimn' e farës që mbuallë me aqë dëshirë.

Eren-Qoj 1990

NJE KUJTIM

N'Eren- Qoj, një nga fshatrat e bukur të Stambollit ng'an' e Ysqydarit, është një udh' e gjerë afër stacionit t'udhës' së hekurte, një udhë që vete nga deti e gjer në Merdiven - Qoj. Cop' e kësaj udhe q'është m'anë të poshtme të fshatit, është anosur me dy rradhë repë të mëdhenj që hedhin një hije të hollë mbi pluhurin e trashë që mbulon rrugën në verë, dhe mbi baltën ngjitëse në dimër.

Duke ardhur nga deti dhe duke ngjitur drejt veriut, udha ka një vajsimë të lehtë; më të dy anët shtëpi të bukura, brenda në kopsht dhe në vreshta, mbajnë ndënjësit e fatshëm të kryeqytetit një gjindje që do dhe kërkon zbavitjen, dhe që nuk le t'i shkojë as ndonjë rasje për të dhënë udhë dëfrimit.

Kjo udhë si shkon rajet e hekurte, zgjatet, prapë ashtu e gjerë, po drurët e anës çdukenë dhe shtëpitë bëhen më të rralle; ca më tutje, duke kthyer pak më të mëngjër, kryqëzohet me një udhë tjetër që vjen nga Koz-Gataku e vete në Gjoz-Tepe. Këtu vëndi formon një shesh të lartë; ca më tej, tek kryqëzohen udhët duket xhamija e Sahrai-Xhedid; më tutje xhamisë duken ca varre, varre të vjetër

dhe të rinj, që gjithë tok, kanë bërë një katër kindje të gjatë.

Nga ky vënt ka një pamje të bukur mbi Çamllixhe-në. Nga veriu, përmbi dhe prapa Merdiven-Qojit, unjen piqinjt' e gjelbër të bregut kaq të hijeshëm dhe të dëgjuar të Çamllixhe-së. Sadoqë shumë herë kam mbetur i çuditur përpara kësaj bukurie t'atij piqiri veshur në bar e në drurë dhe stolitur me shtëpi të hijëshme, gjithnjë kam gjetur një shije të re n'atë pamje. Po tani mëndja jonë s'ka prehjen e duhur për të ndjerë shijen' e kësaj bukurie.

- Këtu në këta varre (i them shokut që kam pranë) kemi dy shqipëtarë: Tahsim Hoxha dhe Sami beu. Të parit për fat të keq nuk dimë ku i dergjen eshtërat¹, sa për të dytin, ky çip dhe ja mban të mbeturat e vdirshëme, nën këtë pirq balte fle gjumin e përjetshëm.

Një grusht dhe mbulon një njeri të gjallë, plot vullnet, tër shpresë dhe dëshirë! një pushtim i thellë tani ka zënë vendin e asaj mëndjeje gjithnjë në lëvrim dhe në punë. Rrojt një herë dhe tani më s'është?

* *

Më kujtohet gjithnjë një vjershë persisht që këndonte Sami beu me një zë të mallëngjyer:

*Der gurbet egjër myrq bigjired damen-i men
Aja qi qyned kabr qi duzed qefen-i men
Tabut-i-mera der xhoj-i bylend pyzarid
Ta bad byred buj mera der vatan-i men,*

1) Kam dëgjuar prej Sami beut vetë që Tahsim Hoxha vdiq n'Eren-Qoj, në shtëpi të Mynifpashës, dhe ishte varosur në varret Sahrai -Xhedid, po mjerisht pa ndonjë shënjë.

2) Përktimi i vargjeve: Në më zëntë vdekja në kurbet piqinë tim, Kush vallë do të bëjë varrë dhe do më qepinj qefinë tim? Tabutin virmani mbi një vend të lartë, që veriu të shpjerë erën time në mëmëdhet tim (Shënim i autorit).

Shumë herë këtë vjershë e pasonte një psherëtimë që Sami beu pothua se e kish për vete të tij, aqë një përshtypje të madhe dhe të veçantë bënte.

Si sot po e shoh: Sami beu kur shkronte e kish zakon që rrinte këmbë-kryq mbi një shilte të unjët; përpara mbante një fron t' unjët ku ishin rradhitur të hapura librat; libra dhe harta të hapur kish dhe më të dy anët, më të mëngjër, më të djathtë. Shkronte kurdoherë me një rregull dhe me një durim të çudiçmë, duke u ngritur gjithnjë fort herët në mëngjes.

Nganjëherë në mes të shkrimit ngrinte kokën nga karta që mbante në dorë, se zakon' e kish të shkrojte pa pshtetur kartën gjëkunt, dhe shkronte pastër me një shkrim të bukur, pa fare prishje dhe ndreqje¹; ahëre syt' e zes që i epnin aqë bukuri fytyrës, i ngrinte, psherëtinte, dhe një vjershë dil nga goja me një zë t' unjët; veç asaj vjershe persisht, shpesh thosh dhe të tjera persisht a arabisht.

Po ish dhe një tjetër, vjershë frëngjisht që dukesh për të cilën kish një dashje të posaçme; dy vjersha të Viktor Hygojt:

*Pourquoi devant mes yeux revenez-vous sans cesse,
O jours de mon enfance et de mon allegresse?*²

Ç'ishinë hidhërimet dhe shpresat e djalërisë që kujtonte Sami beu? Në ç' shpresa, në ç' prozhetë pritmi, në ç' ëndërimet të djalërisë kthente sytë dhe shikonte? Ç'ishinë këto shpresa që s'ishin mbaruar, që ishin pritur më kot?

1) Dihet se Sami beu ka shkruar pothuaj gjithnjë turqisht dhe është i njohur si një shkrimtar i kësaj gjuhe. E kish zakon që të shkrojë duke shtypur librin dhe kurrë ndonjëherë nuk mbaroi ndonjë dorëshkrim më parë se të vihet në shtyp. Kur e pyetnim pse nuk shkron shqip, Sami beu na përgjigjesh se, priste kohën që të shypen çpënguar libra shqipbrenda në Turqi.

2. Pse përpara syvet po me vini gjithnjë, o ditet e djalërisë dhe gazmenderisë (shenimi i autorit).

Kot kemi bërë shumë herë këto pyetje me vete tënë! Po Sami beu s'i kish të shuma fjalët. Atë që di është se, çfarë do që të kenë qënë shpresat, ëndërrimet dhe hidhërimet e tij. ay ish gjithnjë plot durim dhe kurrë s'e njohu dëshpërimin.

Prapë ja shoh të dy syt' e zes plot mendime dhe ëmbëlsi, të shkëlqyeshëm ballët e zbuluar; më të rrallë i dilte ndonjë fjalë hidhërimi nga goja, një psherëtitje e hollë; ahëre pandehnja se dëshpërimi ja shtrëngonte zëmrën, po kjo pandehje shuhesh shpejt duke parë durimin me të cilin punonte, shpresat dhe prozhetetë që bënte... Ahëre thoshnja dhe më dukesh se kurrë ndonjëherë dishprimin nukë ja njohu zëmra dhe mëndja. Edhe kështu vajti gjer n'orë të fundit.

Nga një njeri plot mëndje dhe punë, tani ky pìrg i vogël ka mbetur!

Stamboll, 7 gusht 1910.

SULOTET

Kam një javë këtu në Zafranboll, në këtë qytet t' Anadollit, të humbur në gropë, të nxehtë dhe plot konupe tani në verë. Lumturisht kam fatnë të gjej një ndënjtje të mirë me një kopsht të bukur rreth e rrotull, në këtë mëhallë të krishterë, që njerëzia- nga që të dy fetë s'piqen dot- e shikojnë si një fshat veçan dh'e quajnë Këran-Qoj. Nga penxheret shoh dy vargje malesh të ndarë më një grykë; atë që kam përpara të xhveshur dhe gurishte, m'anë të djathtë male të zez tëri drurëm pyje të thellë. Nga penxhereja tjetër shoh majën e kishës Shënt-Stefan. Ajo Theodhora e

moçme e cila dhe mbase i ep emrin e qytetit (Theodhorjan Polin = Zafranboll).

Kajmekami, miku im z. Kadri Përmeti, më tha që dje se do të vemi në shkollë greqisht të çupave, të ndodhemi në provimet e tyre, dhe me gëzim, e pranova ftimin e tij...

Në sallë të shkollës janë rradhitur nja tridhjetë çupa, në rrjeshtat e para; prapa tyre janë djemtë, në mes të tyre disa gjashtë dhe shtatë vjeç po dhe dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë.

Provimet rrjedhin mbi dheshkronjë, gjuhë turqisht, frëngjisht, orthogravi; nxënësit përsëritën përpara pllakës së zezë dhe kushdo prej të ftuarëvet ka të drejtë të pyesë.

Unë po vë re. Çupat që kam përpara janë të krehura mirë, të kujdesura, të veshura të gjitha me një mënyrë: rroba të bardha me kordele të kaltërta: ngjyrat e Greqisë! Edhe më vjen keq për këto çupa, për këta djem dhe për mëmat dhe etërit e tyre, që janë rradhitur afër murit, më të djathtë e më të mëngjër; më vjen keq për këta njerëzi pa kombësi, pa gjuhë; flasin vetëm turqisht, janë thjeshtë anadollakë, s' di njeriu nga ç'kombësi janë, dhe duan të rrëfihen grekër! S'kan' as histori, as kujtime të moçme, as ndonjë ndjenjë të tanishme, dhe duan të ngushëllohen me një shtat të vogël atje poshtë, me Greqin' e largët se ashtu ja u do feja, ashtu u ka thënë kisha dhe dhaskali. Edhe vërtet më vjen keq si për jetimë, si për djem pa mëmë, pa baba, pa shtëpi, dhe them: kur s'janë gjësen, dobare le të thonë që janë grekër.

Po dal! Çupat tani më s'po pyetën, kanë zën' e kërcejnë. Ç'është kjo valle, kjo këng' e njohur. "Lamtumirë o jet' e ëmbël!... Sulotka..." në gjuhë greqisht.

Këng' e Sulit! Këng' e shqiptarkavet, këng' e vendit tim; edhe kraharori më fryhet zemra më madhohet; më vjen dhe mua t'ja dredhë njëherë, a t'ja marr me to.

Këng' e Sulit! Po shoh ato shqipëtarica trimëresha, ato gra zemër luaneshë, vallen e tyre mbi shkëmbt, varur mbi

riplet, një valle vdekjeje, një zë i qiellit dhe i varrit!
Ushtarët e Ali Tepelenës po afrohen; po sulen; po gratë
këndojnë, dridhen, të zëna prej dore, dhe ay varg më çdo
grimë po humbet nga një shpirt, edhe një nga një gratë
lëshohen poshtë shkëmbit, hidhen në greminë, në skëterrë,
në gojë të vdekjes që i kapër xen një nga një. Edhe vdesin
me këngë në gojë, pa u dredhur zemër' e tyre!

Më mirë vdekj' e lirë se sa turp dhe robëri; na fjala
këtyre shqipëtarëve, e sulotkavet me kujtim të pavdirshëm,
që i japin një emër të përmotshëm kombit tën, që trimëri e
tyre do t'i inspirojë gjithnjë poetët e gjithë kombevet!¹
Sulott, një grusht njerës që kanë mbushur me famën e tyre
faqet më të çkëlqyera të historisë së tanishme, që kanë lënë
kujtime trimërietë paharruara!

Edhe e ndjeva veten time fatore të jem nga kjo racë, nga
ky popull, nga ky dhe, nga këta shkëmbënj që nxjerrin të
tillë njerëz, të tilla gra! Edhe kraharori m'u fry edhe një
herë duke dëgjuar këtë këngë, këta emra, duke parë këtë
valle këtu në këtë qytet t'Anadollit.

Popse zëmra ime përnjëherë më ngushtohet dhe mejtime
të hidhur më sulen' në mendje? A është pse këta sulotë
kanë derdhur gjakun e tyre kaq të famshëm, për një çështje
të huaj, për një komb që s'ish i tyre? - Jo, s'është ky mejtim
që më hidhëron kështu, se e di, e kam ditur, dhe gjithë bota
e di që edhe këta shqiptarë, si kaq të tjerë, si dhe Sinan
pasha, a Qypruliu, a Mehmed Aliu, kanë shërbyer një
kuazë jo të tyren!

Ajo që më hidhëron është Sul' i sotëm.

Ku je, o Sul? N' ato rripat e tua ata njerës trima, a e
kan' akoma atë zemër trime, a e dinë që janë shqiptarë, që

1)Për vdekjen iroke të sulotkave vjershëtori dhe romancieri spanjoll
Gasper Nunez de Arce ka një copë fort të bukur në vepër të tij: "Ultima
lamentacion de Lord Byron" (Shënim i autorit)

gjaku shqiptar rreh në rrëmbat dhe në zëmrat e tyre?

Tre vjet po bëhen kur qeshë në Shqipëri vajçë nga Llura në Llakë të Lelovesë, në këtë copë të Sulit. Po sa një helm i madh më priste: atje pashë një të keqe, një mëkatë që s'rrëfëhet; atje pashë fshatra ku, jo shqiptarërija, po edhe shqipja ka zënë të harohetë!¹ Si tani po e shoh atë djalë mbi mur të Papadhatës, kur m'u përgjigj greqisht fjalës shqipe. - Kush të tha që të mos dish shqip, or bir? - O dhaskallos, më tha djaloshi pa ditur se ç'të vërtetë të helmshme po thosh!

Ah, jo! E kuptoj që këta anadollakë të gjorë, këta jetimë të varfër të thonë se janë grekër. Po ne, ne shqiptarët, me kujtime, me histori të shkëlqyer, me fytyra dhe me emra të ndershëm, në të themi se jemi grekër, këtë s'ma pret dot mendja!

Edhe nuk di, në duhet të kem një cmir të vdekshëm për atë "o dhaskallos", apo në duhet të më vijë keq për atë djalosh dhe për prindët e tij?

Zafranboll, 30 Qershor 1912

NE SINOP

Po fryn një er' e fort e veriut, dhe qiell i Sinopit që rrinte i kthiellt dhe me atë ngjyrë si plumb që një javë, sot është e veshur me copë re të zeza. Pluhuri që pëlyri gjithë botën tërë ditën, zuri dhe u pakësua ndaj mbrëmanet, dhe deshtë

1) *Vizitova qytete: Pollogora, Bulmet, Zervo, Papadhates, Nikolic, Dara, Lelovë.*

bëj një shëtitje.

Ka shumë gjërta për të par këtu në Sinop, dhe që kur jam në të, çdo ditë ka ardhur me një të vogël gaz zbulimi për mua. Edhe sot marr udhën e atij bregu në majët të cilit kam një javë që shoh një gërmadhë të vogël. Mbi tokë gurisht dhe duke shkelur në mëndërz t' egër që ep nj' erë të mirë, në gjysm' ore jam në majë: shoh se kjo godi e vogël s'ka qënë gjë tjetër veçse një xhami, me mihran në vend dhe me kube të rrëzuar përgjysmë; më patnë thënë se qe një shikonjëtoe për të parë anijet së largu, a një fener i moçëm për t' u rrëfyer udhën natën; po s' shoh gjë t' atillë.

Nga kjo gërmadhëzë që kërcet nën frymën e egërsuar t' erës, kam përpara syvet qytetin Sinop, një pjesë të madhe të steresë dhe detin më të dy anët. Në ke qën' ndonjë herë në këtë qytet, i dashur këndonjës, do ta dish se Sinopi është goditur mbi rripin e ngushtë që lith në steret një sinisi shkëmbore, Boz Tepe, një breg i thatë, pa bar, pa dru, dhe majë të cilit po gjëndem.

Një tablo e bukur zgjatet përpara syve të mij: deti që kam më të dy anët ka ngushtuar qytetin mbi atë rrip si në mes t dy pellgjeve, dhe era po i bën xhufka të bardha zallit më të djathtë. Na qyteti me mure të lartë dhe të fortë nga stereja, atje tek rripi është m' i ngushtë, muret t' akropolit të moçmë, të këtij Sinopi të themeluar prej shokut të Irakliut dhe të kolonizuar prej Miletanëve, mure ku sot gjënden të dëgjuarët burgje të Sinopit? Ng' an' e bregut, anë qytetit, këtej nga ana ime, shoh ca mure të tjerë, ca të mbetura godije, pallat' i Mitridatit, t' atij mbreti të çudiçmë që i mbajti ballë Romës kaq vjet, dhe që në funt, i mundur dhe i dëshpëruar nga jeta e nga rrojtja, nga kjo rrotje që donte të mbronte me t' u stërvitur kundër çdo helmi, s' gjeti anë tjetër të mbroj veçse me kordhën të një skllavi, se edhe

kuror' e tij s'hynte dot më punë.¹

Po vërej këto të tëra, shtëpitë, godit e re të ngrehura, muret që po i rrëzojnë tani ng' an' e shtëpis' së qeverisë, muret e burgjevet në të cilët pashë kaqë gurë që dëftejnë se janë të ndrequr prej Qejquas Selçukut. Xhamin' e Isfendiarëvet, të këtyre "hajdutëve" si thon' historitë turke, se i rrinin kundër fëmijës Osmane, po shoh qivuret e tyre afër xhamisë, medresenë që kan' ngrehur...

Sa më pëlqen shikimi i qyteteve të moçme, i vëndevet që mbajnë brenda në muret dhe në godit të tyre kujtimin e disa qindëra vjetëve! Në jetët bredhëse që po rroj këta dy vjet e fundit, kam parë mjaft qytete të vjetër, mjaft gjermadha, dhe përmbi ta kam parë edhe perëndimin e diellit, edhe dritën e venitur të hënës...

Po tani pse jam kështu i pikëlluar? A është kujtim i këndimit të Strabonit, apo pse ndodhem përpara qytetit të Dhiogjen Qenikut² e të Mitridadit, apo pse në këtë liman

1) Mitridati prej te cilit bejme fjale eshte Mitridat i Katerti i quajhuri Evpator, per kete mbret historianet e moçmë thone se ish fort trim, dinte 22 gjuhe dhe me qene se trembesh mos e helmojn armiqte, ish mesuar te pije çdo helm. Mitridat Evpatori leftoi ne lufte dhe si e pa qe edhe ushterit' e tij e lane, desh te helmohesh po me qene se hekmet s'kishin ndonje veprim mbi te, desh t there veten, me kuroren e tij. si e pa qe edhe kurora s'ish e mprehte, i urdheroi ahere nje skllavi qe t'i bjere me kordhet.

2) I dëgjuari fillozof Qenik Dhiogjeni ka lindur në Sinop më 412 dhe vdiq në Korinth më 323, atë ditë që vdiq Aleksandri i Madh në Babiloni. (Shënim i autorit).

të bukur janë mbytur kaqë njerës¹.

Ajo që mejtohem tani është gjë tjetër: atje anë qytetit shoh një godi të bardhë gjysmë të fshehur prej ca drurësh; përpara kësaj shkolle idadie kam parë një varr, një të vogël varr me dy gurë; këta gurë i kam kërkuar sapo ardhsh; ay m'anë të kokës - si gjithë gurët e varrevet myslimane - ka emërin e ati që mbulon:

Ymer Shevki Narta, lindur më 8 Prill 1253 vdekur më 20 Maj 1318.

Ymer Efendi Narta²! Kujtimi tani po më vete njëzet e kaqë vet më prapa: isha një djal akoma kur mbaj mend se për herën' e parë pashë këtë shqiptar. Pastaj e pashë akoma, dhe im atë thosh se kish qënë m'i mir' miqvet dhe m'i vëret i mëmëdhetarëvet. Si sot i shoh mjekrën' e bardhë të tij mbi fytyrën' e hollë dhe të ligur, buzët gjithnjë në qeshje, të folurit e ëmbël.

Tani kujtimi është m'i gjallë se punët në Shqipëri janë të përzjera dhe mëndja vete në ngjarjet e vjetvet të shkuar. Lidhje' e Prizrenit, ajo lidhje dhe ajo lëvizje që ish çap i parë në zgjim e në përparim të kombit tënë, të ndjenjave kombiare tona.

Prapë një ethe, një ethe gjëllimi, një ethe për rrotje i zuri shqiptarët. Dhëntë zoti dhe këto të përpjekura u shtofshin fuqinë dhe i nxjerrshin më të fortë e më të zotër.

Sinop, 27 Korrik 1912.

1) Më 1853, në luftën që thuhet i Kremit a i Sevastopolit; admirali rus Nahmiov mbyti në liman të Sinopit armatën turke 12 anijesh. Varret e të vrrarëvet janë prapa shtëpis' së qeverisë, dhe një vjersh' e gjatë shkruar mbi gur, është vënë për kujtim të tyre.

2) Ymer Efendi Narta ish mik i Abdyl be Frashërit nga koh' e Lidhjes së Prizrenit ku dëftën fuqi dhe mëmëdhetari të vërtetë. 15 vjet më parë u zu në Stamboll dhe u dëbua në Kastamoni pastaj u bë mytesarif në Sinop ku dhe vdiq.

P Y L L I

Njëherë, fati më shtyri në një qytet mbi zall të detit të Zi, në Ineboll. Sadoqë thonë se ay det është shumë her' i kuq dhe i lik, udhëtimi im kish qënë fort i këndshëm. Po e vërteta ish se dhe stina ish pranverë, ëmbëlsi dhe bukuri e motit.

Sa pa dalë nga vaporri, kisha shikuar qytetin. E dinja se brënda s'kish asnjë gjë të vërejshme, n'ato rrugë të ngushta të këtij qyteti të vogël- megjithë që i përsëritur dhe i pastër-nuk më priste ndonjë send i interesatshëm. Pra, donja më mirë ta shikonja së jashtmi. Inebolli ish shtrirë mbi zall, më të dy anë të limanit; shtëpitë e prapsme ngriheshin mbi një faqe, mbi piqinj e një kodre; kodra ngjitesh, bëhesh me majë, dhe fare sipër kishte një godi të madhe. Padyshim një manastir, thashë se rreth godisë kish drurë, lisa të mëdhenj. Pra, kam se ç'të shoh, e di tani ku të vete.

Në udhëtime të tillë njeriu duhet të mos harrojë dy gjëra: Të kënaqet me një hotel të dobët ose me një han të mirë, edhe të dijë të kërkojë, të gjejë, të zbulojë një gjë të interesaçme, një gjë që vlen të vizitohet, një gjë që të mos thotë njeriu se humbi kohën fare kot.

Mora pra, udhën e kodrës, si lashë valixhën në një hotel të keq; shkonja nëpërmes të rrugëvet, herë më të djathtë, herë më të mëngjër. Turkeshat që takonja mb'udhë shihnin turinjtë, ose më kthenin krahet, prisnin gjer sa të largohem; ca të tjera nuk' kënaqeshin as me kaq: rrinin edhe më bisht: donin kështu të më fshihnin edhe fytyrën, edhe formën e trupit; të humbisnin çdo të ngjarë me gruan; po kjo s'më

ndalonte që t' i vërenja më tepër se bëheshin të interesaçme për të qeshur. Kur s' di njeriu udhën, është më mirë, se mund që të shohë edhe gjëra të ra. Si u mbaruan shtëpitë e qyteti e një mëhalle, të rrethuara me kopshte, të mbuluara me drurë, këta kopshte, postatet me zarzavate, lopët, viçët dhe dhentë që ktheheshin, i epnin asaj mëhalle një ngjyrë fshati, një fytyrë pak të shuar, po të qetë.

Si u mbaruan godit e fundit, zinte një pyll i vogël; drurët ishin të përzjerë: veç drurëvet me pemë që lamë përposh, në pyll kish shkozë, ah, panjë, dushk, lofatë, frashër; aty këtë lar, lar i Apollonit rrëfente fisnikun dhe të fortin drun' e tij, me lëvezhgën e limuar, me fletët si majë e shigjetë. Më lart akoma kish bredha, boriga, drurë të shkurtër, po të shëndoshë; lëkur' e tyre e rrudhur dhe' e çarë shtrytthe lëngun e trashë, pisën e verdhë, një farë mjaltë të hidhur. Pas një sheshi të vogël, ku bari gjelbëronte dhe rrëfente ca njolla lulësh mbi kadifen e gjelbër, drurët rriteshin dhe më tepër, majat u ngjiteshin më lart, degët me gjethe u bashkoheshin.

S' di gjë më të këndshme se t' ecurët brenda në një pyll të dendur, ku trungjet lartësohen si shtyllas, kur degët dhe fletët, duke u përzjerë atje në majë, formojnë një arkitekturë gotike që s' e barazon dot kurrë mjeshteri e njeriut; drita këtu mezi gjem një rrugë nëpërmes t' atyre fletëve; sitet, kullohet thotë njeriu se pastrohet, humbet fuqinë dhe merr një ngjyrë të venitur, si drit' e agimit; një mister, një ndjenjë pikëllimi mbretëron. Edhe kuptohet lehtë pse të moçmit e kanë ardhuruar pyllin, pse e kanë mbushur me perëndi, pse atje kanë pasur vëndin e faljevet, e lutjevet, e misterevet, e shogrimevet të tyre.

Duke dalë nga këta lisa, majë bregut, mbi një shesh të vogël ish Manastiri, një kurorë mbi krye të kësaj toke. Ish një godi e madhe, me një kishë të moçme më nj' anë; një mur' i unjtë, një farë sofati e rrethonte.

Ndënja mbi atë sofat. Isha pak i lodhur, se më ish duhur të ecënj më tepër se një orë më të përpjetë. Po ish e bukur

pamja, kisha përpara meje, nën këmbët e mia një tok bukuri.

Pyllin tani po e shihnja të tërë, megjithë ndryshimet e lëndëvet të drurëve. Ish krej qershori dhe dita kish qen' e nxehtë, dielli i shkëlqyer. Nga pylli dilte një arom' e mirë; nën shtizat e diellit këto bimë kishin dirsur; një aromë e bërë prej djersës së vesës dhe prej rrezetve të diellit; kjo djers' e ngrohtë e gjithë këtyre drurëve, ky avull i hollë i jepte njeriut një si dehje.

Një prift i motshëm më ish qasur, mjekrë bardhë, veshje të zezë. I fola gjuhën e tij, ose të them më mirë, gjuhën e kishës; mori besim, më foli pa ndruajtje, më rrëfeu të vuarat e fetarëve të tij, m'u qa prej kombit mundës, më tregoi besimin dhe shpresën që kishte për pritmin.

Në këtë orë tek dita ish në të mbaruar, ky njeri në ngrysje të jetës më dukesh fort i ëmbël. E lashë të flasë.

Në këtë dritë të mbrëmjes majat e drurëve më dukeshin si një det i valuar, një det fletësh. Rrënjët e tyre ishin thellë të ngulura, kërkonin atje poshtë lëngun e dheut; trungjet dhe degët kërkonin vesën dhe diellin. Gjethi i ri sapo kish dalë, mezi ish ngjallur nga vdekj' e dimërit, po një ngjallje, një zgjim i fortë, plot fuqi, plot shpirt; ky shpirt po shfaqesh në lastarë të rinj, në degë të njoma; fletët plot ngjyrë, gjak dhe dritë, të ushqyera me lëngun e baltës dhe me vesën e qiellit, po zgjeroheshin, po çeleshin, të lumtura dhe të forta, me një mijë forma, të dehura prej jetës, të gëzuara prej kësaj lirie së plotë në erë. Sikur donin të shijonin gjithë jetën, gjithë gjëllimnë, gjithë lirinë me një parverë, sa ka vesë dhe diell pa ardhur bryma dhe retë. Edhe degat, si krahë atleti të fortë, ngriheshin drejt diellit dhe qiellit, me gishtërinj të kuruara, me një lavd dhe lutje për mirëbërësit e përjetshëm.

Brenda në pyll, bashkë me fletët dhe lastarët, ishte ngjallur një tjetër jetë, një gjellim me krahë dhe me gojë; një jetë kishte buçitur mi atë baltë, në mes atyre fletëve,

anë degave; një jetë që zjente më një mijë formë, miza, krimba, gjinkalla, flutura, të lumtura dhe të dehura edhe këto prej diellit e prej vesës së kthielltë, të bashkuara e të vëllazëruara me pyllin, për lavdin' e jetësë, gjithë ditën në himne e në lutje, një himne me fjal e me ligjërata, kur ajo e bimëvet ishte e heshtur, pa gojë, vetëm me gjeste.

Tak, tak, tak!

- Po bëjmë dru, - më tha plaku me mjekrën e bardhë. Të krasiturit i ep fuqi drurit, pastaj më mirë të pritet se sa të vdesë mbërdhe prej pleqërie.

Edhe sikur shikoj mjekrën e gjatë, si një lumë dëbore, me hidhërim.

Atje tej tek deti piqesh me qiellin, dielli ish gati në të shuar. Disku rrumbullak mori më parë një formë vezore, pastaj duke psheturë në horizont u zgjerua më tepër u bë fare i shtypurë, u nda nga qarku, dhe mbi ujët, nën diellin u çfaq një farë vij' e vogël e zjarrtë. Fenomen i bukur që m'ish duhur të vinja buzë këtij deti për të parë.

Një pushim. Tani më nuk kuvëndonim. Edhe prifti po shikonte a më mirë po mejtohesh. Mbase po bënte një lutje, një kungim të brendshëm.

Po ky zë ç'është? Nga del kjo klithje e çudiçme?

Fare poshtë, tek qullet qyteti në ujë, në liman, një vaporr i madh po ngarkon ushtarë. Djelmoshat, fshatarët, burrat e Anadollit po shpihen' në Shqipëri se ka kryengritje në Kosovë.

Atje është rrëmujë vëndi! Një ethe i ka zënë njerëzit. Këta që po ngarkohen në vapor nuk dinë ku venë, s'dinë pse venë. Po ata atje, në anën Vardarit dhe Drinit, a e dinë ç'bëjnë? Gjaku pa dyshim do të rjedhë. Njerës do të vriten. Për fitim a për dëm, duke ditur qëllimin a po një fat i verbër po i shtyn?

Tak, tak, tak! - bën sëpata.

"Të krasiturit i ep fuqi drurit; më mirë të pritet se sa të vdesë vetë" - më kish thënë plaku.

Kastamoni, 18 Korrik 1912.

NETET

Kam ca kujtime nate që, të isha poet, do t'i vinja në vjershë, të isha piktor do t'i përshkronja me ngjyra.

* *

Një natë ramazani, dhjetë vjet më parë, në Stamboll desha të vete në Sh-t Sofi për teravih. Falëtorja e madhe ishte e zbratur kur arrita. Kandilët qenë të rrallë. Ca nga ca shkëndijat e kandilëvet u shtuan, njerëzia zu të vijë. Ajo kube e madhe dukesh sikur po e shtypte me gjithë të rëndët e saj këtë pushim të thellë. Në gjysm' errësirët shtyllat e trasha dhe të limuara, si gjigandë të mëdhenj, pandehësh se ishin çuar më këmbë dhe po shikonin përpjetë, po prisnin një gjë.

Edhe sa vente njerëzia po arrinte. Gjith ay shesh zu të vij i ngushtë, reshtat po afëroheshin, besnikët po qaseshin, me një afrim te njeri jatri, sikur për t'u falur më mirë gjithë bashkë.

Përnjëherë u dëgjua zër' i myezinit nga mihrabi; pastaj një zë jatrë, dhe gjithë këta njerës, si një njeri i vetëm, ngritnë duart e tyre, me një shpirt, të gjithë bashkë me një hov lutjeje.

Ca kohë nuk' u dëgjua në këtë falëtoje të gjerë asnjë zë tjetër, veç fjalët e ngadalshme të myezinit. Gjithë kjo gjindje ishte fundosur në adhurim, e lumtur që nginjte mevojën e lutjes që u ndjente shpirti.

* *

Në Vjenë një prej monumenteve më të vërejtshme është dhe kisha e madhe e Sh-t Stefanit. Falëtorja e madhe gotike duket sikur ka vetëm shtyllat e saj të rënda. Kur hyra brenda mu duk sikur nuk' kishte kube, po sikur një natë e kishte mbuluar së sipërmi, një natë misterioze.

Edhe besnikët ishin gjunjësor përpara ikonave të shënjtave në një adhurim plot lutje. Sa zëmra kishin ardhur këtu që të kërkojnë përdëllim, të gjejnë ngushëllim, të qetësojnë valët e vuajtjeve. Desha një natë, ta shoh në drit' të hënës këtë kishë. Ish një hën' e ndriçme, me një dritë më të artë se kurdoherë. Donja të shihnja atë pullasin me majë, atë kullën si një shigjetë drejt revet, në pushim, në vetësi.

Sa qenkam gënjyer! Kur u qasçë pranë, hëna kishte humbur, hije e saj ishte çdukur! Llambat e elektrikut lëshonin më të gjitha anët një dritë të fortë, edhe njerëzia e derdhur më të katr' anët prej rrugëve të gjata po zjente dhe roitte rreth kësaj godije.

Edhe kurrë s'kam mallëkuar si ahëre edhe dritën e elektrikut, edhe njerëzit që s'dinë të flen' natën.

* *

Në Athinë jam në një teatro. Në mes dy akteve njeriu ndjen një nevojë të madhe që të dalë, të marrë frymë, të çlodhet prej asaj vërejtjeje së shtrënguar.

Isha fare vetëm, dhe dolla në perron të shkallës, të marr pak erë të freskët. Përpara ish një shesh i vogël, i mbjellë

me pakë bimë ekuatoriale, dhe rrethuar me ca godi të larta.

Er' e freskët ish dhe pak e ftohtë, dhe kurr gjë s'i jep shpirt dhe fuqi njeriut sa të ftohët e erës. Ngrita sytë përpjetë. O Çudi! Kurrë s'kisha parë një qiell kaqë të bukur!

Ish një nat' e errët; drit e hënës s'kishte ardhur të shuajë yjtë, dhe këta yj m'u duknë të mëdhenj, shumë të mëdhenj. Asnjëherë s'kisha pandehur që këto shkëndija të kenë kaqë dritë, të jenë kaqë të kthiellta, qielli vetë të jetë kaq i shkëlqyer, kaq i kulluar, në thellësi të tij të pafuntme.

Ahere m'u duk sikur e kuptova pse ata të moçmët e epnin fuqi dhe fytyrë perëndija qiellit dhe yjvet të tij.

Në Ajeros, po bëhenë gjashtë vjet, jam në Masnastir Sh-t Paul. Një jav' e shkuar n'atë vent është në kujtimet e mij jeta m'e ëmbël që kam parë. Çdo nanastir ka interesin e tij, çdo çip dhe një bukuri të veçantë. Edhe sot akoma po e ndjej bukurinë e mëngjezit kur zgjuheshja në Karies, përpara të tri qiparisave të vegjël, të veshur në rrobe të zezë. Bilbili dhe qyqeja përzjenin zëret e tyre melankolikë përmbi një det të gjelbër të bërë prej gjethit të drurëve pa numër.

Pra në manastirt Sh-t Paul atë natë ishte afgripnia; kallogjerët gjithë bashkë do të falëshin tërë natën në kishët. Disa prej tyre venin të çlodheshin pak, ktheheshin më pastaj, dhe prifti që kam pranë, me një tyrqishte të pak, donte të më shpjegonte ritualin. U - larguash nga folësi, që të jem më vetëm.

Tani kallogjerët gjithë së bashku, me një lëvizje të matur, po bënin kryq, duke unjur trupin e tyre drejt dheut. Rrobat e zeza të këtyre priftërinjve nxirnin një zë të hollë, një fushullimë të çudiçme.

Edhe përnjëherë mëndja më vate njëzet vjet më pas. Isha i vogël ahere, dhe rrinim më një mëhallë të largët në Stamboll në Marki- Qoj. Çdo mbrëmje me dy shokë të mij venja anë detit, më një vend t mbjellë me rrepë të mëdhenj, drurë shekullorë plot dega dhe fletë. Çdo darkë pas

perëndimi; korbat e gjith' atyre viseve vinin me tufë që të zinin vëndin e natës.

Edhe fluturim i tyre atje lart në erë nxirrte një fushullimë të çuditçme.

* *

Vjet po vemi në Korçë nga Elbasani. Dje kishim marrë vesh trazimin e shëmtuar që ish bërë n'atë qytet, dhe jemi nisur me ca vetëdashës. Kur arrimë në Babje ish errur që me kohë, hanxhiu kishte mbyllur derën, ish kryqëzuar afër zjarrit të kafesë, një pagur dhe një kupë me ullinj të zes përpara. Më një mënt hani u mbush se ishim shtuar dhe me udhtarë të tjerë, ullinj të që hanxhiu i bënte meze, na qetuan pak urinë; një pul' e shkuar në hell me nxit, na dha pak fuqi. Hanxhiut i kishim ngritur prëhjen, i muarmë dhe vëndin.

Po s' duhet që të rrimë. Udhë është' e gjatë dhe do vajtur një orë më shpejt. Ejani, djem, të flemë në Xhurë.

Jemi më këmbë, po asnjë s' qahet; dyfekun e kanë marrë ata që kanë besim edhe në kërcinjt' e tyre.

Një hën' e ëmbël, afër katrëzimit të fundit, po na ndrit qiellin e lindjes. Kjo udhë ditën është me një bukuri të madhe; natën me hënë është me një pitoresk të parrëfyer.

Hëna dukesh e mbërthyer mbi këtë mur që kemi më të djathtë; drit' e saj herë del prapa një shkëmbi, herë fshihetë prej një bregu. Herë mbretëron te një copë qiellit të kaltërt, formuar më një të çarë të dheut. Matanë, përkundrejt, më të mëngjër tënë, drit' e hollë vete dhe pluhuron malet e Mokrës, po lugina e Shkumbinit, plot oshëtima dhe mistere, mbetet në hije.

Mbi gjithë këto tablo, nga e djathta, ka dalë një shkëmb, i ngushtë dhe i gjatë, kryet të sheshuar, mbi vargun e brigjeve si një mur. Hëna, afro gjysmë, më duket sikur pëlqen këtë bregun e gurtë më tepër se çdo gjë tjetër, se sado që ecim, copa drite gjithnjë duket mbi atë shkëmb.